



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



## T R A N S K R I P T

I mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.03.2018, e cila filloi në orën 10:00.

**Kryesuesi, Agim Kuleta:** Po besoj që jemi gati me filluar.

Atëherë përshëndetje për të gjithë!

Para se të fillojmë me pjesën e rregullt me rendin e ditës, e kemi një zëvendësim në radhët e asamblistëve të GP të LVV-së, z. **Yll Rugova** zëvendësohet nga z. **Bashkim Beha**, të cilin e ftojme të ngrihet në këmbë dhe ta japë betimin.

**Unë, Bashkim Beha, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.**

**Betohem!**

**Kryesuesi:** Faleminderit, Bashkim, urime e punë të mbarë!

Tash janë disa shpjegime që ka nevojë të bëhen për asamblistët sa i përket mënyrës së funksionimit me teknologji, ashtu edhe disa çështje të tjera, për të cilat z. Bllaca do të na njoftojë.

**Osman Bllaca:** Përshëndetje të gjithëve!

Ka ndryshuar mënyra e votimit në mënyrë elektronike nga ajo që ka qenë më parë me kartela. Kartelat më nuk do t'i përdorim, por do të bëjmë votim të drejtpërdrejtë, kështu që kur kryesuesi e përfundon dhe thotë po hyjmë në procesin e votimit, atëherë para mikrofonave ndezën të tri shenjat: "po", "jo" dhe "abstenim". E prekni njërën prej tyre, në mënyrë që të regjistrohet tek regjia votimi. 20 sekonda zgjat e drejta e votimit që duhet ta bëni, pra brenda 20 sekondave duhet të votoni. Gjithashtu, është edhe deklarimi i pasurisë, si zyrtarë të lartë që jeni. Duhet ta deklaroni pasurinë në Agjensionin Antikorrupsion. Ata kanë kërkuar, kanë bërë edhe një shkresë, në mënyrë që disa, apo shumica prej anëtarëve

nuk e kanë bërë deklarinë e pasurisë. Luteni që të deklaroni pasurinë deri më 31 mars 2018, për arsye se pastaj gjobat janë goxha të mëdha nga Agjensioni Antikorrupsion. Anëtarë të Kuvendit, para jush e keni edhe nga një fletë që duhet të shënoni emrin dhe mbiemrin për E-mail zyrtar, por ka shumë njerëz që e kanë të njëjtë emrin dhe mbiemrin me dike tjetër që ka E-mail zyrtar, andaj shkruani emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin. Pra, në këtë formë p.sh. në mënyrë që mund të jetë Osman Asllan Bllaca, tash p.sh. ka Osman Bllaca tjetër dhe në këtë formë, pra e bëjmë: "Osman .A. Bllaca.@rks-gov.net", pra ky do të jetë emaili i juaj zyrtar.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Atëherë konstatojmë se kemi kuorum, 44 janë prezentë dhe mund të procedojmë me mbledhjen.

Përpara e kemi një rend dite.

A ka dikush diçka rreth rendit të ditës?

Po, urdhëro z. Makolli!

**Vesel Makolli:** Shef të grupit e keni bërë Samiun, e duhet bërë një permetacion me mua.

**Kryesuesi:** Në rregull, faleminderit!

Tash unë e kam një propozim, nëse pajtohemi ta fusim si pikë të rendit të ditës. Gjatë kësaj periudhe e kam parë që rregullorja është prej vitit 2010 dhe ka nevojë për disa ndryshime, në mënyrë që të funksionalizohet edhe më shumë puna e kuvendit, prandaj nëse jeni dakord, do të propozoj që ta fusim si pikë të rendit të ditës: "Formimi i grupit punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Kuvendit dhe komiteteve".

A jeni dakord?

Atëherë regjia le të përgatitet për votim.

Votojmë tash.

Regjia, më fal vetëm një sekondë, se po më duket ka nevojë për sqarime.

Jo, jo, nuk është ashtu, jo, tash po propozoj me e fut një pikë të re, pra "Rregullorja e punës së Kuvendit dhe komiteteve". Po mendoj që ka nevojë pak me punuar diçka. Propozimi është me e krijuar një grup punues, prej të gjitha subjekteve politike, dhe me plotësuar e me ndryshuar.

Më falni, veç një sekondë, regjia ju lutem!

Fjalën e ka Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Ne e kemi edhe formimin e grupit punues të Planit të veprimit, kështu që ia shtojmë atij Planin e punës dhe Rregulloren për punën e Kuvendit. Pra do të jetë i njëjti grup që punon për Plan të punës dhe për Rregulloren e punës së Kuvendit dhe komiteteve.

**Kryesuesi:** Nëse jeni dakord, po.

Atëherë po e qesim formalisht në votim propozimin që të plotësohet pika e rendit të ditës. Po, po, veç duhet plotësim-ndryshimi me u votuar.

Atëherë, pra po e hedhim në votim komplet rendin e ditës, me propozim për plotësim dhe ndryshim.

Po, urdhëro!

**Agim Gashi:** Në KPF e dhashë vërejtjen rreth formulimit të pikës së dytë të rendit të ditës. Meqenëse Komuna e Prishtinës e ka të miratuar një Plan zhvillimor komunal deri në vitin 2022, ai plan është i plotfuqishëm. Meqenëse Komunës së Prishtinës iu ka paraqitur nevoja për ndryshimin e planit, bazuar në ligjet përkatëse që e rregullojnë këtë fushë, bazuar në Planin financiar për vitin 2018, miratuar nga po ky Kuvend, ku është planifikuar buxheti për pozicionin: “Propozim-ndryshimi i Planit zhvillimor komunal”. Unë propozoj që kjo pikë të harmonizohet me dokumentet paraprake dhe të formulohet kështu: “Propozimvendimi për propozim-ndryshimin dhe plotësimin e Planit zhvillimor komunal 2018-2026”, sepse nuk ka kurrkund në botë dy dokumente paralele me ekzistuar, dhe do të ishte shumë e drejtë në bazë ligjore, që kjo pikë e rendit të ditës të harmonizohet me dokumentet paraprake.

Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka z. Genc Bashota.

**Genc Bashota:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Z. Gashi, e diskutuam edhe në KPF këtë çështje, po në ndërkohë është e rregulluar me Ligj të planifikimit, nuk guxojmë me e quajtur dokumentin plotësimndryshim, por Plan zhvillimor komunal. Do të thotë është, kemi pyetur edhe në Ministri, është e rregulluar me Ligjin e ri të planifikimit, nuk ka plotësim-ndryshim, por Plan i ri zhvillimor komunal. Është e vërtetë që ne e kemi një Plan zhvillimor komunal, sa për sqarim, do të thotë zgjat deri në vitin 2022, është në fuqi, por për shkak të Hartës zonale jemi të detyruar me e harmonizuar Planin zhvillimor komunal me Hartën zonale, dhe për këtë arsye e kemi futur si pikë. Do të zgjatë 12 muaj, një proces që e kemi paramenduar, por jemi të obliguar me e zbatuar Udhëzimin administrativ, nuk ka mundësi me e quajtur plotësim-ndryshim.

**Kryesuesi:** Po, replikë, urdhëro!

**Agim Gashi:** GP i LDK-së nuk pajtohet me këto arsyetime, se edhe ne e kemi konsultuar ligjin, është e vërtetë që në ligj përmendet se komuna duhet të nxjerrë Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale, si dokumente obligative, por meqenëse Komuna e Prishtinës e ka pasur të miratuar një version të planit dhe është i plotfuqishëm deri në plotfuqizimin e versionit të ri, duhet të shkohet sipas rregullës për ndryshimin dhe plotësimin e planit përkatës komunal, zhvillimor komunal. Kjo është analogjikisht e njëjtë sikurse te ligjet që miratohen në Kuvendin e Kosovës, dhe asnjëherë nuk thuhet po nxirret një ligj i ri mbi bazat e një ligji tjetër, ku në aspekt përmbajtjesor janë identik plotësisht, por bëhet plotësim-ndryshimi, dhe mund të bëhet sa herë të ketë nevojë plotësim-ndryshimi. Edhe këtu po bëhet plotësim-ndryshimi, prandaj kjo është logjike dhe është edhe ligjore që të zhvillohet kjo procedurë të cilën ne po e kërkojmë, kjo është më mirë për Kuvendin. Unë nuk e di

kush është ai person që i paska dhënë këto udhëzime përfaqësues i MAPL-së, kjo është anomali në qoftë se ai është përgjigjur kësajsoj qysh po thotë drejtori.

**Kryesuesi:** Drejtor, a e deshe fjalën?

**Genc Bashota:** Vetëm një sqarim të shkurtër.

Nuk ka, kur të hartohet plani i ri, që ne po e quajmë plani i ri, kuptohet që do të jetë ndryshim i atij ekzistues, në përmbajtje po flas. Unë nuk mundem prej tani ta di që sa për qind do të ndryshojë, kurrkush nuk e di. E formojmë komitetin drejtues të ekspertëve, i cili merret me këto çështje, do të thotë një pjesë e atij plani mbetet dhe diçka ndryshohet, do të thotë është edhe hipotetike me iu treguar sa ka me mbetur i tillë dhe sa ka me u ndryshuar, nuk është as vendim i imi, d.m.th. përmbajtja është kjo, një ndryshim, mirëpo decidivisht po ju tregoj që udhëzimet që ne i kemi, duhet ta quajmë Planin i ri zhvillimor komunal.

**Kryesuesi:** Në rregull.

Fjalën e ka Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Unë kam një propozim, që pika e gjashtë "Propozimi për formimin e Komitetit për komunitete" të largohet nga rendi i ditës, për shkak të shkëlqes së Rregullores për procedurën e themelimit, pra me numër 01-110-273-423. Është shkëlqur rregullorja pasi që nuk është konsultuar askush me shefin e GP të LVV-së. Në bazë të arsytimit që e keni dërguar ju si kryesues i Kuvendit, thuhet se duhet të konsultohen me të gjithë shefat e GP-ve të secilit subjekt politik.

**Kryesuesi:** Vetëm një sqarim desha. Sa i përket anëtarëve të tjerë të komuniteteve pakicë, ata i kanë ndjekur procedurat që janë paraparë nga Komuna, sa i përket VV-së, kur të vijmë te pika e rendit të ditës, do ta propozoni tash, do të thotë se në komitet nuk e keni propozuar, kanë propozuar grupet tjera, e tash do ta propozoni ju kandidatin e juaj.

**Eman Rrahmani:** Grupet tjera i kanë propozuar më herët.

**Kryesuesi:** LDK-ja e ka propozuar, do të thotë dy partitë që janë më të mëdha i kanë propozuar, ju nuk e keni propozuar. Pra, tash kur të vijmë te pika e rendit të ditës e propozoni atë. Thjesht, nuk ka qenë propozimi i gatshëm në komitet e propozohet këtu.

**Eman Rrahmani:** Nuk është ftuar askush prej neve në komitet, as shefja e GP të LVV-së nuk është ftuar në komitet.

**Kryesuesi:** Jo, në komitet nuk ftohet shefja e GP-së, kanë qenë përfaqësuesit anëtarë të komitetit që janë zgjedhur në Kuvend, atëherë anëtarët e komitetit që janë zgjedhur, që janë propozuar dhe janë votuar këtu prej VV-së. Unë mendoj që ky duhet të jetë komunikimi, pastaj brenda grupit me shefin e grupit.

**Eman Rrahmani:** Jo, në qoftë se këtu shkruan se ju duhet të keni kontakt në konsultë me shefin e GP-së, unë mendoj që është përgjegjësi e juaja me pasur kontakt dhe me u konsultuar me shefen e GP-së, jo anëtarët e komitetit.

**Kryesuesi:** Në rregull, faleminderit!  
Fjalën e ka Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit!  
Përshëndetje për të gjithë!  
I nderuari kryesues,  
Të nderuar drejtorë,  
Kolegë asamblistë,  
Medie,

Fillimisht desha të ndërlidhem, ose të japë një sqarim lidhur me pyetjen e z. Rrahmani sa i përket anëtarit nga koalicioni, sepse në KPF është diskutuar që një anëtar do të jetë nga koalicioni ynë, d.m.th. në mes të LVV-së, AKR-së, Alternativës dhe AAK-së. Unë kam kërkuar në atë komitet që të dakordohemi, d.m.th. që para seancës, në këtë seancë me e propozuar një anëtar nga koalicioni, sepse kam menduar që shefat e GP-ve duhet të vendosin për këtë pikë, për atë nuk është propozuar anëtari prej koalicionit të lartpërmendur.

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka z. Shefqet Osmani.

**Shefqet Osmani:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam rreth rendit të ditës një propozim, te pika e nëntë "Pyetje dhe përgjigje", pasi që prej praktikave të mëparshme ekzekutivi deri në fund nuk po qëndron kurrë, kisha propozuar, në qoftë se jeni dakord edhe ju të tjerët, që pika e nëntë "Pyetje dhe përgjigje" të jetë si pikë e parë e rendit të ditës, pasi po mendoj që 80% e ekzekutivit është këtu, e ne zakonisht pyetjet dhe përgjigjen po i bëjmë në fund, por nuk po na përgjigjet kurrkush, sepse ekzekutivi nuk po qëndron. Andaj, do të ishte një praktikë e mirë që pika "Pyetje dhe përgjigje" me qenë ndër pikat e para, me na u përgjigj ekzekutivi për disa pyetje që i kemi unë dhe të tjerët.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Një prej arsyeve që kam insistuar që duhet Rregullorja e punës së Kuvendit me u ndryshuar, është pikërisht edhe kjo. Do të thotë se është logjike që fillimisht me qenë pika kur janë edhe drejtorët këtu, se unë, fundi i fundit, unë konsideroj që drejtorët nuk është e domosdoshme të gjithë me qenë këtu, sepse mund të kanë ndonjë punë më të rëndësishme diku tjetër, ndonjë takim ose diçka tjetër, por pikat që diskutohen e që kanë lidhje me atë drejtori, ata do të duhej të jenë patjetër, duhet të jenë patjetër prezentë gjithashtu edhe te pika "Pyetje dhe përgjigje". Prandaj është shumë më praktike që kjo pikë të jetë në fillim, dhe unë mendoj që në rregullore do të futet kjo.  
Faleminderit!

Fjalën e ka z. Nol Nushi.

**Nol Nushi:** Desha me u ndërlidhur me parafolësin, një propozim për këdo që futet në atë pjesën e rregullores. Kjo puna e pyetjeve dhe përgjigjeve, mendoj që kishte me qenë shumë e mirë që nëse pyetjet ose problemet konkrete të dorëzohen pak më herët te kryesuesi dhe kryesuesi ia drejton drejtorëve respektivë atë pyetje ose atë problem, në mënyrë që përgjigjet me qenë shumë më të sakta, sepse e dimë që është e pamundur secili drejtor në secilin moment me e ditur secilin detaj në komunë, dhe kjo kishte me e bërë debatin më konstruktiv, më falni, edhe nuk na kish humbur shumë kohë, kështu që ata që kanë me qenë pjesë e atij grupi, ju kisha sugjeruar me marrë përsipër këtë propozim. Mendoj që është ide shumë e mirë me u ndjekur praktika e Kuvendit të Kosovës, ku d.m.th. paraqiten pyetjen paraprakisht, dorëzohen me shkrim dhe përgjigjet merren në seancën e radhës. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Diskutime tjera?

Fjalën e ka z. Leutrim Retkoceri.

**Leutrim Retkoceri:** Faleminderit!

Përshëndetje, kryesues

Drejtorë dhe

Kolegë këshilltarë!

Unë fillimisht e mirëpres përmirësim dhe plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit, sidomos për rëndësinë që ka. Unë desha me u ndërlidhur edhe me atë që thatë se drejtorët kanë punë më të rëndësishme. Ta kemi parasysh se ne e kemi një seancë të rregullt për një muaj, dhe kjo seancë është shumë e mirëseardhur, mirëpo duhet të jetë i mirëseardhur edhe kryetari dhe të gjithë drejtorët në këtë seancë. Unë apeloj edhe te kryetari, sepse shumë pika me rëndësi nga kryetari i Komunës janë duke u injoruar, apo duke mos qenë prezent këtu po tregon edhe mos rëndësia e tij për punë të cilat janë me rëndësi në kryeqytet.

Kaq pata.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

A ka diskutime tjera?

Atëherë, e kemi një propozim nga GP i LDK-së, që të ndryshohet pika e dytë, ndërkohë që këtu e kemi propozimin që ka ardhur nga drejtorja. Unë do ta hedhë në votim këtë propozim të drejtorisë, sepse është me rregull që të hidhet propozimi i parë, dhe nëse nuk i ka votat, pastaj e hedhim edhe propozimin e dytë.

I lutem regjisë të përgatitet për votim.

Votohet propozimi zyrtar që është në rendin e ditës, po, pika e dytë, vetëm pika e dytë, se ka propozim për me u ndryshuar, kështu që propozimi nga drejtorja shkon fillimisht, propozimi zyrtar që ka ardhur.

Ok., janë dy propozime, do të thotë është propozimi zyrtar që ka ardhur nga drejtorja, që e keni në rend të ditës, dhe është propozimi i GP të LDK-së, për me ndryshuar këtë pikë të

rendit të ditës. Fillimisht hidhet në votim propozimi zyrtar që ka ardhur, d.m.th. prej drejtorisë.

Ok., nëse nuk i ka votat propozimi i drejtorisë, votohet propozimi tjetër.

Urdhëro, drejtor!

**Genc Bashota:** Faleminderit, kryesues!

Edhe një sqarim plotësues. Në vitin 2013, është miratuar Ligji i ri i planifikimit hapësinor, me numër 04-174, i cili decidivisht thotë që në nivelin lokal duhet t'i kemi tri dokumente të planifikimit: Planin zhvillimor komunal, për të cilin tash po diskutojmë, Hartën zonale dhe Planet rregulluese të hollësishme. Do të thotë, sipas nesh nuk ka ndryshim-plotësim, por ka hartim të dokumentit, që quhet "Plani zhvillimor komunal", i cili gjithsesi duhet të harmonizohet me Hartën zonale. Sa për sqarim, ju e keni dokumentin përpara, i keni hapat si do të kryhet kjo procedurë, diku rreth 12 muaj do të zgjatë, janë qëllimet e aktivitetit të gjitha të specifikuar me muaj, të gjitha janë njëjtë të harmonizuara me Udhëzimin administrativ, i cili ka dalë vitin e kaluar, kështu që kjo është e tëra. Çka desha vetëm diçka me specifikuar, do të thotë ne fillojmë me e hartuar këtë dokument në momentin kur e krijojmë një komitet drejtues dhe një grup punues. Komiteti drejtues do të jetë i përbërë prej ekspertëve jo vetëm të Komunës, por kryesisht nga jashtë, do të thotë prej ekspertëve të pavarur të fushave të ndryshme, është natyrë shumë komplekse dhe shumë specifike, ndërsa grupi punues do të jetë në Komunë, i përfshirë nga të gjitha drejtoritë, për arsye se jo vetëm Planifikimi, por edhe drejtoritë tjera duhet të përfshihen në hartimin e këtij dokumenti, diku 12 muaj zgjat, Harta zonale 18 muaj.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Po, urdhëro!

**Agim Gashi:** Ky ligj sjell të re vetëm Hartën zonale, ndërsa versioni paraprak i ligjit ka paraparë Planin zhvillimor komunal dhe Planin zhvillimor urban. Me daljen e versionit të ri të ligjit, eliminohet Plani zhvillimor urban dhe hynë Harta zonale, ndërsa Plani zhvillimor komunal mbetet po ashtu si version i qëndrueshëm i versionit të parë të ligjit. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Po, të lutem, z. Olluri!

**Ardian Olluri:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal,

Z. Gashi, kur patëm sjellë ndryshimet dhe plotësimet e planeve rregulluese ekzistuese, Ministria na pati thënë që dokumentet ekzistuese nuk mundeni me i ndryshuar, për shkak se neni 26 i Ligjit të planifikimit i ka lënë në fuqi derisa t'i nxirri dokumentet e reja të planifikimit, në harmoni me Ligjin e ri të planifikimit, dhe ju atëherë si grup i Kuvendit keni qenë shumë insistues që Ministria e ka mirë, edhe pse ne nuk ishim të pajtimit. Ne patëm vendosur ta respektojmë atë vendim dhe filluam t'i nxjerrim dokumentet e planifikimit sipas ligjit. Tash, Plani zhvillimor komunal ekzistues është nxjerrë në bazë të ligjit të vjetër, jemi duke nxjerrë një dokument të ri të planifikimit, i cili është i bazuar në

Ligjin e ri të planifikimit, ashtu siç na ka thënë Ministria atëherë, ashtu siç po thotë edhe tash. Pra nuk po e ndryshojmë dhe plotësojmë, për shkak se Ministria ka thënë nuk mundeni me ndryshuar dhe me i plotësuar dokumentet ekzistuese, sepse ligji i ka lënë në fuqi derisa t'i nxirrni dokumentet e reja të planifikimit.

**Kryesuesi:** Po, atëherë shkojmë.

Po, z. Halimi, urdhëro!

**Halim Halimi:** Është mirë që jemi këtu edhe përbërja e mëparshme, jemi një pjesë këtu. A është e vërtetë që ju keni pru plane rregulluese të hollësishme në Kuvend me i votuar pa hartimin e Hartës zonale? Harta zonale na është thënë që është gati, është çështje ditësh, është kah fundi, tash thuhet se po fillojmë hartimin e Hartës zonale. Ju sa herë na keni thënë edhe buxhet është ndarë për Hartën zonale, por Harta zonale nuk ka qenë kurrkund, e ju në mënyrë të dhunshme na i keni sjellë planet rregulluese të hollësishme në këtë Kuvend për miratim. Sa e sa herë ju kemi thënë që janë të kundërligjshme, dhe dolën që janë të kundërligjshme, sepse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor na i kthej që janë të kundërligjshme, a ju gjithëherë gojën plotë e keni pasur, jemi duke punuar në Hartën zonale, është çështja e Kuvendit, a ne tash veç po fillojmë. Kështu që nisjani prej ditës së parë, punoni në bazë të rregullores, në bazë të ligjit, në bazë të sugjerimeve të organeve qendrore, mos të themi na kanë thënë, ju kemi thënë, janë shkresat, i bëjnë drejtoritë, kryesuesi i Kuvendit shkresë Ministrisë, kërkojmë sqarime dhe ajo e Ministrisë mbetet, e jo sikur herëve të kaluara, jo ne nuk e dëgjojmë ministrinë e Bajram Gecit, jo nuk e dëgjojmë ministrinë e këtij, e këtij, e këtij. Kështu që unë po e shoh që e njëjta frymë, e njëjta punë qysh në fillim po donë me u bërë, kështu që ju kisha lutur, edhe për juve është mirë, edhe për neve, të zbatohet ligji. Atë që po e kërkon Agimi, derisa deri më 2022 e kemi Planin zhvillimor komunal e plotësojmë dhe e ndryshojmë, e jo, mos flisni veç paushall qashtu se nuk mundet. Unë po i shoh disa, nuk lexojnë hiq, veç thotë jo nuk mundet, po pse nuk mundet, bindëm ti mua, kërko prej Ministrisë atë që keni biseduar, ju ka thënë Ministria merreni shkresën, është dashur shkresën me e marrë dhe këtu me na thënë qe Ministria na ka thënë dhe ne ishim pajtuar.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Urdhëro, Leonora!

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Faleminderit, kryesues!

Unë thjesht kisha propozuar që të fillojmë sa më shpejtë me propozimin, me votimin e rendit të ditës, kështu që sa i përket mandej diskutimit për secilën pikë, d.m.th. i kemi pas aprovimit të rendit të ditës, kështu që kisha thënë që mos me humbur shumë kohë para se të votohet rendi i ditës.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Atëherë e hedhim në votim, siç thash, propozimin që ka ardhur nga drejtoria.



Regjia, të lutem bëhu gati për votim.  
Votojmë tash.  
Prezent janë 46 deputetë aktualisht.  
Atëherë për janë 27 vota;  
Kundër 13 vota;  
Abstenim 5 vota.  
Nuk kanë votuar 6 deputetë.

Konsiderojmë se miratohet ky formulim i pikës së rendit të ditës dhe tani e hedhim në votim rendin e ditës komplet, bashkë me propozimin që e dha z. Halimi.

Regjia, a jeni gati?

Shkojmë me votim, rendi i ditës komplet tash është.

Atëherë edhe njëherë, mos të regjistrohet ky votim.

Më herët e diskutuam, mirëpo para se me e hedhur në votim tash këtu që e hodhëm, e kërkuat fjalën për pikën e dytë, tash kërkoja me e votuar rendin e ditës komplet bashkë me propozimin e z. Halimi që për Grupin punues për hartimin e rregullores, ta fusim bashkë me plan të punës, d.m.th. me qenë si pikë e përbashkët, nuk pati diçka tjetër, ajo që në fillim veç u shty votimi për shkak të diskutimit.

A është e qartë tash?

Atëherë shkojmë edhe njëherë me votim.

Regjia, të lutem bëhu gati!

Shkojmë.

Atëherë për janë 43 vota;

Kundër 3 vota;

Abstenim 1 votë;

Nuk kanë votuar 4.

Faleminderit shumë!

**Konstatohet se është miratuar rendi i ditës.**

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Kryesuesi:** A ka dikush diçka lidhur me ekstraktin?

Atëherë regjia gati për votim.

Shkojmë.

Rezultatet janë këto:

Për, 42 vota;

Kundër, 1 votë;

Abstenim asnjë.

Nuk kanë votuar 8.

Faleminderit shumë!

Faqe 9 nga 71

**Konstatohet që u miratua pika e parë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi:** Shkojmë tutje.

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal “Prishtina 2018-2026”.**

**Kryesuesi:** Ftoj tash shefat e GP-ve ta marrin fjalën.

Fjalën e ka zonja Leonora Shabani-Bajraktari.

Nëse ka nevojë, ok. drejtorja gjithmonë nëse donë diçka e kërkon fjalën, po.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Ne si GP i LVV-së e votojmë dhe e përkrahim hartimin e Planit zhvillimor komunal për vitin 2018-2026.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka z. Halim Halimi, nga GP i LDK-së.

**Halim Halimi:** GP i LDK-së e ka analizuar këtë propozimvendim dhe qëndrojmë prapa asaj që e tha edhe z. Agim Gashi. Ne mendojmë se ky propozimvendim duhet të quhet “Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit zhvillimor të Komunës së Prishtinës prej vitit 2018-2026”. Mirëpo duke marrë parasysh Ligjin mbi planifikimin hapësinor, që është aprovuar në vitin 2013, qysh tha drejtori, në nivelin lokal duhet të nxirren këto dokumente bazike, d.m.th. Plani zhvillimor komunal, Harta zonale e komunës edhe Plani rregullues i hollësishëm. Meqë Kuvendi i Komunës së Prishtinës në vitin 2013, e ka miratuar Planin zhvillimor komunal për periudhën 2012-2022, i cili plan edhe sot e kësaj dite është në fuqi, ne kërkojmë që, kërkuam në realitet që të plotësohet dhe ndryshohet. Kështu që po të plotësohet dhe të ndryshohet ne do të ishim për, përndryshe me këtë titullim kështu: “Hartim i Planit të ri zhvillimor të komunës 2018-2026”, ne jemi kundër. Meqenëse këto dy pika edhe Harta zonale si dokument, në bazë të Ligjit mbi planifikimin hapësinor e kemi menjëherë. Unë mbetem prapa asaj që thash edhe më parë, që ne gjatë 4 viteve këtu gati jemi informuar që Harta zonale është në përfundim e sipër, tash na del se duhet të marrim vendim për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës. Atëherë kjo është shumë lehtë me ditur, sepse gjithmonë i kemi kundërshtar planet rregulluese që janë prurë për miratim në këtë Kuvend, në mungesë të Hartës zonale, me arsye se ligji e parasheh të kemi Hartën zonale, kështu që GP i LDK-së është kundër. Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Halimi!

Fjalën e ka z. Stavileci, nga GP i PDK-së.

**Blerand Stavileci:** Faleminderit, kryesues!

Faqe 10 nga 71

Të nderuar kolegë,

Ne edhe atë ditë diskutuam gjerë e gjatë në kuadër të takimit në KPF, i dhamë edhe atje disa mendime dhe sugjerime fillestare, po në të njëjtën kohë edhe sot Leutrimi, në emër të grupit, do t'i japë disa mendime dhe pastaj do ta bëjmë të ditur vendimin tonë.

Faleminderit!

**Leutrim Retkoceri:** Përshëndetje edhe njëherë!

Faleminderit, Blerand!

Ne e kemi analizuar fillimin e hartimit të Planit zhvillimor të komunës së Prishtinës, duke pas parasysh se është edhe një plan tjetër zhvillimor, kemi analizuar edhe kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve. Besoj se të gjithë jeni të njoftuar dhe keni pranuar me E-mail shqetësimet e qytetarëve për problemet që i kanë ata që nuk ju bëhen vizita nga drejtorët dhe nga kryetari i Komunës së Prishtinës, me gjithë promovimin që e bënte se do të jetë gjithmonë në kontakt me qytetarë. Ne para pak ditëve kemi pranuar një letër nga kryetari i Bashkësisë V lokale në Prishtinë, lagja "Veternik", aty thuhet se drejtorët e Komunës së Prishtinës nuk kanë qenë në vizita dhe as që i kanë përfillur kërkesat e tyre. Atje mungon Qendra e Mjekësisë Familjare, mungojnë shkollat, mungojnë edhe çerdhet, dhe nuk e di ne përderisa e kemi këtë injorim nga drejtorët dhe kryetari i Komunës së Prishtinës ndaj qytetarëve, për çfarë fillimi të hartimit të Planit zhvillimor duhet të flasim! Do të thotë, pikë së pari, këtu është duke munguar transparenca dhe është duke munguar diskutimi me qytetarët atje për të filluar ky plan. Nuk mundemi ne të ecim përpara duke i nënvlerësuar planet e kaluara dhe duke kërkuar plane të tjera, pa i përfillur dhe pa i dëgjuar qytetarët fillimisht. Këto janë, do të thotë ky është qëndrimi jonë dhe ky është vlerësimi, do të thotë në kontakt me qytetarët, dhe përderisa është kjo qasje, ne nuk do ta votojmë një fillim të hartimit të këtij plani me këto mangësi.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Atëherë fjalën e ka z. Bashota.

Edhe një sugjerim, ju lutem, kush donë ta marrë fjalën kur të hapen diskutimet për të tjerët, shtypeni pullën që të regjistrohet atje në regji.

Urdhëro, z. Bashota!

**Genc Bashota:** Vetëm një sqarim, të lutem, nuk mundet Plani zhvillimor komunal me filluar prej një situatë në Veternik, edhe një kërkesë të një banorit atje, a po kupton, do të thotë se qasjen e keni pak gabim. Dokument strategjik i cili, a ta përfundoj unë, i cili vlen 8 vjet, një numër i madh i ekspertëve, si e thash, të Prishtinës dhe jashtë saj marrin pjesë në këtë dokument. Kjo si e thoni ju, është me e kap për bishti njëfarë problemi prej një situatë në Veternik, është një çështje e cila do të inkorporohet në Planin zhvillimor komunal dhe në Hartën zonale, jo një të cilën e përmendet ju, unë nuk e di, por me qindra kemi, ta përfundoj. Nëse i analizon këto hapat, e shoh që ka diskutime publike, diskutimet publike në secilën fazë janë të përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ, do të thotë ju vjen koha kur edhe i takojmë ata qytetarë, jo vetëm ata, këtu ka shumë takime, dhe i dëgjojnë të gjitha

ato. Por nuk mundet, nuk mundeni me thënë që Plani zhvillimor komunal qysh po hartohet, kur dikush atje e ka njëfarë problemi, d.m.th. qasjen e ke totalisht gabim.

**Kryesuesi:** Po, replikë 2 minuta.

**Leutrim Retkoceri:** Fjalën që the që nuk e dini këtë problem, është realitet, sikurse që nuk i dini edhe shumë probleme të tjera të qytetarëve të Prishtinës, edhe do të thotë për me kapë prej bishtit, po besoj së pari po e kap ti këtë farë pune, se duhet me i takuar qytetarët dhe duhet me e hartuar këtë plan pak më mbarë. Të takon ty se e ke përgjegjësi, e unë e kam përgjegjësi këtu me i ngre shqetësimet e qytetarëve, të cilët na kontaktojnë dhe të cilët na kërkojnë me shumë ngulm, që me ua hapë sytë juve, sigurisht edhe në prezencë të mediave këtu, që ndoshta edhe juve tash ju pengojnë.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka z. Arben Vitia.

**Arben Vitia:** Faleminderit!

Unë nuk po dua me e zgatur, vetëm për sqarim. Leutrim, kemi qenë minimum dhjetë ose pesëmbëdhjetë dëgjime publike me qytetarët e Veternikut për lokacionin e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF). E dini që atje është e ndarë, disa rrugë në disa pjesë, ku secila pjesë ka kërkuar që QMF-ja të ndërtohet te pjesa e tyre, dhe për këtë arsye mos me u ngutur ne me e bërë një investim ashtu si të na teket neve, po e përsërisë prapë, minimum janë organizuar dhjetë, e sigurt edhe më shumë, dëgjime publike me qytetarët e Veternikut, që t'i marrim parasysh kërkesat dhe sugjerimet e tyre kur të bëhet ndërtimi i kësaj qendre. Kjo ishte sa i përket QMF-së, për të tjerat nuk jam kompetent, Leutrim.

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka z. Jonuz Salihaj.  
Regjia, të lutem!

**Jonuz Salihaj:** Faleminderit!

Një sqarim lidhur me këtë. Unë jam një kohë të shkurtër drejtor i Drejtorisë së Arsimit, i kam takuar me kërkesën e tyre, mundem me thënë para juve, një pjesë të banorëve të Bashkësisë V lokale të lagjes "Veterrniku", dhe i kam takuar nja tri herë, sa herë që kanë kërkuar ata, dhe i kam informuar se jemi veç me një problem të lokacionit për me u ndërruar dhe shkolla e re do të bëhet. Do ta bënë pjesa private e Bankës Botërore, do ta bënë një shkollë shumë moderne. Për çerdhe kemi problem me lokacion, sigurisht do të gjejmë edhe aty zgjidhje, por për shkollë ju garantoj, do të jetë një shkollë super moderne, e cila do të mirëmbahet nga ata që e ndërtojnë për 20 vjet. Do të jetë shkollë e ngjashme me Shkollën Model dhe Shkollën e Gjelbër, me të gjitha standardet evropiane.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me shefat e GP-ve se kemi mbetur në gjysmë.  
Fjalën e ka z. Fadil Gashi, GP i AAK-së.

**Fadil Gashi GP i AAK-së:** Edhe GP i AAK-së e përkrah këtë propozimvendim.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Atëherë fjalën e ka shefi i GP AKR, AA, z. Vesel Makolli.

**Vesel Makolli GP AKR, AA:** Edhe ne e përkrahim, meqenëse ndoshta është më mirë me u quajtur "Plani i ri zhvillimor komunal", pasi veç ekziston një plan, ndoshta është më mirë me u shtuar kjo parashtesa "-i ri".  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

E kisha kërkuar një shpjegim nga regjia, a është Eman Rrahmani i pari, apo Nol Nushi, se po më duket po lëvizin ato?

Është Nol Nushi, veç kur ta shtypni pullën mos e lëshoni, duhet me e mbajtur të ndezur.

Atëherë fjalën e ka Nol Nushi.

Mos e shtyp dy herë se e refuzon.

**Nol Nushi:** Veç një diskutim të shkurtër lidhur me ato shqetësimet e banorëve që komuna nuk i paska takuar. Parafolësi vetë tha se d.m.th. e ka marrë këtë nga raporti i IMPO-së, as vetë nuk i ka takuar do të thotë, dhe për mua është shpresëdhënëse nëse prej krejt takimeve që i ka mbajtur IMPO, ka dalë vetëm një problem në lagjen "Veterniku", kjo i bien që i paskemi punët shumë mirë, dhe duke i dëgjuar drejtorët, u pa që d.m.th. edhe ai problem paska me u zgjidhur dhe paska mbetur që veç me u caktuar lokacionet ku do të ndërtohet QMF-ja edhe shkolla. Përndryshe, vetë IMPO thotë që takimet kanë qenë totalisht joformale, me joformale takimi me qenë prej 1-100 persona, e me 100 persona nuk besoj që ka qenë, edhe sigurisht që krejt qytetarët e Prishtinës kanë shqetësime të ndryshme dhe nuk mundet asnjë plan me qenë perfekt, për bash secilin qytetar, ai nuk është plan pastaj, është plotësim dëshirash, e Komuna është këtu me bërë plane afatgjata, e jo me plotësuar dëshira. Gjithashtu, ju kisha lutur kolegëve shumë miqësisht dhe shumë kolegialisht, me qenë pak më konstruktivë, dhe duke e pasur parasysh pak edhe moshën, me e pru njëfarë fryme të re në këtë Kuvend, e jo me e bartur frymën e mandatit të kaluar.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Z. Leutrim, çka është, për çka po e kërkon fjalën? Replikë nuk ka të drejtë, jo tash por gjithmonë.

Po vazhdojmë, e kemi rregulloren, tash secili ka me thënë diçka për çka thotë tjetri, nuk pat, replika është e qartë, kur të përmendet emri, nuk u përmend emri, më vjen keq Leutrim.

Fjalën e ka z. Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit, kryesues!

Pak a shumë atë çka desha me thënë unë e tha edhe Noli. Parafolësi tregoi që nuk ka qenë në vizitë asnjëherë në atë lagje dhe është informuar përmes E-mailit, të cilin e kemi pranuar të gjithë, e kjo d.m.th. që kjo është veç një arsye për me folur këtu, me kundërshtuar diçka e jo që është vërtetuar. Ne e dimë të gjithë që ajo gjendje është për shkak, që tregoj edhe drejtori i shëndetësisë, por edhe të gjithë drejtorët tjerë, mirëpo ai me akuzuar një drejtor pse nuk ke shkuar në vizitë, pa qenë vetë asnjëherë në vizitë në atë lagje, po mendoj që është jo e shëndetshme me folur këtu para qytetarit.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka z. Rifat Deri.

**Rifat Deri:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës!

Atë çka e tha Arbeni në lidhje me QMF në pjesën e lagjes “Veterniku”, prej kah vij edhe unë, është më se e vërtetë. I kemi mbajtur disa takime, por problemin kryesor e kemi pasur, më sa e di unë, Arben, nuk mundeshim me gjetur pronë komunale për ndërtimin e QMF-së. I kemi mbajtur disa takime, nuk po e di a kanë qenë 10 takime a më shumë, por ka pasur mjaft banorë të asaj lagjeje që kanë marrë pjesë në ato takime dhe kemi shpreh shqetësimet tona në lidhje me atë se pse ajo lagje nuk ka QMF, pse nuk ka shkollë, pse nuk ka edhe një paralele të parashkollorëve. Por, më sa më kujtohet, gjithmonë ka qenë prezent edhe ish-drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës në këto takime, dhe tash duke u nis prej këtij plani edhe po mendoj propozimin për përmirësimin që e dha shefi i grupit tonë parlamentar për hartimin e Planit të ri zhvillimor të komunës së Prishtinës. Po besoj se në këtë plan të ri do të inkorporohen të gjitha kërkesat e banorëve të asaj pjese të Prishtinës, më sa e di unë, dje e kam pasur një takim blic me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, z. Arben Vitia. Arbeni më tregoi që është gjetur parcela dhe shumë shpejtë do të fillojë ndërtimi i QMF-së.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Urdhëro, Leonora!

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Për të gjithë qytetarët, sidomos për ata që na ndjekin online, LVV-ja nuk e ka në plan me votuar ndonjë plan, apo ndonjë dokument që nuk është në dobi të qytetarëve. Të gjitha ato plane që votohen nga LVV-ja, e kanë një qëllim për të mirën e të gjithë qytetarëve pa dallim, kështu që për këtë i siguroj të gjithë qytetarët se çdo gjë që votohet në Kuvendin Komunal të Prishtinës, do të votohet çdoherë në të mirën e qytetarëve.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit shumë, kryesues!

Për mos me u bërë i tepërt, pasi veç u hap kjo tema e lagjes “Veterniku”, po dua një koment. Pasi që veç u përmenden shumë sende prej kolegut të grupit, por edhe prej anëtarëve të tjerë, sa i përket QMF-së, kam edhe unë, banor i asaj pjese, dhe ka pasur në atë pjesë diskutime edhe me drejtorin edhe me banorët, dhe mendoj që në këtë fazë është përzgjedhur një nga hapësirat më të mira dhe me ideale për këtë lagje, e cila do t’i plotësoj nevojat e kësaj lagjeje sa i përket QMF-së, dhe aty është ndoshta që punët e mira duhet gjithmonë me u përkrahur dhe me u aplauduar. Në këtë rast, në fakt po e aplaudoj drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, sepse ka bërë një punë shumë të madhe në përzgjedhje, ose gjatë procesit, ku shumë shpejtë ka me filluar edhe puna, por në përzgjedhjen e lokacionit, është lokacioni më i mirë, më ideali për krejt atë pjesë. Lagjja “Veterniku” ka edhe shumë probleme të tjera, të cilat po besoj shumë që ne si përfaqësues mundemi me i ngritur te drejtoritë përkatëse, të cilat veç edhe kemi me i bërë. Unë e kam veç edhe një pyetje sa i përket Planit, te neni 6, për drejtorin Genc Bashota. Mjetet për hartimin e dokumentit të Planit zhvillimor komunal janë siguruar nga buxheti i komunës, po më intereson me e ditur orientimisht sa mundet me qenë kostoja e hartimit të këtij plani deri në përfundim, sa mundet me qenë kostoja komplet për hartimin e këtij plani?

**Kryesuesi:** Po, po presim përgjigjet.

**Genc Bashota:** Ok., më fal!

75 mijë i kemi të buxhetuara për Planin zhvillimor komunal, 100 mijë për Hartën zonale, sa ka me kushtuar nuk e di, por nuk do ta hedhim na në konkurs në tender krejt Planin zhvillimor komunal, do të thotë si të tillë me e punuar dikush. Do të krijohen disa grupe punuese, ku një pjesë të cilën e shohim që është racionale e bënë dikush, tjetrën e bëjmë në formë konsulence.

**Kryesuesi:** Po, urdhëro z. Vitia!

**Arben Vitia:** Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, Sami, për fjalët e mira, po unë nuk jam i bindur në fakt që e kemi zgjidhur lokacionin më të mirë. Vetëm ta shpjegoj, se e shpjegova në fillim që Veterniku është i ndarë me disa rrugë, të cilat e vështirësojnë qasjen e një pjese në pjesën tjetër, pavarësisht se ku bëhet. Kjo ka qenë një zgjidhje e zorit, po them sinqerisht, mirëpo në fund kemi rënë dakord edhe me qytetarët, me disa, jo me të gjithë, natyrisht, në këto diskutime që i përmendi Rifati, e përmendët edhe ju, që me ekspansionin e rritjes së popullsisë në atë pjesë, shumë shpejt do të ketë nevojë edhe për një qendër në pjesën tjetër, kështu që a jam i sigurt që e kemi zgjedhur lokacionin më të mirë, dorën në zemër, jo, sepse shumë qytetarë të asaj pjese do të mbesin të pakënaqur, mirëpo, prapë po e them, ka qenë një zgjidhje e zorit, duke u nisur edhe nga mungesa e tokës komunale, edhe duke u nisur prej faktorëve të tjerë të cilët na kanë pamundësuar me e gjetur një zgjedhje ideale për të gjithë qytetarët e asaj pjese. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka Burbuqe Hydaverdi, shefe e Sektorit për planifikim.

**Burbuqe Hydaverdi:** Faleminderit!

Sa i përket fillimisht emërtimit, d.m.th. plotësim dhe ndryshim, apo Plan zhvillimor komunal, sa për informatë, unë e kam këtu Planin zhvillimor komunal që është miratuar në vitin 2013, dhe është ende në fuqi, ka afat ndoshta edhe tri vjet apo tri vjet e gjysmë, por, në anën tjetër, në Hartën zonale të komunës duhet ta hartojmë në harmoni me Planin zhvillimor komunal. Nëse shkojmë me Hartë zonale, na mbeten edhe 18 muaj, d.m.th. na mbeten një vjet e gjysmë deri në miratim, atëherë do të mbetet një PZHK në fuqi, që e kemi vetëm edhe dy vjet ndoshta, ose më pak se dy vjet në fuqi, normalisht në nëse thirrëmi në Planin zhvillimor që e kemi në fuqi. Ndërsa sa i përket harmonizimit, qëllimi është harmonizimi i Planit zhvillimor komunal me Ligjin e ri të planifikimit, që me këtë ligj është vetëm strategji. Ne me këtë PZHK që e kemi në fuqi mund të lëshojmë edhe leje, ndërsa kur ta miratojmë Planin zhvillimor komunal, sipas Ligjit të ri, do të jetë vetëm strategji e komunës e cila do të përmbajë strategjitë e të gjitha drejtorive, do të thotë ato sektoriale qofshin ato të arsimit, ekonomisë, bujqësisë e të gjitha tjerat. Sa u përket edhe këtyre katër vjetëve sa ka qenë në fuqi, në si drejtori e kemi bërë një vlerësim të Planit zhvillimor komunal, ashtu edhe siç thuhet në Ligjin për planifikim, dhe sipas këtij vlerësimi ne e kemi pasur parasysh dhe e shohim të arsyeshme që duhet të bëhen disa ndryshime, sepse kemi ndryshime në terren. Është fjala për autostradën, kyçja në autostradë, të cilën Ministria e ka realizuar, d.m.th. pa përfillur planet tona që i kemi pasur në fuqi. Është vetëm një prej arsyeve që na duhet ta ndryshojmë, nuk duhet tash në një Plan zhvillimor, në të vërtetë një Hartë zonale ta hartojmë në bazë të atij Planit zhvillimor komunal që e kemi në fuqi, e në fakt gjendja faktike në terren është ndryshe. D.m.th. qëllimi i krejt kësaj është se ne po thirrëmi në emër, a ta quajmë si plotësim ndryshim, normalisht që pak ka me qenë plotësim ndryshim, nuk do me thënë që kemi me e ndryshuar në krejt Planin zhvillimor komunal që e kemi në fuqi, por kemi me shtuar strategji, prioritete, të cilat do të thotë do t'i kemi për 8 vitet e ardhshme. Në anën tjetër, ky vendim që do të dërgohet normalisht, nëse e shohim aspektin ligjor, ne kemi me e dërguar në Ministri për ligjshmëri, e në qoftë se ata e shohin që do të thotë është gabim, e keni quajtur Plan zhvillimor komunal, të cilin e keni në fuqi e tash po doni tjetër, atëherë ata duhet të vendosin për këtë punë, sepse ne deri këtu vazhdimisht kemi konsultuar Ministrinë e Planifikimit dhe gjithë këtë procedurë dhe këtë plan të menaxhimit e kemi bërë bashkërisht me ta, d.m.th. para se me e dërguar këtu në Kuvend, e kemi konsultuar dhe e kemi bërë këtë plan të menaxhimit të cilin e kemi pasur edhe pak si mostër nga Ministria e Planifikimit Hapësinor.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Replikë, z. Agim Gashi.

**Agim Gashi:** Jo replikë, po ...(jashtë mikrofonit) edhe drejtori se dhanë sqarime të mirëfillta, dhe se këto sqarime plotësisht janë në përputhshmëri me propozimin që na e dhamë, se krejt kjo punë që do të bëhet, do të jetë një plotësim-ndryshim i planit ekzistues, sepse kjo botë nuk do të fillojë prej ditës së sotme, por ka ekzistuar edhe më herët, dhe se



ne kemi pasur një qëllim shumë fisnik dhe të mirë në këtë që dokumenti të jetë vërtetë i nominuar ashtu siç bëhet ndryshimi, të jetë i përputhshëm, për arsye që me e shpreh një kulturë të vazhdueshme të këtij institucioni që po e bën, ose që e ka bërë prej kur është themeluar pas lufte. Dhe qeverisja është kulturë, nuk është përmbysje, është kulturë, vazhdon gjërat e këqija i eliminon, të mirat vazhdon t'i zhvillojë, dhe në këtë parim është bërë edhe propozimi i GP të LDK-së, sepse ne dëshirojmë të zhvillojmë një kontinuitet të punës së mirë që do ta bëjnë institucionet. Për atë që tha zonja për interpretimet e Ministrisë, po edhe atje mund të ketë juristë sikur këtu që po na japin këshillime nganjëherë të pabazuara, japin këshillime të pabazuara edhe nuk duan me e lodhur trurin fundamentalisht, por ja fut arave dhe thotë hajt bërë të ri se në rregull është kjo punë. Pra, nuk dëshiroj të ketë keqkuptime, se GP i LDK-së nuk është kundër këtyre ndryshimeve, kundër këtij dokumenti, por ky dokument me të vërtetë duhet të hartohet, sepse është dokument bazik, edhe mbi bazat e dokumentit paraprak, sepse aty është brumi, aty është themeli i krejt kësaj natyre.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Leutrim Retkoceri më duket ishte në listë, regjia, të lutem listën, po.

**Leutrim Retkoceri:** Faleminderit, kryesues!

Më në fund po e qoni drejtësinë në vend, me e sqaruar këtë punën që unë e ngrita se këtu disa kolegë tentojnë me i prapështuar gjërat. E kemi një letër, që e kemi pranuar me E-mail, ta kemi të qartë, drejtori Vitia e pranoi dhe e falënderoj për këtë korrektësi, ndërsa po e ndjej obligim që dy paragraf t'ua lexoj kolegëve këshilltarë. Do të thotë e kemi këtu një dokument, drejtuar nga kryetari i Bashkësisë V lokale, z. Deli Avdiu, edhe do të thotë veç ta lexoj se ju duhet për me e kuptuar, që do të thotë kryesia e Bashkësisë V lokale në Prishtinë, që nga viti 2014-2015 deri më sot, ka drejtuar në vazhdimësi

**Kryesuesi:** Leutrim, vetëm pak, të lutem, një sekondë.

Asamblisti ka 5 minuta të drejtën e fjalës, si e shfrytëzon është puna e tij, do të thotë është detyrë e jona tash me i duruar ato që nuk na pëlqejnë, 5 minuta i ka, i shfrytëzon 5 minuta si të donë.

**Leutrim Retkoceri:** Faleminderit, kryesues!

Do të thotë, kryesia e Bashkësisë V lokale në Prishtinë, që nga viti 2014-2015 e deri më sot, ka drejtuar në vazhdimësi kërkesa në Drejtorinë e Arsimit dhe të Shëndetësisë, përmes së cilave ka kërkuar ndërtimin e këtyre objekteve, të cilat janë me rëndësi jetike për qytetarët tanë. Vlen të ceket se deri më sot asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje në formë të shkruar për çështjen në fjalë nga drejtorët përkatës. Ka pasur premtime gojore, ceket në letrën e tyre, ndërsa kërkesa është shumë e qartë.

Të nderuar asamblistë, kemi provuar në të gjitha mënyrat e mundshme, format, me drejtorët përkatës për ndërtimin e objektit në fjalë, por nuk kemi arritur dot që kërkesat e qytetarëve t'i përmbushim, e vetmja shpresë për ne jeni ju, të nderuar asamblistë. Ne iu kemi drejtuar të gjithëve, unë e mora fjalën që ta ndërli dhi me pikën, i nderuari drejtor,

sepse citohet edhe emri i juaj, ta jap edhe letrën e shkruar, ndërsa, për sqarim, sa për qasjen që e patën parafolësit që mu citua në këtë pikë që e ngrita, se kush dhe çka ka sjellë model në institucionet tona, më së miri flet rasti i disa asamblistëve këtu, të cilët arrogancën, mos kulturën edhe sjelljet e dhunshme në politikë, i kanë kthyer në përditshmëri, por për fat të mirë, tani kjo po ju kthehet në mes veti dhe nuk e di se ku do të përfundojnë.  
Kalofshi mirë!

**Kryesuesi:** Ju lutem, vetëm brenda temës.

Fjalën e ka z. Adrian Olluri.

Ju lutem, veç një sekondë, veç një sekondë, ju lutem, vetëm ju përmbaheni pikave të rendit të ditës, ju kisha lutur të jemi më konstruktivë, t'u përmbahemi pikave të rendit të ditës, mos të përdorim fjalë ofenduese, ju lutem.

Urdhëro, z. Olluri!

**Ardian Olluri:** Z. Retkoceri, Kuvendi për momentin është duke e diskutuar pikën e rendit të ditës, inicimin e Planit zhvillimor komunal. Kur e ngritët si çështje, ju thatë që kemi një ankesë prej qytetarëve të Bashkësisë V lokale, edhe në atë ankesë thuhet që drejtorët nuk i kanë vizituar dhe nuk janë marrë me telashet e banorëve. Tash kur e more fjalën për herën e dytë, edhe gjatë diskutimit u vërtetua që drejtorët janë marrë me këto telashe të asaj zone dhe ka pasur përpjekje serioze me i zgjidhur dhe janë në proces të zgjidhjes së telasheve. Ajo që nuk po e kuptoj unë është, se nëse je duke e ngritur si çështje, si protestë e jotja personale pse nuk janë zgjidhur telashet e banorëve, po shihet që ka përpjekje me i zgjidhur telashet. Nëse e ke fjalën që është dashur që gjatë hartimit të Planit zhvillimor komunal me i konsultuar banorët, atëherë këtu me siguri është një keqkuptim, për shkak se jemi në fillim duke diskutuar vendimin për me e iniciuar hartimin, edhe ky vendim tek pika 8, neni 8 i ka edhe konsultimet publike, pra Drejtoria e Planifikimit që e ka propozuar këtë akt, nuk ka pasur autorizim me shkuar dhe me biseduar me askënd për hartim dhe për këtë proces, pa e marrë autorizimin prej Kuvendit. Sot Drejtoria e Planifikimit dhe Ekzekutivi i Komunës është duke kërkuar autorizim prej Kuvendit të Komunës që me filluar hartimin e Planit zhvillimor komunal, dhe gjatë këtij procesi me i konsultuar edhe banorët.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të gjithë asamblistët!

Po pajtohem me Ardianin, sot jemi duke diskutuar për Planin zhvillimor dhe nuk është në rregull kështu, dhe kur e ngrit një kërkesë të qytetarëve, me u munduar me përfituar kaq ultë politikisht, sepse vetëm sa po e zhvlerëson atë kërkesë të qytetarëve. Gjithashtu edhe unë kur e pash atë E-mail të raportit të IMPO-së, ku ishte një kërkesë e adresuar për disa drejtori, pata në plan që edhe vetë, ose e dija i sigurt që dikush nga grupi jonë ka me i adresuar këto te drejtorët, por jo menjëherë me tendencën me përfituar disa poenë politikë, ke mjaft kohë, i ke 4 vjet në Asamble, ke me pasur këso rastesh, ke me ngritur çështje sa të

duash, mirëpo mos i zhvlerëso kërkesat e qytetarëve, duke provuar me përfituar ca poenë të vogël politikë, se nuk në rregull kjo.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Fjalën e ka Kumrije Shabani-Ramadani.

Leutrim, të lutem!

Leutrim, të lutem!

Urdhëro, Kumrije!

**Kumrije Shabani-Ramadani:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje kolegë!

Unë kam disa pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, meqenëse kemi shumë ankesa prej banorëve, qytetarëve të Prishtinës. Vizitat mjekësore me terminë e kanë komplikuar shumë situatën, kështu që është ngarkuar shumë Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në këtë rast epidemie të gripit, në vend që t'u dalim në ndihmë qytetarëve 24 orë, është bërë me terminë, kështu që më së keqi kanë pësuar gratë shtatzëna, pleqtë dhe fëmijët. Pyetja e dytë është: Pse shtatzënat nuk marrin trajtim mjekësor në QMF, kur ka qenë gripi sezonal, por ato drejtohen te gjinekologu; a është këtu ikja e përgjegjësisë së mjekëve, apo është ndonjë leverdi e lidhur me ordinancat private? Pyetja e tretë është: Pse inspektorët nuk dalin në terren dhe të inspektojnë mjekët të cilët janë të lidhur me kompanitë farmaceutike, kështu që pacienti nuk e merr barin e kërkuar, mirëpo merr çka i ofron kompania?

Kaq për drejtorin.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Meqenëse është jashtë kësaj pike të rendit të ditës, për të qenë korrekt me rregulloren, jo se mund të hapen diskutime, por le të jetë te pika "Pyetje dhe përgjigje", ju lutem, jo se një lëshim me e bërë, po duhet vazhdimisht me lëshuar.

Faleminderit!

Fjalën e ka Shefki Gashi.

**Shefki Gashi:** Faleminderit, kryesues!

Edhe unë sigurisht këto fjalë që do t'i them, do të pritna sikur të tjerët, se kjo u bë model i edukatës këtu, por unë nuk do të merrem me këta këtu, ose me neve, por po më kujtohet thënia e La Fontenit "Se peshku priset në kokë e zbrazet në bish", unë nuk e di çka jemi duke bërë na këtu sot, kur njerëzit përgjegjës që kanë me i zbatuar këto sende çka ne i diskutojmë, nuk janë këtu. Kjo më së pari është nënçmim i kryesuesit që ia kanë bërë...(fjala nuk kuptohet), Ok. në mandatin e kaluar ka qenë kryesuesi tjetër, mandej është injorim total i neve si asamblastë, edhe tash flasim sikur kur nget lumit zbathur, qe dy orë ne nuk jemi kah bëjmë kurrgjë. E dyta, e dëgjova ankesën e Bashkësisë lokale, unë ju informoj juve, se edhe ju e dini të gjithë, se bashkësitë lokale nuk pranohen si institucione lokale që janë të parapara me Rregullore dhe Statutin e Komunës. Atje punohet në terren me komisar politik të VV-së, dhe bashkësitë lokale nuk janë kurrkund të konsultuara, absolut, kemi

qenë komisioni për zgjedhjen e kryetarëve për bashkësi lokale, para tri vite e gjysmë, vetëm një bashkësi lokale e kemi kryer atëherë, më nuk ka vazhduar puna e zgjedhjes së kryetarëve të bashkësive lokale, që do të thotë që atje është një papërgjegjësi totale. Prandaj z. kryesues, ty të dëshiroj sukses në punë, por të jesh pak më këmbëngulës, të jesh pak më parimor, t'i thërrasësh të bisedosh me ta, sepse kryetari ose nënkryetari, duhet me qenë të paktën ndonjëri këtu. Ne po flasim për gjëra që janë mjaft me rëndësi, tri dokumente që i ke sot, gjatë katër vjetëve nuk kemi pasur kurrë, dokumenti i parë është Plani komunal urban, Ok.; është Harta zonale, për të cilën jeni kokorizur që 4 vjet, e kemi, nuk e kemi, e kemi bërë, nuk e kemi bërë, sepse e kemi ditur të gjithë që nuk kanë bërë kurrë; është aprovimi ose raporti i buxhetit, nuk kemi raport të buxhetit që 8-9 muaj, e kanë shti buxhetin 4-mujor, edhe 4 mujorin e fundit edhe buxhetin e përgjithshëm për vitin 2017, e kanë pështjellë ta kanë pru ta kanë lënë në dorë qitu, edhe ti tash qaje kokën me këta. Unë mendova, kur e përmendi ky kolegu këtu, që me të vërtetë do të jenë serioz, edhe pse nuk besoj kurrë në seriozitetin e tyre, se nuk i lejon pamja, as mosha, as sjellja në qytet çfarë e bëjnë këta me Prishtinën e me Kosovën, a po kupton a jo. Prandaj, prapë po ju lus sikur fëmijë, që të jemi serioz, urdhëroni bisedoni me shefat e juaj, që të bien vendime serioze Kuvendi, e mos të bëhemi sikur në mandatin e kaluar, që nuk kemi bërë bash kurrë, nuk kemi me çka të krenohemi, me ato ngrëndreq kifile, me ata drej kungja, me to na ka shkuar një mandat. Prandaj, ju kisha lutur që të jemi më serioz, e keni...(nuk kuptohet) si në politikë, si në profesion, si në të tëra, e mosni veç me fyerje, sharje.

Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka Nol Nushi.

**Nol Nushi:** Edhe njëherë Komuna e Prishtinës, qysh thash, nuk është peshku i artë që i plotëson krejt dëshirat e qytetarëve të Prishtinës! Shumë mirë e cituan dokumentin aty, ku thoshin kemi kërkuar me na ndërtuar një shkollë e një QMF, dhe ato nuk janë ndërtuar, komuna nuk bën. Po a e dini për sa objekte, për sa shërbime ka nevojë qytetari sot, dhe sigurisht që Komuna me këtë pullë këtu qysh po e lëshojmë në mikrofonin, nuk mundet me e ndërtuar as spitalin, as objektet tjera të nevojshme, mos u bëni qesharakë, veç pak më serioz, veç pak më serioz dhe nuk i bëni këto diskutime, seriozisht, veç pak më serioz me qenë nuk i bëni këto diskutime. Nëse doni me mbajtur, mos më ndërprit, të lutem, nuk të ndërpreva, mos më ndërprit, të lutem! Nëse doni me u mbajtur në mend si asamblisti më qesharak, e ke të fituar qysh në seancën e dytë, sigurt dhe nuk ke konkurrencë, ka pasur shumë më shumë konkurrencë përpara teje, por nuk ke, definitivisht nuk ke. Edhe mundem me t'i rrahë shuplakat, se edhe ke qejf, por ke me u mbajtur në mend si asamblisti më qesharak. Nuk është mirë me u mbajtur në mend kështu si ngucakeq, është mirë me u bërë racional dhe i logjikshëm në kërkesa.

**Kryesuesi:** Të lutem, rreth pikës së rendit të ditës, po.

**Nol Nushi:** Nuk është fyerje me të thënë asamblist qesharak, në rregull, mua po më shtynë me qesh, në rregull. Është mirë me i lexuar rregullat, edhe për kolegen,

**Kryesuesi:** Ok. unë e dhashë vërejtjen, të lutem, Leutrim, veç ofendime nuk ka. 5 minuta i ka, ju lutem, veç pak, Leutrim, Leutrim.

**Nol Nushi:** Është mirë me i lexuar rregullat, dëgjo, mbaj shënime, mbaj shënime, të lutem, nëse mundesh,

**Kryesuesi:** Ju lutem, 5 minuta i ka, i shfrytëzon si të dojë, ofendimet nuk lejohen, këto janë rregullat.

**Nol Nushi:** Nëse është ofendim e tërheq, hiq problem nuk e kam, kërkoj falje, nëse është ofendim unë kërkoj falje tash, po nuk besoj.

**Kryesuesi:** Vetëm diskutoni me radhë, përmbajuni diskutimeve.

**Nol Nushi:** Atëherë kështu, edhe njëherë, kryesues në rregull, edhe për anëtarët tjerë të grupit që ngrisin, është tema për lisa, ata flasin për fshesa, nuk është në rregull! Sapo e votuam rendin e ditës, nuk bënë që në pikën e rendit të ditës "Plani zhvillimor komunal", ne me fol a ka barna në QKMF dhe qysh ia kanë dhënë një bar gabim, nuk ka hiq lidhje me këtë temë, veç mos ta humbim kohën kot, jemi ardhur me i kryer do punë të mira, dhe nuk është fer veç me fol apo e dinë, pak më racionalisht, me mujt ju kisha tregu, por nuk mundem me gjasë, ju tregon tjetërkush. Edhe diçka

**Kryesuesi:** Leutrim, të lutem, mos se duhet me ndërmarr masa, Leutrim, veç një sekondë. Nol, Nol, të lutem! Leutrim, nëse vazhdon kështu, më duhet me e zbatuar nenin 8, të lutem, nuk ke të drejtë me fol pa e marrë fjalën, të lutem, është rregull, është rregull, ekziston e drejta e replikës nëse ta përmend emrin, përndryshe edhe ju e morët fjalën, patët fjalë të njëjta për palën tjetër, ofendime nuk duhet me pasur, 5 minuta i keni në shfrytëzim, i shfrytëzim i si të doni, është çështje çka doni me transmetuar te publiku dhe publiku e vlerëson çka thoni, por nëse ndërhyini dhe nuk e pritni fjalën, më besoni se duhet me e zbatuar nenin 8 të rregullores, e dini të gjithë çka ka neni 8, të lutem.

**Nol Nushi:** Lidhur me parafolësin, shumica e këtij grupi që jemi ulur këtu janë asamblistë për herë të parë, dhe nuk jemi hiq të interesuar me vazhduar atë që ka ndodhë në mandatin e kaluar, për dallim prej jush. Nëse kurrgjë bash nuk kemi bërë, i bie që veç i kemi ndërruar vendet këtu në ulëse, që mendoj që është vendimtare për sukseset e mandatit të kaluar, se përndryshe ishim kanë andej dhe ish kanë dikush tjetër aty ulur. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka Ardian Berisha.

**Adrian Berisha:** Përshëndetje të gjithëve!  
I nderuar kryesues,

Të dashur kolegë dhe kolege,  
Duke sugjeruar me vazhduar me fol për temën që kemi ardhur sot, rendin e ditës, isha ndalur në dy pika, që nuk po kam qare pa i diskutuar. Zonjës kolege i kisha sugjeruar me shkuar një ditë në QKMF dhe një ditë në QKUK dhe me pa d.m.th. dallimin si dita me natë që është, kurse z. Gashit i kisha thënë me vizituar Bashkësinë lokale në Dardani, është e menaxhuar prej z. Safet Kamberit, i cili është anëtarë i LDK-së, edhe me pa që nuk janë vetëm komisarët e LVV-së që bëjnë presion dhe janë stopus të proceseve në bashkësi lokale. Po ashtu, i kisha sugjeruar mos me qenë paragjykues sa i përket moshës, gjinisë, racës, sepse është shumë keq në vitin 2018 me qenë kjo.  
Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka Kumrije Shabani-Ramadani.  
Replika është 2 minuta, ju lutem!

**Kumrije Shabani-Ramadani:** I nderuari koleg, unë jam çdo ditë në QKUK dhe çdo ditë jam me qytetarë në QKMF, dhe këto janë vetëm ankesat e qytetarëve të Prishtinës, kurr gjë tjetër, nuk dua për kurrkënd me paragjykuar, vetëm se janë disa ankesa nga qytetarët e Prishtinës.

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Sami Boroci, keni diskutuar një herë. Veç edhe diçka, ju lutem, për një çështje diskutoni vetëm njëherë, ju lutem, i përmbaheni rregullave, se me nis kështu diskutimet shkojnë pa fund.  
Faleminderit!  
Atëherë shkojmë me votim.  
Regjia ju lutem përgatituni për votim.  
Votojmë pikën e dytë të rendit të ditës "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal".  
Gjithmonë shkon propozimi zyrtar i pari.  
Votojmë tash.  
Të pranishëm janë 47 deputetë.  
Për janë 27 vota.  
Kundër janë 18 vota.  
Abstenime nuk ka.  
Nuk kanë votuar 6.  
Faleminderit shumë.

**Konstatohet që miratohet edhe kjo pikë, pika e dytë e rendit të ditës.**

Shkojmë tutje.

**Pika e tretë**

## **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të Komunës së Prishtinës 2018-2026.**

**Kryesuesi:** Drejtor a keni?  
Po, të lutem!

**Genc Bashota:** Faleminderit, kryesues!

Atëherë, sa për sqarim, dokumenti i nivelit të dytë të planifikimit, pas Planit zhvillimor komunal, është Harta zonale, të cilën ne po e qesim sot në propozim për inicimin e hartimit të Hartës zonale. Sa për një sqarim paraprak çka u diskutua këtu, do të thotë Udhëzimi administrativ për normat teknike të planifikimit ka dalë vjet në gushtë, do të thotë pyetja pse nuk është hartuar Harta zonale deri sot, sa për një sqarim, ndërsa udhëzuesi për hartimin e Hartës zonale ka dalë tash në muajin shkurt. Gjatë krejt kësaj kohe, veç po dua me ju garantuar që nuk kemi humbë kohë si Drejtori e Planifikimit, edhe e Urbanizmit, se kjo ka filluar qysh në kohën kur drejtorja ka qenë e përbashkët Urbanizëm dhe Planifikim, do të thotë janë kryer të gjitha incizimet gjeodezike, janë kryer të gjitha identifikimet e pronave komunale që nuk kanë qenë të identifikuar, është databaza, është databaza tashmë e të gjitha pronave komunale. Është bërë identifikimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore, KEDS, KOST, PTK, Termokos, Ujësjellës dhe, në fund, tash jemi duke e përfunduar analizën e banimit, që është një dokument shumë i rëndësishëm, jemi në fund të atij procesi. Do të thotë, hartimi i këtyre dokumenteve apo krijimi i këtyre databazave ka zgjatur diku 2 vjet, një numër i madh i të rinjve, i praktikantëve, disa prej këtyre organizatave të huaja që na kanë ndihmuar edhe financiarisht DEMOS-i, RUSP-i kanë kontribuar në këtë drejtim, dhe besoni që nuk po dua me bërë reklamë, por me të vërtetë këtu është bërë një punë shumë e madhe, për me mbërrirë në këtë fazë në të cilën tash jemi. Ky është fillimi i hartimit të Hartës zonale, pra, sa për sqarim, që u keqkuptuam që ne nuk paskemi bërë Hartë zonale që tri vjet, apo nuk paskemi bërë asgjë në këtë drejtim. Sido që të jetë, do të thotë jemi në këtë situatë që sot para jush e kemi propozuar hartimin e Hartës zonale, njëjtë edhe këtu si në Planin zhvillimor komunal, e keni dokumentin me të gjitha hapat që e përcaktojnë këtë proces, i cili do të zgjatë 18 muaj, edhe njëjtë është sipas Udhëzimit administrativ të ministrisë i harmonizuar me atë siç e përcakton ligji.

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. drejtor!  
Tash shkojmë me shefat e GP-ve.  
Leonora Shabani-Bajraktari, GP i LVV-së.

**Leonora Shabani- Bajraktari:** LVV-ja e përkrah fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës.  
Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Z. Halim Halimi, GP i LDK-së.

**Halim Halimi:** GP i LDK-së e përkrah fillimin e hartimit të Hartës zonale, por me dilemat që që 3-4 vjet na është thënë që Harta zonale veç ka përfunduar, dhe me vërejtjet të cilat

në këtë kuvend në mënyrë të dhunshme janë sjellë plane rregulluese pa Hartë zonale për me u miratuar. Dhe, gjithëherë kemi thënë që ato plane janë të kundërligjshme, kanë dalë që janë të kundërligjshme, në bazë të shkresave dhe vendimeve të Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por meqë nuk kemi pasur Hartë zonale asnjëherë, se ligji për planifikim hapësinor e parasheh, për këtë ne jemi, e përkrahim hartimin e Hartës zonale për komunën e Prishtinës.

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Halimi!

Z. Blerand Stavileci, GP i PDK-së.

**Blerand Stavileci:** Faleminderit edhe një herë!

Meqenëse edhe kjo pikë hyn pothuajse në të njëjtën natyrë të punëve të cilat do të bëhen në të ardhmen, ne do të donim që sikurse edhe për pikën paraprake, edhe për këtë t'i përmbahemi në radhë të parë afateve kohore edhe në bazë të ligjit, po që të ketë edhe një transparencë në raport me ne dhe me qytetarët. Unë edhe atë ditë në mbledhjen e KPF-së kërkova që, ndoshta, megjithëse këtu kemi një matricë të mirë, ta kemi të zbërthyer edhe në formën e një diagrami të një gantogrami, në mënyrë që ta shohim në secilën fazë se ku është. Dhe tjetra, që diskutimet që i bëjmë ne edhe në cilësinë e kryesuesve të GP-ve, por edhe të gjithë deputetët, përderisa tangjentojnë me temën, edhe nëse dikujt mund t'i duket që nuk kanë të bëjnë me temën, po kanë të bëjnë, sepse shqetësimet që u ngritën edhe më herët nga kolegja që kishin të bënin me fushën e shëndetësisë, mund të jenë, nëse asgjë tjetër, edhe pse të gjitha ishin të rëndësishme, një imput me rëndësi edhe për vetë drejtorin, sepse ndoshta nuk ka pasur informatë, p.sh. për çështjen e shtatzënave, edhe në bashkëpunim atje edhe me nivelin qendror, por edhe me bashkësitë lokale edhe me të gjithë, ta gjejmë një zgjidhje të mirë. Ideja është që të konsultohemi sa më shumë, ideja është që secila vërejtje dhe ankesë të shqyrtohet, nëse ka hapësirë për t'iu dhënë përgjigje pozitive i jepet, nëse jo, duhet të dihet se pse nuk bëhet ashtu, dhe mendoj që në këtë mënyrë edhe bëhet një plan i mirë, po edhe deri në maksimum, pra, inkorporohen qoftë edhe ato që dikush mund t'i cilësojë si dëshira të qytetarëve. Përderisa ato kanë bazë, nuk janë vetëm dëshira, janë më shumë se kaq, përderisa nuk kanë bazë, ju tregohet se pse, dhe besoj që as këtu në kuvend, as në ekzekutiv, as atje te bashkësitë lokale, as te qytetarët nuk do të ketë vërejtje të tjera dhe do të jenë në një masë të caktuar të kënaqur. Kështu që, mendoj që po e them, po marr pak nga leksioni i asaj që u fol deri tani për pikën e dytë, po edhe për këtë pikë, besoj që mos ti përsërisim ato, dhe përderisa jemi brenda materies që e diskutojmë është në rregull. Edhe nëse ka pyetje dhe diskutime periferike, pse jo, nëse janë në dobi të temës, në momentin që kalohet në arenën tjetër të gjuhës politike, atëherë do t'ia kthejmë jo me të njëjtën masë, por dyfish më shumë.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Z. Fadil Gashi, GP i AAK-së.

**Fadil Gashi:** Faleminderit, kryesues!

Edhe GP i AAK-së e përkrah fillimin e hartimit e Hartës zonale.

Faleminderit!



**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Z. Vesel Makolli, GP i AKR-së, AA-së.

**Vesel Makolli:** E përkrahim fillimin e hartimit të Hartës zonale.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
E hap diskutimin.  
Fjalën e ka Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** E kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit. Vitin e kaluar janë planifikuar 250 mijë euro për Hartën zonale, kurse tash më sa e dëgjova më herët, e tha diku 100 mijë euro, nëse nuk gaboj, janë të planifikuara për Hartën zonale, dhe e përgëzoj për këtë minimizim të kostos. Kisha pas qejf me e ditur ndonjë arsye se pse vitin e kaluar janë paraparë 250 mijë, kurse këtë vit 100 mijë euro. Dhe tjetra: A parashihni probleme që ka me pasur për shkak të zhvillimit të debateve me qytetarë, Plani zhvillimor komunal dhe hartimi i Hartës zonale, në të njëjtën kohë mos është pak i pamundshëm organizimi i kaq shumë tubimeve me qytetarë, kur dihet se zakonisht edhe pjesëmarrja është shumë e vogël?

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Urdhëro, drejtor!

**Genc Bashota:** Faleminderit, Eman!  
Buxheti sivjet është më i vogël, për arsye se këto çka i përmenda, sidomos incizimet gjeodezike kanë qenë të kushtueshme, ato kanë përfunduar, do të thotë ato kanë qenë në atë 250 mijë euro që e përmendët, edhe disa të tjera, incizimet për vitin e kaluar a? Në realitet është e pamundshme, nuk e di raportin, po munden me qenë në procedurë e nuk kanë hyrë në evidencë, a po kupton, sido që të jetë. Përndryshe, sa i përket diskutimeve publike d.m.th. na e shohim diçka që mundemi me realizuar për PZHK edhe për Hartën zonale, për arsye se, në të kundërtën na bie me e zgjatur këtë proces në mënyrë të pafund. Do të thotë ne jemi shumë të disponuar me iu përmbajtur kësaj çka e kemi prezantuar, për 18 muaj me nëse mundemi me e përfunduar Hartën zonale, se edhe ashtu, siç e dini, qyteti ka shumë probleme me planifikim dhe nuk mundemi me e qar më larg.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Diskutues tjerë nuk kemi.  
Atëherë e hedhim në votim.  
Regjia, ju lutem, gati.  
Kush është për?  
Kush është për nuk ka nevojë tash.  
Ju lutem votoni.  
Faleminderit!

Atëherë, më 45 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, dhe 6 që nuk kanë votuar, miratohet Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës.

**Pika e katërt**

**Raporti financiar buxhetor (TM 4), janar-dhjetor 2017.**

**Kryesuesi:** A do, nëse je i interesuar mundesh me marrë fjalën.

**Ismail Kokaj:** Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Pasi kam qenë pjesë e këtij raporti, shfrytëzova rastin me e vazhduar leximin e këtij raporti, mirëpo pa dashur me e zgjatur, e kam lëshuar mikrofonin më duket. Raporti është dorëzuar para 30 janarit të të gjithë asamblistët. Buxheti i planifikuar për vitin 2017, ka qenë 62 milionë, 8 milionë e 700 mijë ka qenë bartja, gjithsej buxheti 70 milionë. Shpenzimet e këtij buxheti për vitin 2017, kanë qenë 56 milionë e 684 mijë, realizimi në përqindje është 80.1. Viti 2017, ka qenë, mund ta quaj si viti i të hyrave, ku prej planifikimit 24 milionë e 607 mijë, është realizuar 24 milionë e 533 mijë, në përqindje i shprehur 99.7%. Detajet e mëtutjeshme janë në kronologjinë e tabelës të cilën e keni përpara, ku nuk kisha mundur me i lexuar secilën një nga një, mirëpo është një raport, që me siguri deri tash veç e keni shfletuar.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor!

Atëherë vazhdojmë me GP.

Shefja e GP të LVV-së, Leonora.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Unë ia kaloj fjalën Eman Rrahmanit.

**Kryesuesi:** Ok. Faleminderit!

Fjalën e ka Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit!

Raporti financiar statikisht është në rregull, mirëpo ajo çka ne kërkojmë si LVV, është që ky raport na ofroi informata të hollësishme se si janë shpenzuar, ose pse nuk janë shpenzuar. Shihet këtu qartë në raport se në shumë sektorë nuk janë shpenzuar mjetet të cilat janë parashikuar, andaj nuk ka asnjë shpjegim pse nuk janë realizuar, ose edhe kur janë tejkuluar të hyrat të cilat janë në buxhet. Tjetër problem është, që i kemi këtu në fund, detyrimet e Komunës, ku janë mbi 255 lëndë në gjykata, të cilat, më sa e kuptova unë, janë të humbura në shkallën e parë. Vlera vetëm e këtyre që janë paraqitur në këtë raport është 6 milionë e 180 mijë e 289 €, nuk kemi asnjë shpjegim se pse janë humbë këto lëndë, pse i kemi humbur këto raste në gjykatë. Ajo çka po dua me thënë është, që është mirë që buxheti të shtyhet për votim për seancën e ardhshme dhe të na ofrohet një raport i qartë i të gjitha

shpenzimeve se si janë bërë, ku janë bërë, ose e të hyrave që nuk keni mundur me i inkasuar. Atë çka po shoh unë këtu, nuk është një raport shumë i shpjeguar.

**Kryesuesi:** Po, po, duhet, lirisht.

**Ismail Kokaj:** Ky është një raport i cili e përcakton gjendjen faktike, për pyetjet mundeni me i bërë paraprakisht në drejtorinë përkatëse, është edhe më herët janë informatë në uebsajd, mundeni edhe përmes Drejtorisë së Financave me ardhur me pyet, në këtë rast me shkuar me i pyetur, edhe me e marrë informatën para se me ardhur këtu. Sa i përket votimit, raporti është vetëm informatë, është një diçka që ka ndodhur, është votuar apo nuk është votua, nuk kisha thënë me e shty. Është diçka që ka ndodhur, është informatë që duhet me e sjell në Kuvend, mirëpo prapëseprapë këto informata janë edhe në uebsajd, se edhe më herët është diskutuar pse mos me u votuar, pse me u hedh në votim, edhe në mandatet e kaluara, nëse nuk gaboj.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Po, replikë a, po, ke të drejtë në replikë, veç mua më duhet për shkak të kohës me e bërë 2 minuta.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit!

Po besoj që të paktën ne si asamblistë nuk mundemi me shkuar te 12 ose 13 drejtori, te secila me kërkuar për secilin detaj, informata se si janë shpenzuar, ose pse nuk janë shpenzuar këto. Besoj që raporti kishte me qenë i mirë, sikur të kishte qenë i plotësuar në detaje, që të jemi të gjithë të informuar se çka ka ndodhur gjatë vitit 2017, cilat investime janë në procesim, cilat kanë dështuar për shkak të arsyeve të ndryshme, edhe pse po mendoj se kishte me qenë shumë më e mirë për transparencë edhe për gjithçka.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Z. Halim Halimi,  
Ok. Sokol Havolli.

**Sokol Havolli:** Faleminderit shumë!

Tash po shpjegohet në bazë të këtij raporti, në fakt edhe pse kryetari i Komunës nuk është sot këtu, sigurisht ndihet i turpëruar çfarë raporti ka pru në asamble dhe çfarë raporti donë me e publikuar dhe me e dërguar në Ministri. Ky nuk është raport, në fakt është një vepër qesharake, kjo nuk ka të bëjë hiq fare me raport financiar. Ligji është shumë i qartë, pika e parë, ku jep 30 ditë afat pas përfundimit të periudhës raportuese që t'i dorëzohet Kuvendit, pika e parë, menjëherë tejkalohe ky afat. Hajde nuk është kiameti më i madh që është tejkalu për rreth një javë, mirëpo në ligj janë të paraqitura edhe kriteret se çka duhet me përmbajtur një raport tremujor financiar. Ne e kuptojmë çka është buxheti dhe çka është pasqyra financiare, edhe raporti natyrisht se duhet me i përmbajtur ato tabelat kryesore, dhe është gjendje faktike, mirëpo ato kërkojnë shpjegime, ato kërkojnë edhe analizë,

gjithashtu kërkojnë diagnostifikim të gjendjes se pse ka ardhur deri te ajo. Gjithashtu edhe në fillim të raportit, sepse është raport i kryetarit, duhet të merret parasysh, në fillim thuhet se është mbërri 99.7%, 150% është mbërri në njëren kategori, 50% në kategorinë tjetër, kjo nuk ka të bëjë me planifikim financiar fare, hiq, kjo në fakt tregon paaftësinë më të madhe në mungesë të kapaciteteve planifikuese. Nuk ka mundësi në njëren kategori të shkoj 150%, e 200% të planifikimit, e në tjetrën kategori të jetë 0, nuk ka mundësi. Tani lidhet kjo edhe me debatet tjera, inspektorati 0 gjoba ka të planifikuar, 0 gjoba ka të realizuar, dhe dalim ne flasim këtu për çështjen e ajrit, të ambientit e krejt këtyre temave. Pra, është raport jashtëzakonisht qesharak dhe nuk i ka shpjegimet, përkundër faktit që synimi juaj ishte me e arsyetuar atë, mirëpo këtu kërkohet në ligj drejtpërdrejt që raporti mbi të ardhurat edhe shpenzimet, ta ketë mbishkrimin, mbi shikimin, më falni jo mbishkrimin, pra mbi shikimin, pra një overvju, një analizë i bie, një komentim të atyre numrave, se ata numra janë, përndryshe kishin thënë veç gjuani tabelat dhe nuk ka nevojë kurrfarë komentimi. Por komentimi kërkon, kjo analiza, mbishikimi kërkon që të komentohen të hyrat, shpenzimet, deficitit, po ashtu është kërkesë eksplicite që të bëhet krahasimi me dy vitet paraprake, dhe nuk është askund me dy vitet paraprake, se nëse hyjmë në detaje teknike me komentuar këtë raport, po ashtu del qesharake, sepse nuk e ka një standard. Hyni në disa raporte të vitit 2007, ose 2006, para 10-12 vjetëve në Ministri të Financave dhe këqyrni qysh përgatitet një raport, para 10-12 vjetëve në Kosovë përgatitet një raport se më vitin 2018 në Komunën e Prishtinës, që duhet me qenë model për krejt komunat tjera. Kjo do të thotë, unë jam befasuar dhe në fakt sot unë e kuptoj pse nuk është kryetari këtu, pra, sot e kuptoj pse nuk është kryetari këtu, sepse ky nuk është raport. Pastaj, kur të hyjmë me i komentuar zërat konkretë, shohim, do të thotë që është e vërtetë realizimi 99.7%, 150% në disa kategori, 20-30% në kategoritë tjera, dështim total në planifikim, pastaj te shpenzimet kanë qenë shumë të kujdesshëm me i realizuar shpenzimet në mallra dhe shërbime; në qiramarrje të automjeteve, kemi pasur 4 vjet zhurmë për një automjet Audi Q7, që e ka pas vlerën 70 mijë euro dhe është shitur me 20 mijë euro, d.m.th. humbje prej rreth 30-40-50 mijë, hajde dhe amortizimi i saj, të vlerës së pasurisë së Komunës për shitjen e automjetit. Sot Komuna e Prishtinës paguan 80 mijë euro qira vjetore për automjete, i kemi shpenzimet e reprezentacionit, që janë shumë të larta, i kemi shpenzimet e të gjitha kategorive tjera të luksit, mallra dhe shërbime, që janë d.m.th. në gjendje në realizim 100%, aq sa i kanë planifikuar, cent më cent i kanë harxhuar. Kur vjen çështja te zhvillimi i Komunës së Prishtinës, te investimet kapitale, te kategoritë që janë qenësore për infrastrukturë, për jetën e qytetarit, për gjelbërimin, për të gjitha këto, atëherë ne biem menjëherë në 50% të realizimit. Është e tepërt me komentuar më tepër këtë raport, sepse ka të meta në secilën kategori, po madje është e tepërt të quhet edhe raport, sepse është një vepër e cila na ofendon neve të gjithëve këtu si asamblastë, dhe unë shumë sinqerisht, shumë sinqerisht po shpresoj që ky raport ka me iu kthyer me votë kundër, përfshirë edhe prej kolegëve tanë të LVV-së, sepse nuk bën me u ofenduar asamblasti, qytetari, ky Kuvend komunal me një raport të tillë, duhet me e kthyer këtë kundër, gjithsesi, dhe duhemi me treguar, duhemi me...(Fjala e pa përfunduar). Raporti financiar mundet me qenë një prej dokumenteve më të lehta, po më lëni një javë kohë, ta përgatis një raport financiar më të mirë se sa kjo që sigurisht ju ka marrë nja 2 muaj kohë juve me e përgatit, veç një javë kohë duhet me e përgatit më të mirë. Unë e di që ka aty statistika, tabela e krejt, mirëpo tri fjali edhe në

fund, madje në titull thotë Raporti financiar (TM4) 2017, për Kuvend, i lekturuar. Nuk është as i lekturuar dhe deri këtu do të thotë shkon ofendimi me këtë raport, ndaj të gjithë neve çka jemi këtu, nuk është as i lekturuar. Mua po më vjen shumë keq që po shprehem në këtë mënyrë, por është e tepërt të hyjmë dhe t'i komentojmë zërat buxhetor, qoftë në shpenzime, qoftë në të hyra, qoftë edhe në çështje shumë shqetësuese, që e ngriti kolegu nga LVV-ja, sa i përket lëndëve gjyqësore e kështu me radhë. Është e tepërt të hyhet të komentohen këto, kur do të thotë ka 0 informacion, janë disa numra të paraqitur si fotografi, jo as si tabela. Na duhet me marrë me i bërë disa analiza tjera, neve na duhen edhe në formë tabelare, na duhet me i nxjerrë disa përqindje, sa për qind është realizuar një kategori, sa për qind një kategori tjetër, asnjë prej këtyre nuk janë bërë. Unë shumë sinqerisht shpresoj që ne si Kuvend komunal, bashkë do t'ia kthejmë këtë raport, nuk do ta votojmë, se po të isha në vend të ekzekutivit, mua më kishte ardhur turp me e dërguar madje edhe deri në Ministri të Financave, se le më që e kemi pa mjaftueshëm 40-50 persona këtu. Nuk e ka asnjërin prej kërkesave, do të thotë që janë me ligj, do të thotë krahasimi me dy vitet paraprake, nuk i përmbush kriteret ligjore siç kërkohet me Ligjin për financat publike për raportet vjetore, nuk ka kurrfarë analizimi, nuk e shpjegon mënyrën e financimit të deficitit, nuk e shpjegon askund mënyrën e financimit edhe të mbishpenzimeve në kategori të caktuara, nuk janë në asnjë formë të respektuara nga përpiluesi i këtij raporti, që në bazë të ligjit është kryetari i Komunës, nenet specifike të Ligjit për financa publike, prandaj, është e pamundur të votohet kjo pikë e rendit të ditës pozitivisht. Prapë po e përsërisë, e dimë se kjo është gjendja faktike, mirëpo raporti është jashtëzakonisht dobët i përgatitur, pa kurrfarë shpjegimi, pa kurrfarë informate. Tash duke e pasur parasysh këtë raport, unë sikletin e madh e kam që çka kemi me bërë kur të vjen raporti i auditorit, çka ka me gjetur në këtë raport raporti i auditorit që vjen sigurisht shumë shpejt, çka ka me pasur në këtë situatë. Kështu që, natyrisht se vota e LDK-së do të jetë kundër këtij raporti, sepse është raport ofendues për publikun, madje është e tepërte dhe është lëvdatë e madhe nëse i themi këtij raport.

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Havolli!  
Fjalën e ka z. Blerand Stavileci.

**Blerand Stavileci:** Faleminderit edhe njëherë, kryesues!

Të nderuar e të respektuar kolegë,

Me të vërtetë, nëse ka diçka që sot mund të përmblihet me epitelin dhe mbiemrin qesharake, është pikërisht ky "r" nuk po i them as raport, për shkak se edhe po më duket eufemizëm, meqenëse është skandaloz, i papranueshëm, përbuzës, amator, diletant! Në faqen e dytë të tij thotë: " menjëherë, e cila i ka i mbyllë sot", e vendos diku gishtin minimum tri gabime i keni, qofshin materiale, teknike, profesionale, gjuhësore. Thotë raport i përgatitur nga kryetari i Komunës, kryetari nuk vjen, turpërohet - nuk turpërohet, është punë e tij, mendoj që këtë duhet ta shohim përtej dallimeve politike dhe partiake, ta vendosim një standard të institucionit të atij i cili e kryen punën, e bënë punën, raporton për punën, pavarësisht se i cilës parti është. Komuna sikurse secili institucion, i ka disa dokumente bazë, disa që i diskutuam edhe sot, e ka një Plan strategjik, në këtë rast, në kuadër të atyre dokumenteve hyn edhe Plani zhvillimor komunal, e ka një buxhet i cili

pastaj në baza vjetore e detalizon punën operative njëvjeçare. Pra, janë parametra cilësor dhe parametra sasior, që jepen me anë të buxhetit. Unë, kur e diskutuam në KPF u rezervova, i bëra disa shënime për veti, i mora, pastaj hulumtova dhe i kam marrë 10 komuna në kontinente të ndryshme, nga kureshtja, dhe e kam përzgjedhur një të prej tyre. Lëre që këto Ferizaj dhe Gjilani i kanë më të mira, me gjithë respektin, por duke dashur që Prishtina të bëhet model, e kam marr një të një komune në Afrikë, Komuna Knisna, me 50 mijë banorë, do t'ua shpërndaj, mundem edhe të tjerëve me linkun elektronik, raport i mirëfilltë me të gjitha elementet brenda tij, ashtu siç e parashohin ligjet e tyre, por të gjitha janë të përfshira edhe nga ajo që është kërkesë e nenit 46, pika 1 dhe pika 2 e Ligjit për financa publike dhe përgjegjësitë. Tash unë e kam problem, sepse këtu janë edhe disa njerëz dhe kam respekt dhe prej disave prej tyre bile më vjen keq që ndoshta janë timonierë të caktuar në sektorë të caktuar, por unë nuk do e pranoja që ta vë nënshkrimin tim në raporte të tilla dhe, në fund i bie që ai që është në terminalin e fundit të këtij zinxhiri, e që është kryetari, e që ashtu e parasheh edhe ligji, po edhe këtu thotë, në faqen e dytë, besoj se edhe ju e keni parë. Do të hyj edhe në elemente përmbajtësore të kësaj "r-je", po edhe ju e shihni qoftë edhe tabelat janë të deformatuara, edhe fondi i shkronjave nuk është i njëjtë, më falni, po a e shohin këtë edhe nxënësit e shkollës fillore. Unë do t'ju tregoj, nxënësit e shkollës së mesme që bëjnë lëndë të ndryshme, studentët e ekonomikut, do t'ua dërgojmë me e-mail, ja se si punohet në institucionet tona, nuk është me rëndësi a është i Shpendit, i Sokolit, a i Blerandit, por kjo është e papranueshme, kjo është përbuzje për të gjithë. Ne flasim këtu e gjuhemi me njëri-tjetrin me diskurs politik, në anën tjetër, diçka që është më e rëndësishmja për komunën tonë, është totalisht nënçmuese ndaj të gjithë neve edhe qytetarëve. Po të ishte viti i parë, do të thosha mirë, ende nuk janë konsoliduar, viti i katërt, po hyjmë në të pestin, plus një bagazh edukativ shkollor që e ka, le ta shohin edhe ato universitete të jashtme se çka ka te ne, e në anën tjetër flitet e tentohet që figura e dikujt të zmadhohet! Kjo është, unë besoj dhe më pëlqeu diskutimi i Emanit, ai e nxori, edhe unë do ta përmendi atë pikë, e kam diskutuar edhe atë ditë në KPF, që është diçka që me të vërtetë neve duhet të na shqetësojë jashtëzakonisht shumë. Pra, unë e kam përmbledhur në pesë pika, e para është mos përmbushja e kriterit ligjor, e merrni, mundeni edhe tash në telefona ta danllodoni Ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë, i keni 10 pika t'i lexoni, e shihni që të gjitha prej tyre janë anashkaluar ose në tërësi, ose pjesërisht. Po i përmendi disa, p.sh. shpenzimet faktike në lidhje me secilën kategori të shpenzimit krahasuar me vitin e kaluar, suficitet, deficitet, numri faktik i punonjësve të përhershëm dhe të përkohshëm të organizatave buxhetore krahasuar me numrat e autorizuar në buxhet. Informata mbi investimet dhe detyrimet, detaje mbi të gjithë pranuesit e granteve publike të bëra gjatë vitit fiskal, si dhe shumat të cilat ata i kanë pranuar. Përpos kësaj, duhet t'ia shtojmë edhe atë, se këtu ka pasur edhe një lloj lajthitje në mes të asaj se është raport për tremujorin e fundit të vitit të kaluar dhe viti në tërësi, dhe tash me tendencë, pa tendencë, e shohim se edhe brenda këtij teksti diku thuhet tremujori, e në kllapa vihet (1 janar-31 dhjetor), pra është tremujor apo është i plotë? Por, cilado që të jetë, nuk mund të fshihen këto gabime, defekte, mangësi, që përpos kësaj anës që neve na paraqitet këtu, e po dal te pika e dytë, reflektohet pikërisht te njëri nga elementet, kategoritë esenciale të buxhetit, që janë investimet kapitale. Kolegë, përsëri po e them, me dëshirën më të madhe për të qenë jo konstruktiv, por ultra konstruktiv, do ta mënjoja nga përgjegjësia qoftë edhe vetë

kryetarin për vitin e parë, po e themi edhe për vitin e dytë, po të vjen në vitin e fundit të mandatit të kaluar dhe të kemi një realizueshmëri të investimeve kapitale prej vetëm 56%, 58%, 62%, madje edhe te ky realizim i mjerë i të gjitha viteve, po të kishim të paktën një progresion, po kemi një regresion, ka qenë diku në kufirin e 60%, tash e kemi gati gjysmën. Pra, kjo organizatë parat që i ka për investime kapitale, mos mendoni që mund t'i shpenzojë më shumë se gjysmën, e ne sot flasim për një shkollë në Veterrnik, flasim për një QMF, për çka flasim! Pra, kjo është një paaftësi totale, një impotencë për të bërë punë për këtë qytet, e që reflektohet edhe këtu, të paktën po të ishin të prezantuara mirë e si duhet, do të mund që edhe opozitës t'ia hiqnit një pjesë të fjalorit, që ne sot kemi mundësi pra me plotë të drejtë po e them jo vetëm ne, por secili qytetar i Prishtinës që e ka në dorë këtë "r". Për mos raportimin e rregullt, të gjithë e dimë çfarë ka ndodhur edhe në të kaluarën, numri i gabimeve që janë këtu, unë edhe i kam numëruar, janë mbi 300 gabime të të gjitha natyrave, materiale, profesionale, teknike, gjuhësore, të gjitha, të gjitha, dhe jam i bindur që edhe pas lekturimit do të mbesin plotë të tilla, edhe një herë do ta lexoj dhe do t'i bëjë korrigjimet me atë kimikun e kuq, si nxënësve dhe studentëve që e shohin kur dikush e meriton njësh, po të kishte not 0 edhe 0. Dhe, e fundit, pajtohem plotësisht me Emanin, më vjen mirë që unë e kam ngritur atë ditë në KPF, mbetet e fundit në raport si pjesë e detyrimeve, janë të përshkruara 46 lëndë, sepse mendohet këtu në tremujor: tetor, nëntor, dhjetor, ndërkaq e shihni që në total janë 255 lëndë për vitin kalendarik 1 janar-31 dhjetor. Dhe unë edhe këto, edhe pse janë të pamjaftueshme si informacione, mendoj që për secilën duhet ta dimë, jo vetëm të thuhet kompensim dëmi, jo vetëm të thuhet kontekst gjyqësor...(diskutimi i paincizuar).

**Kryesuesi:** Blerand, më fal veç një sekondë, se ka kaluar koha, nëse je afër vazhdo edhe 30 sekonda, regjia.

**Blerand Stavileci:** Nëse kemi përafërsisht, sepse tash nuk mund të ketë një lëndë që kompensimi do të jetë shumë i lartë, ose që është shumë i ultë, po nëse është përafërsisht ky trend, atëherë ne flasim për 30 milionë, që është 50%, gati 50% e buxhetit të Komunës. Prandaj pajtohem edhe ne, besoj edhe të gjitha GP-të këtu nuk duhet të kanë mëdyshje, ky raport dhe votimi i tij duhet të shtyhen, duhet të bëjmë presion maksimal jo për organizatën, jo për kryetarin, po që në fund edhe ne nesër si pjesëtarë të kësaj asambleje, dikujt t'ia tregojmë, pastaj mund të flasim në kuadër të zërave të caktuar, është shpenzuar mirë, nuk është shpenzuar mirë, pse kaq pak mallra e shërbime, pse kaq pak subvencione, etj. etj., por në parim le të ketë një standard, pavarësisht se kush është, sepse kjo është me të vërtetë nënçmuese. Mua nëse jo, atij, mua më vjen marre për ta dhe të gjithë të tjerët...(diskutim i paincizuar).

**Kryesuesi:** Faleminderit z. Stavileci!  
Fjalën e ka Fadil Gashi, GP i AAK-së.

**Fadil Gashi:** Faleminderit, kryesues!

Edhe GP i AAK-së mendon se ky raport duhet të shtyhet, pasi që nuk kemi shumë të dhëna për të.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!  
Fjalën e ka z. Vese Makolli.

**Vesel Makolli:** Ia kaloj fjalën Sami Borocit.

**Kryesuesi:** Okej.  
Fjalën e ka Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit, kryesues!

Atëherë, edhe GP i AKR-së ka analizuar me kujdes raportin me informatat e prezantuara, ka pasur ndoshta mungesë të plotë të informatave, të cilat ne ose nuk kemi mbërri me i kuptuar ndoshta, ose nuk kanë qenë të prezantuara me qëllim, sepse është përgjegjësi e jona, sidomos shpenzimi i parasë, ose i parave publike. Ne u dakorduar bashkë edhe me grupin që po ashtu të kërkojmë shtyrjen e votimit të këtij raporti dhe para Asamblesë të prezantohet një raport më i detajuar konform Ligjit për financa publike. Kemi pasur edhe reagimin e organizatave të cilat e monitorojnë punën e Kuvendit, ose punën e qeverisjes në Prishtinë, kështu që edhe ne kërkojmë që votimi i këtij raporti të shtyhet, duke u plotësuar me shumë më shumë detaje.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Fjalën e ka Fiknete Bejta.

**Fiknete Bejta:** Përshëndetje!

Të nderuar kolegë,  
Kryesues,

Duke u bazuar në një analizë të këtij raporti, konstatoj se ky raport financiar është një material i dobët, i cili nuk bazohet në Ligjin për financa publike dhe përgjegjësitë, është pa përmbajtje dhe me probleme numerike, me elemente kundërshtuese në mes të pozicioneve financiare. Përveç gabimeve të mëdha profesionale, raportit në tërësinë e tij i mungon krahasimi, analiza e kontekstit dhe sqarimi i numrave në kuptimin e realizimit të kontratave dhe projekteve, pastaj mungon lista e pasurive të organizatës buxhetore, lista e të punësuarve të përhershëm, nuk ka shpallje dhe shpjegime tjera. Në një analizë të performancës financiare theksojmë se shkalla e realizimit të projekteve kapitale dhe shpenzimi i mjeteve vetjake për vitin 2017, nuk ishte në nivel të kënaqshëm. Gjatë gjithë raportit edhe në pjesën e investimeve, nuk ka pasur aspak analizë, janë paraqitur të dhëna, por nuk është përdorur asnjë metodë e analizës për të ofruar një perspektivë më të qartë. Raporti lavdëron se në vitin 2017, Komuna ka pasur 17 milionë 721 mijë euro investime kapitale, por ne shohim se raportet paraprake ato të vitit 2016, dhe në tri vitet e fundit ka rënie të konsiderueshme të investimeve, dhe vetëm prej vitit 2016, dallimi është mbi 4 milionë euro më pak, dhe mbi 2 milionë euro më pak në realizim të vitit 2017 nëse e krahasojmë vetëm me vitin 2016. Projektioni për realizimin e vjeljes së tatimit në pronën e paluajtshme është jashtë pritjeve reale. Këtë e bazoj në faktin se tatimi në pronë në janar të



vitit 2016 është rritur, si rrjedhojë e kësaj dhe gjendjes faktike në terren kemi edhe përllogaritje më të madhe, sepse situata në terren ka ndryshuar, duke u shtuar edhe baza e llogaritjes dhe, përveç kësaj, Komuna në dallim prej vitit 2016-2017, ka vjelë më pak buxhet nga këto planifikime për 17%. Shkalla e të hyrave komunale ka shënuar rënie të ndjeshme në krahasim me vitet paraprake, nëse bazohemi në të dhëna reale dhe projeksione të bazuara në mundësitë reale. Krahas rënies së të hyrave komunale, është shënuar rritje e ndjeshme e shpenzimeve të parasë publike komunale dhe është shënuar rritje d.m.th. për 0.28% të realizimi i pagave dhe mëditjeve, është rritur gjithashtu shpenzimi të shërbimet dhe kemi rritje të shpenzimeve edhe në mallra dhe shërbime. Kemi rritje të bartjeve të kategorive buxhetore, p.sh. tek investimet kapitale, në krahasim me vitin 2016, kemi një rritje prej 16,79%, tek subvencionet dhe donacionet kemi rritje të bartjeve prej 16.95%, ose të investimet kapitale për 13%. Dhe nëse e analizojmë performancën financiare të disa drejtorive komunale, po marrim vetëm disa prej tyre, themi se drejtoritë nuk kanë pasur efektivitet në menaxhimin e parasë publike, sepse nëse i analizojmë disa drejtori veç e veç, shohim se Drejtoria e Administratës, fjala vjen, ka realizuar buxhetin vetëm për 29.13%, Drejtoria e Pronës 24.42%, Drejtoria e Planifikimit 31.65%, apo të këto dy sektorët, Sektori i zhvillimit vetëm 26%. Këtu vlen të theksohet se rreth 50 projekte nuk kanë filluar të realizohen, edhe pse kanë pasur mjete buxhetore. Pasi nuk kam kohë, po kaloj te kjo vlera e konsiderueshme e dosjeve që na u kanë ofruar vetëm si numra. Sipas nenit 39.2, ato ekzekutime me përmbarim p.sh. vetëm në vitin 2017, kemi mbi 270 mijë euro, një pyetje e kam për kryetarin: Çfarë masash janë marrë nga Zyra ligjore për mënjanimin e këtyre pagesave me përmbarues, sepse këto dëmtojnë rrjedhën e planifikimit buxhetor?

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Regjia, ju lutem listën!

E kërkoni fjalën me buton.

Fjalën e ka Agim Gashi.

Më falni, Egzon Azemi, në rregull, ju jeni tash, regjia ka bërë një lëshim.

Urdhëroni!

**Egzon Azemi:** Faleminderit!

Vlerësoj që nga ky kuvend i sotëm në Prishtinë, duhet të marrin mësim edhe të gjitha qytetet tjera, jo në këtë rast të ekzekutivit që të dërgojë raporte të tilla, krejtësisht të dobëta dhe joprofesionale, mirëpo të marrin mësim sidomos partitë politike, që në raste kur interesi i qytetit është më i rëndësishëm, nuk duhet të shikohet se cila parti, ose cili kryetar udhëheqë me kryeqytetin. Normalisht që do të votoj kundër këtij raporti, sepse një raport i tillë financiar më shumë i ngjan një organizate joqeveritare, sesa një organi, apo një institucioni siç është Komuna e Prishtinës.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Fjalën e ka z. Agim Gashi.

**Agim Gashi:** Faleminderit, kryesues!

Unë do të ndalem vetëm te disa gjëra shumë të thjeshta, sepse nuk është e natyrës sime profesionale që të lëshohem në detaje financiare, sepse nuk i marr vesh ato punë, por si njeri i rëndomtë e shoh se, në plan të parë, ato që i thanë parafolësit se raporti nuk ka bazë ligjore, sepse nuk i ka plotësuar as kriteret elementare që i përcakton Ligji për financa publike, për menaxhimin e financave publike, por ajo që bien në sy, janë gabimet elementare, apo lëshimet elementare, të cilat nuk e di pse i kanë futur ashtu. P. sh. në raport asnjë fjalë nuk fletë për ndërmarrjet komunale. Ndërmarrjet komunale janë pronë e Komunës së Prishtinës, për të cilat përgjegjës është kryetari i Komunës së Prishtinës, dhe qeveria komunale, asnjë fjalë e vetme, sikur ato nuk ekzistojnë dhe nuk operojnë në territorin e komunës së Prishtinës. E dyta, shihni në faqet 17-19, këtu thotë: “Kodi buxhetor 2/2.4/1, Qendra e Mjekësisë Familjare, Veternik, 222 mijë 666 euro shpenzime”. Kur është ndërtuar ajo?! Pak më poshtë thotë; “Shkolla fillore në Kalabri, 275 mijë e 311 euro”. Kur është ndërtuar ajo shkollë?! Pak më parë folëm se nuk po kemi lokacione, ose “Mati 1”, 498 mijë e 971 euro, ne e patëm hallin e parcelave, gjë që ajo nuk është arsye, sepse katër vite nuk kemi arritur me siguruar në njërën nga tetë pikat e domosdoshme për ndërtimin e institucioneve shkollore një lokacion, ku kemi mundur me procedura ligjore me e siguruar lokacionin, a me paguar, a me këmbyer etj. etj., e me e ndërtuar së paku një shkollë, pra me e hequr një barrë nga tetë barra që i ka kjo qeveri komunale në këtë mandat, sepse tash është bukur problem me i përmbushur të gjitha ato kërkesa. Te investimet kapitale, ju e patë që realizimi buxhetor është 44 e diçka për qind, gati 50% nuk është realizuar. Pa hyrë në detaje, gjërat janë prezantuar të përgjithësuara. Atje thotë thurja e oborreve të shkollave, ose ndërtimi i sallave të edukatës fizike, 220 mijë euro; unë nuk e di që mund të ndërtohen shumë salla të edukatës fizike me 220 mijë euro. Pra, ka këso lëshime teknike, të cilat në të vërtetë edhe personin më laik e bëjnë me dyshuar që është prezantuar një punë joserioze para nesh këtu. Nuk do të ju marr shumë kohë, sepse parafolësit i thanë, por unë vetëm sa për ilustrim i identifikova nja dy-tri elemente, për me pa se me të vërtetë nuk është mirë as për neve që një qeveri komunale me dal me një dokument të tillë, dhe unë mendoj që kjo duhet mos të votohet kështu. A duhet të sillet në versionin e ri, apo nuk do të sillet, ato janë çështje tjera. Unë e di që ne kompetenca me i obliguar ata me e bërë, se ka pasur edhe raste më herët që nuk i kemi votuar dhe ato kanë heshtur, kanë shkuar ashtu e kanë përfunduar diku në sirtarët e Komunës e nuk është marr më askush me atë punë. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Veç e shtypë, të lutem, tjetër herë.

Fjalën e ka Naime Osmani.

Mundesh me vazhduar, por herëve tjera e shtyp butonin për me u lajmëruar, se ndoshta nuk ke qenë këtu kur e kemi bërë shpjegimin.

**Naime Osmani:** Përshëndetje për të gjithë.

Kryesues,

Kolegë të nderuar,

Media të shkruara dhe elektronike,

Së pari, e shfrytëzoj rastin, se sot është data 7 mars, t'i përgëzoj dhe t'i uroj të gjithë mësimdhënësit, t'ju uroj punë të mbarë, shëndet dhe suksese.

E mora fjalën se, megjithëse të gjitha i thanë kolegët e mi lidhur me këtë raport, por unë dua me cekur, po ndërlidhem te ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse, te Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, pasi që gjithherë e ceku, sepse jam përfaqësuese prej fshatrave, dhe sikur ne fshatrat mos të ishim në Kosovë! Unë kërkoj që kur të na sillet përsëri ky raport, t'i specifikojnë të gjitha projektet të cilat janë kryer, pasi këtu përfshihen dhe janë cekur shumë, p.sh. të cilat janë harxhuar; nuk jam ekonomiste me profesion, por bile ta dimë ku kanë shkuar. Unë gjithashtu e kërkoj edhe një gjë tjetër, që në këtë vit, mos në këtë vit edhe viteve në vijim, mos të shkëputen për rastet emergjente, për profile të ndryshme, siç është p.sh. rasti, unë më 3 janar të vitit 2018, e kam bërë kërkesën si asambliste dhe si qytetare e Prishtinës. Banori i fshatit Besi, rruga "Fazli Osmani", e kam cekur edhe në seancën e kaluar, është dëmtuar rruga me rregullimin e kanalizimit në vitin 2016, pjesa komplet nga kanalizimi, nga gypat e kanalizimit është shembur, me vetura absolut banorët nuk kanë qasje në ato shtëpi, dhe mua më është kthyer përgjigja dhe atë kur kam ardhur në drejtori, jo në mënyrë elektronike, ose, ose me postë. Më është kthyer përgjigja, mirë e kishin shkruar, me shkruar e kishin shkruar mirë, po punë nuk ka, nuk janë ndërmarrë hapat konkret, nuk i kanë printuar fotografitë, edhe pse TV Klan ka qenë aty, nuk e di arsye pse nuk e ka paraqitur përmes medieve. Qytetarët, ose banorët e fshatit Besi, por edhe të atyre fshatrave, të gjitha obligimet ndaj Komunës së Prishtinës i kryejnë, nuk e di pse ky injorim, nuk ju ka kushtuar asgjë p.sh. me dy kamionë zall me ardhur e me u mbyllur ai kanal. Ndoshta po duhet me e ngritur tonin, se tjera herë kur kam diskutuar, kam diskutuar, kam folur me fjalë të buta, se nuk kemi ardhur këtu qysh thonë me u përta, por për me i paraqitur rastet konkrete, me i përcjellë kërkesat e qytetarëve, se për raportin mos të flas, të gjithë po e dinë, të gjithë e thanë. Tjetra, në vitin 2014, është miratuar Rregullorja për menaxhimin e varrezave dhe komemoracionit në Komunën e Prishtinës, paratë kanë shkuar, ndërsa varrezat nëpër fshatra, në disa fshatra nuk janë rrethuar, nuk janë rrethuar në Tenezhdoll, në Vranidoll. Edhe pse fshatrat e kanë një menaxhim pak më ndryshe, edhe pse në rregullore nuk ceket aty, se p.sh. për hapjen e një varri në qytet e njofton "Hortikulturën", punëtorët e "Hortikulturës" i hapin varrezat, fshatrat e kursejnë "Hortikulturën" se varrezat i hapin vetë qytetarët, dhe në këtë mënyrë për hapjen e varrezave nuk kompensohet askush. Por, megjithatë, unë e ceka këtë, që në fshatrat Tenezhdoll dhe Vranidoll nuk është bërë rrethimi i varrezave. Tjetra, se shumica e kolegëve e dinë se është mandati i tretë i imi, por edhe në mandatin e kaluar gjithherë i kam bërë kërkesat, siç po shihet edhe tash, bile në mandatin e kaluar nja 2-3 muaj rrinin qeveritarët këtu, por tash po shkojnë. Në Vranidoll kërkohen rrugicat dhe rregullimi i kanalizimit, në Tenezhdoll, jo në të ndryshme nuk po e lë hiq, në fund, nuk po dua me e lënë në fund, jo nuk po e lë në fund, po në Vranidoll rregullimi i kanalizimit, rrugicat, në Tenezhdoll rrugicat dhe rrethoja e varrezave, në Rimanishtë, rrugicat, kanalizimi, ujësjellësi, që nuk kanë bërë kurrëgjë për Rimanishtë, vetëm ku i kanë pasur militantët e vetë, në Besi një rrugë, le të ma bien një shembull me argument, le të më thonë kjo punë është kryer në Besi, kjo punë është kryer në Rimanisht, ose ....

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Fjalën e ka Adrian Berisha.

**Adrian Berisha:** I nderuari kryesues,

Të dashur kolegë,

Është shumë banale, sinqerisht, me diskutuar ne për probleme tjera, kur po e dimë që pika e katërt e rendit të ditës është duke u diskutuar. Arsyeja pse nuk janë drejtorët tjerë këtu, është se ne kemi punë me dy drejtorë këtu, me ish-drejtorin e Financave dhe tashmë drejtoreshën, atëherë le të diskutojmë për financa. Ne po e dimë që, po pajtohemi që kjo nuk do të votohet sot, kishim shkuar në votim, kishim diskutuar për diçka tjetër, kurse për rrugët e Tenezhdollit, duhet me u drejtuar te Drejtoria e Investimeve Kapitale, ashtu besoj unë, për të gjitha rrugët e fshatrave edhe lagjeve që janë. Të flasim për financa, po e dimë që raporti është skandaloz, e votojmë, kush mendon po, kush jo, edhe shkojmë përpara, qashtu po mendoj unë.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Të përfundojmë njëherë.

Fjalën e ka Leutrim Retkoceri.

**Leutrim Retkoceri:** Faleminderit, kryesues!

Fillimisht, është për me e përshëndetur këtë seancë, që sidomos kjo pika për Raportin financiar buxhetor është duke u diskutuar në mënyrë konstruktive edhe nga koalicioni qeverisës. Unë vetëm desha për këtë raport, pa hyrë me e komentuar më shumë, të gjithë jemi të njëzëri, sepse ky më së paku është raport financiar. Desha të bëjë vetëm një krahasim, që besoj se është një mostër e mirë, që kur të përmirësohet, pas kthimit të këtij raporti, do të kemi për çka të bisedojmë për çështje konkrete. Fjala është për të hyrat vetjake, në faqen e 6, që është ndër të rralla që është një krahasim në mes të vitit 2016-2017, është tatimi në pronë, përderisa në vitin 2016 do të thotë ka qenë realizimi më i madh me 7.1 milionë, në vitin 2017 e kemi 6.9 milionë, do të thotë kjo tregon qartë për një vendim të kahershëm të kryetarit të Komunës për ndarjen e zonave në lagje të komunës së Prishtinës, që në të hyra përveç që janë dëmtuar qytetarët me këtë kategorizim, edhe në të hyra është dëmtuar buxheti i Komunës. Besoj që pas kthimit dhe përmirësimit të këtij raporti, në seancat e ardhshme do të diskutojmë konkretisht edhe për defektet tjera, që na qesin në fakt këto financa të buxhetit.

Faleminderit!

Kaq pata.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Diskutime tjera nuk ka.

Po, urdhëro drejtor!

Fjalën e ka Gëzim Mehmeti.

**Gëzim Mehmeti:** E nderuara zonja asambliste, ju jeni e mirëseardhur çdoherë në Drejtorinë e Investimeve Kapitale për shqetësimet dhe kërkesat tuaja. Një gjë dua ta sqarojë. Diku

gjatë vitit 2000-2012, është investuar në prona private. Në bazë të analizave që i kemi ne, banorët të cilët janë pronarë të pronave kanë me ngrit padi kundër Komunës, ne do të bankrotojmë. Këtë e them sepse, të lutem, veç një moment, sepse në të ardhmen do të kemi telashe shumë dhe ne nuk mundemi në çdo pronë private të investojmë, t'u ndërtojmë rrugë, këtë duhet njëherë e përgjithmonë ta ndalojmë, e para. E dyta, sa i përket Rimanishtës, Ministria e Planifikimit Hapësinor e ka miratuar buxhetin, me të cilin do të ndërtohet ujësjellësi.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Replikë, ke të drejtë 2 minuta.

Urdhëro!

**Naime Osmani:** Drejtor, unë si asambliste e kam për obligim me e cekur në kuvend, po edhe me i bërë kërkesat, nuk mundem unë si asambliste çdo ditë me ardhur në drejtori, dhe rastet emergjente, unë thash edhe këto fotografitë e rrugës nuk i kam printuar dhe t'i sjellë. Nuk është pronë private, se tatimi i paguhet Komunës dhe këtë duhet me e pasur të qartë, nëse nuk e dini, merrni lexoni ligjet, aplikoni ligjet, ju lutem, po edhe rregulloret e Komunës, se ky rast është urgjent, është rruga prej 150 m, Komuna e Prishtinës e ka ndërtuar atë kanalizim dhe është shembur komplet kah gypat, dhe si pasojë banorët nuk kanë qasje te oborret e tyre, nuk kanë qasje me vetura te shtëpitë e tyre. Nëse nesër e kanë një të sëmurë, qysh e qojnë ata, qysh e dërgojnë në spital?! Këto gjëra duhet me i pasur parasysh. Absolut nuk i drejtohem kurrkujt në këtë mënyrë, po sot po më detyroni, se asamblisti nuk e ka për obligim çdo ditë me ardhur në drejtori.

Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Po replikë, urdhëro!

**Gëzim Mehmeti:** Nuk po kërkoj nga ju që çdo ditë të vini në Drejtorinë e Investimeve Kapitale, por janë përfaqësuesit e lagjes, është Bashkësia lokale që mund t'i drejtojnë kërkesat e tyre. Ne kemi intervenime çdo ditë sa i përket emergjencës, vetëm se duhet me pasur parasysh, besoj që do të ketë bashkëpunim nga ana e juaj, se në prona private, Komuna e Prishtinës nuk ka kapacitet buxhetor të investojë dhe të ndërtojë rrugët private, që janë prona private, për arsye se tash do t'ua shpjegoj pse. Prishtina sipas regjistrimit civil të fundit, i ka diku 198 -199 mijë banorë, ne e kemi buxhetin e ndarë në këtë mënyrë, ndërsa në kryeqytet jetojnë diku mbi 400-500 mijë banorë, ne duhet ta rrisim buxhetin, besoj që Qeveria e Kosovës do të na ndihmojë, po ashtu edhe me miratimin e Ligjit për Prishtinën, që të ketë më shumë të hyra sa i përket buxhetit, sepse nuk kemi kapacitet të ndërhyjmë në çdo lagje, Prishtina po rritet çdo ditë. Sa i përket emergjencës, ne i kemi bërë këto, mirëpo ju lus që për pronat private, ku ka konteste, sepse për prona private e kemi shumë të vështirë.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Po edhe hera e dytë është e replikës, ke të drejtë.

**Naime Osmani:** Ajo pronë, nëse është ajo rrugë, të lutem koleg i nderuar, ke parasysh se edhe ti je me votë, edhe unë jam, mos reago, unë nuk reagova kur fole ti, të lutem, të lutem!

**Kryesuesi:** Adrian, Adrian, të lutem, hera e dytë e replikës dhe ka të drejtë, dhe po mbyllen diskutimet me kaq, shkojmë në votim.

**Naime Osmani:** Ajo nuk është pronë private, nëse e konsideroni ju një rrugë pronë private, atëherë pse është ndërtuar kanalizimi nëpër pronë private nëpër rrugë? Ju lutem, se nuk po e zgjati më shumë.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Këta tre të tjerët që janë paraqit me diskutuar, janë realisht që kanë diskutuar më herët, nuk ka të drejtë diskutimi, po, po të lutem po tash e ke përfunduar të drejtën e fjalës, drejtori iu përgjigj zonjës Osmani, nuk pati diçka tjetër çështje replikë. Nëse ka diçka tjetër që ke kërkuar sqarim, për këtë çështje ju lutem jo, se nuk...

Faleminderit!

Atëherë, regjia, ju lutem përgatitni për votim.

Jo, jo, veç një sekondë.

Po këtë temë e ke diskutuar, e ke një herë të drejtë fjale 5 minuta,

(Është diskutuar larg mikrofonit)

**Kryesuesi:** Në rregull është, po tash nuk është koha të sqarojmë secili njëri tjetrit deri në fund, është e drejta e diskutimit 5 minuta, ka përfunduar.

Fjalën e ka ish-drejtori i financave, ju lutem.

**Ismail Kokaj:** Unë prapë isha kthyer te Raporti (TM 4). Arsyeja pse është Raporti (TM 4), është se jemi të obliguar në baza kuartale të raportojuar. Sipas ligjit është e rregulluar që çdo 30 ditë pas kuartalit, me pasur një informatë të tillë, një raport të tillë. Sa i përket Zyrës së auditorit, ne jemi shumë, shumë në rregull me raportet të cilat dalin, dhe raporti, detajor, merret në qershor, kur del prej Zyrës së Auditorit. Për informatat shtesë që i kërkuat, ne mundemi me ia bashkëngjitur secilit shpenzim analitiken e shpenzimit, që ka me qenë një raport më voluminoz, përndryshe, baza dhe esenca e këtij raporti nuk ndryshon, janë këta numra dhe këta numra nuk ndryshojnë. Është e drejtë e juaja a doni me votuar, apo nuk doni me votuar. Si Drejtori e Financave e kemi obligim me ju dërguar raportin 30 ditë pas tremujorit, qoftë ai tremujor i parë, i dytë, i tretë, apo qoftë tremujori i katërt, është në dorën e juaj a e votoni, apo nuk e votoni, edhe pse votohet. Unë prapë nuk e di këtë proces, për çdo informatë shtesë, prapë mundeni me kërkuar sqarim për secilën shpenzim, kemi me qenë pranë kësaj.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Për shkak të kësaj që thatë pse votohet, pse jo, atëherë duhet me pasur kujdes që të paraqitet si informim, jo si raport, të paraqitet si informim si pikë e rendit ditës, herëve tjera, po.

Jo, jo, ke diskutuar, vetëm një sekondë, ju lutem, në rregull, po 10 minuta, Sokol.

Diskutimi ka përfunduar.

Ju lutem, regjia të përgatitet për votim.

Votojmë tash.

Për 9 vota;

Kundër 33 vota;

Abstenojnë 3;

Nuk kanë votuar 6.

### **Konstatohet që raporti nuk kalon.**

Shkojmë tutje.

### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për miratimin paraprak të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).**

**Kryesuesi:** Drejtor, a ke me paraqit diçka?

**Dren Kukaj:** Jashtë kësaj pike të veçantë, të këtij rasti konkret, veç si informatë, për shkak se e mora obligim herën e kaluar në mbledhjen e KPF-së, që me organizuar një takim me KEDS-in, KOST-in dhe ZRE-në. Përmes kryesuesit, të gjitha subjektet politike i kemi njoftuar për takimin. Temat ndërlidhen përgjithësisht me çështjen e pronave që po na i kërkon KEDS-i, për nevojat e shtrirjes së rrjetit, po gjithashtu do të diskutohet edhe Plani i zgjerimit edhe i përmirësimit të rrjetit ekzistues. Kushdo që ka ndonjë çështje tjetër që i shkon në interes Komunës së Prishtinës, mundeni me i paraqitur besoj te kryesuesi edhe t'i diskutohet në javën tjetër në një takim të përbashkët këtu në Komunë, shpresoj me përfaqësuesit e lartë të këtyre kompanive. Në raport me pikën nuk kam diçka.

**Kryesuesi:** Në rregull, faleminderit shumë!

Shkojmë me GP.

Fjalën e ka Leonora Shabani-Bajraktari.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** LVV-ja në parim e mbështetë kërkesën nga KEDS-i, kështu që vetëm në qoftë se ka ndonjë rregullore që ne mundemi me e kompensuar, si p.sh. A ka ndonjë rregullore që e rregullon shfrytëzimin e pronës së Komunës për rrjetin e energjisë elektrike? Pra, nëse mund të faturohet shfrytëzimi i pronës së Komunës që e ka KEDS-i, për shkak se KEDS është një kompani private, komerciale, ku pastaj këto të hyra kishin formuar një fond. Mendimi im është që ai fond të dedikohet për arsimin, konkretisht për punësimin e mësimdhënësve mbështetës të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Urdhëro, drejtor!

**Dren Kukaj:** ... (Larg mikrofonit) ... i cili ka pësuar ndryshime, e përkitazi ndryshimeve që i ka pësuar, ka të bëjë me prona, e një prej çështjeve që po duam me e diskutuar ne, me këta dy akterë që janë të energjisë, është kjo çështje edhe kompensimi. Aktualisht nuk kemi të drejtë me i kërkuar kompensim. Ne i procedojmë këto raste, për shkak se konsiderojmë që qytetarët e asaj ane ku zgjerohet distribuimi i energjisë, kanë nevojë për energji, edhe nuk e shohim kështu. Ideja është që të mblihdemi me të gjithë, d.m.th. me ZRE-në, me KEDS-in, me KOST-in dhe ta diskutojmë edhe këtë çështje. Kështu që unë ju ftoj të gjithëve me ardhur në takim, cilindo vendim që e marrim bashkërisht, për mua është Ok. me vazhduar, nuk kam ndonjë problem, dhe e ndaj atë shqetësim. Mendoj që duhet, për aq sa është e mundshme, me u kompensuar ne si Komunë, për shkak se po ia japim pronat KEDS-it, por kjo është çështje besoj të cilën do ta diskutojmë atë ditë në takim e jo tash.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Fjalën e ka z. Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Ja kaloj fjalën z. Shefki Gashi.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Urdhëro, z. Shefki Gashi!

**Shefki Gashi:** Faleminderit, kryesues!

Natyrisht që ne e aprovojmë ndarjen e pozicionit për KEDS-in, por tash mos të bëhet shumë, se neve dikujt po na bien me lëvizur më shumë në terren e ku ta di unë, është problemi që shtrirja e trafave, nevoja për trafo, sidomos në pjesën e katundeve, është tepër me nevojë, sepse atje ka dyfish humbje të energjisë elektrike. E dinë këta njerëzit e elektrikes më shumë, se përveç asaj që përçuesit janë shumë larg, ku ka humbje të energjisë elektrike, është edhe rrjeti është i vjetruar, dhe ka nevojë që të ndërtohen disa trafo. Ka kërkesa, ndoshta edhe qytetarët do të participojnë, ose të gjejmë njëfarë forme që Komuna ta udhëheqë atë proces, dhe nevojat e qytetarëve për trafo ose për përforsim të tensionit të rrymës elektrike, të iniciohet prej Komunës dhe prej shërbimeve komunale këtu dhe, në njëfarë forme me e kushtëzuar edhe atë kompaninë private me ndarjen e parcelave aty ku ka nevojë, ku e ka interesin, sikur që është Prishtina. P.sh. ata kanë interes në Prishtinë, por nuk kanë interes me e pas një trafo diku në Marec ose në Zllash, ose në Koliq. Prandaj, edhe atje t'i detyrojmë që qytetarëve që janë atje, edhe ai numër i vogël që kanë mbetur, po flas për fshatrat atje më rreth kufirit, se këto këtu kah Llukari, Makoci, Mramuri, Busia e Slivova, këto janë të banuara shumë dendur, që të rritet numri i trafave.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Gashi!

Fjalën e ka Blerand Stavileci.



**Blerand Stavileci:** Faleminderit edhe njëherë, kryesues!

Ashtu siç diskutuam herën e fundit, dhe unë e pash përsëri edhe përfaqësuesi i Komunës ishte në atë frymë që e diskutuam atje dhe u dakorduam, po se po, se kjo që e votojmë sot është e mirë dhe në dobi të qytetarëve, por për mos të qenë këto veprime dhe vendime të fragmentuara, është shumë më mirë që ne t'i paraprijmë, që ta kemi një fotografi të kompletuar, meqenëse KEDS-i i ka planet e veta edhe vjetore për zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit, dhe nëse ne iu rrimë gati nëpërmjet personave që caktohen që të diskutojnë me ta dhe të merren vesh, duke i përfillur në plotni pritjet dhe kërkesat, dhe kërkesat e qytetarëve, atëherë besoj që do të jenë gjëra të mira, të cilat ju hyjnë në punë edhe qytetarëve si amvisëri, po edhe bizneseve në lokacione të ndryshme të Prishtinës.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Stavileci!  
Fjalën e ka z. Fadil Gashi.

**Fadil Gashi:** Faleminderit, kryesues!  
Edhe GP i AAK-së e përkrahë këtë rregullore.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Fjalën e ka z. Vesel Makolli.

**Vesel Makolli:** E përkrahim, por do ta plotëson me dy fjali Samiu.

**Kryesuesi:** Në rregull.  
Fjalën e ka Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit, kryesues!  
Faleminderit, Vesel!

Siç e deklaroi edhe shefi i GP, edhe kryetarët e AKR-së dhe AA-së, do ta përkrahim votimin e kësaj pike, mirëpo edhe në KPF, veç e përmendi Blerandi edhe parafolësit, kemi diskutuar, ose në fakt kemi kërkuar që takimet e ardhshme të cilat do të jenë me përfaqësuesit e KEDS-it, të jetë një plan ndoshta për një periudhë njëvjeçare, plani i tyre mbi rrjetin e distribuimit, me qëllim që ne mos me e votuar çdo seancë nga një pronë, mirëpo nëse ata e bien një plan vjetor, atëherë kishte me qenë shumë më e qartë edhe për neve kjo pikë. Po ashtu, le të shihet mundësia, meqenëse KEDS-i është kompani private, le të shihet mundësia, nëse ka bazë ligjore, që me e kompensuar shfrytëzimin e kësaj prone publike.  
Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
E hap diskutimin.  
Fjalën e ka Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit!

Fillimisht, kryesues është mirë që mendimet që merren prej asamblistëve edhe të respektohen, për shkak se kërkesa jonë ishte që ta shtyjme votimin për raportin financiar, e jo të votohet, po duan me na qit në një pozitë në të cilën duhet me votuar ndoshta edhe pa dëshirën tonë. Shumica e asamblistëve ishim për me e shtyrë, jo për me e votuar.

**Kryesuesi:** Shtyrje është, realisht kjo procedurë është shtyrje, është mos miratim i këtij raporti, është mospranim, se diskutuam këtë çështje edhe me Zyrën ligjore.

**Eman Rrahmani:** Tjetër gjë është shtyrja dhe tjetër është votimi kundër. Shtyrja d.m.th. me e pru një raport të detajizuar dhe tash që votohet kundër, atëherë ka mundësi edhe mos me pru raport fare.

**Kryesuesi:** Atëherë, më fal se nuk desha me e shndërruar në replikë, por atëherë si procedurë ishte dashur me e tërhequr nëse nuk kishim dashur, pra, nëse nuk duam me e tërhequr, kalojmë në votim. Po flas prej një praktike në Kuvend të Kosovës. Nuk e di tash edhe interpretimi i Zyrës ligjore ishte kështu.

**Eman Rrahmani:** Sa i përket tash që është, unë kisha kërkuar që edhe kjo pikë, meqenëse Dreni paska organizuar një takim me grupe të interesit që kanë direkt, të shtyhet dhe pas konsultimit dhe marrjes së vendimeve të përbashkëta, pastaj të vendoset për dhënien apo jo të kësaj parcele. Unë po e jap mendimin tim, secili e ka votën e vetë, po mendimin tim. Shefja e grupit e ka përfunduar fjalën e vet, ndërsa unë jam duke e thënë mendimin tim personal.

**Kryesuesi:** Në emër të grupit ka folur dikush tjetër, Vala, Vala a po e do fjalën? Eman, vazhdo se koha po ecën.

**Eman Rrahmani:** Ajo çka po kërkojë unë është për shkak se KEDS-i është duke i diskriminuar shumicën e lagjeve të Prishtinës. Është mirë me u ulur me ta dhe me i diskutuar problemet të cilat është duke ua shkaktuar qytetarëve, bizneseve dhe gjithkujt. Nuk jam duke kërkuar mos me ia dhënë në shfrytëzim 9 m<sup>2</sup> apo diçka KEDS-it, për shkak se prej asaj përfitojnë qytetarët e asaj pjese, dhe ka shumë praktika që është duke i përdorur KEDS-i, që është duke blerë pronë private, dhe pastaj i vendos trafo në ato prona. Ajo çka mua më gëzoi, është se Dreni e pranoi një takim me drejtorët e KEDS-it, me përfaqësues të partive dhe me kryesuesin e Kuvendit. Është mirë që në atë takim të kërkohet që në momentin që ka ndërprerje të energjisë, të shpërndahet ajo ndërprerje për të gjithë njësorët njësoj, e jo me iu ndalur një pjese, një fshati, ose një lagjeje me nga 6 orë, me nga 8 orë, kurse një lagje tjetër me pasur 24 orë. Këto gjëra duhet me u koordinuar dhe me e bërë një marrëveshje mirëkuptimi, apo me u gjetur një, për shkak që KEDS-i ka shumë nevojë për ndihmën e Komunës, unë kam qenë i kyçur direkt, dhe e përgëzoj drejtorin teknik të KEDS-it për rajonin e Prishtinës, që është z. Milazim Avdiu, është duke e bërë një punë jashtëzakonisht të madhe për përmirësimin e cilësisë së energjisë. Mirëpo në të dy anët ka

pengesa, si nga ana e Komunës, për shkak të dhënies së lejes së punës, por edhe në anën tjetër, KEDS-i bënë diskriminime të jashtëzakonshme të lagjeve me reduktime të rrymës. Këto gjëra po mendoj që është mirë me u diskutuar dhe me u zgjidhur njëherë e mirë. Kemi lagjet "Kolovica", "Kodra e Trimave" dhe fshatrat në përgjithësi, ku janë detyruar të gjitha bizneset, të gjitha fabrikat me u larguar prej aty. Kjo ka ndikuar edhe ekonomikisht, edhe në të gjitha aspektet tjera. Nuk është kaq e lehtë kjo, po ia japim dhe po kryhet, nuk është esenca tek 9 m<sup>2</sup>, por është esenca se qysh me u krijuar një rrugë e zgjidhjes së këtyre problemeve të mëdha që janë. Andaj, unë kisha kërkuar që këto probleme të zgjedhën, pastaj të vendoset për dhënien e pronave, të kësaj prone dhe secilës prone që i nevojitet, dhe krijon një përmirësim të gjendjes së energjisë.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Po drejtor, urdhëro!

**Dren Kukaj:** Veç desha me ju informuar, pasi u hap si temë në mbledhjen e kaluar të KPF-së, me ju informuar që javën ndoshta do ta kemi atë takim, kam pas në këtë javë, po veç pat shumë punë, e ideja është që në atë takim me i diskutuar këto. Unë konsideroj që ka interes publik për atë zonë të këtyre qytetarëve, që ua lehtëson, si me thënë qasjen në energji elektrike ky trafostacion, këtë pronë prej 9 m<sup>2</sup> që po e japim ne. Për mua mos e jepi hiq, por unë mendoj që ka interes ai grup i qytetarëve me e marrë, po tash si të doni. Javën tjetër këto tema mundemi me i diskutuar, e jo sot, dhe kishte me qenë mirë kushdo që ka interesim me u përgatitur, mendoj unë, dhe me ardhur si më konkretisht aty, pra ideja e takimit është ajo, Eman, që po e thua ti, për atë dhe e kemi lënë. Jo, po javën tjetër takohemi, e ta shohim pastaj çka po bëhet.

**Kryesuesi:** Ju dërgojmë njoftimin me shkrim.

Fjalën e ka Adrian Berisha.

**Adrian Berisha:** E përgëzoj drejtorin e Drejtorisë së Pronës, z. Dren Kukaj, për këtë vendim sa i përket takimit të përbashkët, unë kisha sugjeruar që me u takuar, fillimisht me i marrë d.m.th. ankesat nga qytetarët të gjithë ne asamblistët këtu, p.sh. unë kam ankesë prej fshatit Butofc të Hajvalisë, që rryma është me tension të ultë, d.m.th. dhe kisha sugjeruar që ne krejt me i marrë ankesat e qytetarëve me i drejtuar te shefat e GP-ve dhe me këtë rast me e bërë një listë të kërkesave të qytetarëve drejtuar KEDS-it. Përndryshe, për 9 m<sup>2</sup> nuk e kisha bërë aq të madhe, duke marrë parasysh që kemi me e zgjidhur një problem të një regjioni të komunës sonë.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Fjalën e ka Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit, kryesues!

Meqenëse diskutova edhe më herët, unë veç po kërkoj që kjo pikë të mos shtyhet , sepse është nevojë e banorëve dhe ne duhet sot me e votuar për ta dhënë këtë pronë. E një koment te Adrian Berisha, Butofc në Hajvali nuk ka, fshati Butofc nuk është në Hajvali, Adrian.

**Kryesuesi:** Hajde se në rregull është, Adrian, në rregull është. Ju lutem, mos ia merrni kohën Sami Borocit. Regjia, e ndërprisni kohën, hajde, në rregull është. Ju lutem, Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Kryesues, unë veç e mbarova fjalën, faleminderit shumë për fjalën!

**Kryesuesi:** Jo, duhet edhe njëherë me e përsëritur.

**Sami Boroci:** Ok., atëherë kërkesa ime është mos me e shtyrë këtë pikë, me e votuar, sepse mendoj që kjo reflekton te banorët e kësaj lagjeje të Bërnicsës, nëse nuk gabo, kështu që unë po kërkoj që me e votuar, mos me e hequr sot, pastaj për pikat tjera me e diskutuar bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Pronës.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.  
Fjalën e ka Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Faleminderit!

Pyetja ime është jashtë rendit të ditës, sepse për këtë çështje po besoj se po pajtohemi të gjithë me votuar, por dua me e pyetur tash, nëse donë të përgjigjet menjëherë, nëse donë përgjigjet në fund krejt, në pikën e fundit. Desha me e pyetur drejtorinë e Drejtorisë së Pronës, se çka ka ndodhur me banesat, për të cilat ne në njëfarë forme e kemi dhenë edhe si premtim, banesat që anëtarët e LDK-së ia kanë ndarë vetvetes, po nga kjo asamble. Dua të dijë se cili është vendimi që ka me marrë Drejtoria lidhur me këtë çështje.  
Faleminderit!

**Kryesuesi:** Atëherë, veç një sekondë, veç një sekondë, ju lutem!

Po e hedhim në votim, nëse nuk ka diskutues për këtë pikë, dhe mundemi me diskutuar në pikën të ndryshme, se po e shoh që ka shumë interesim pasi janë drejtorët këtu, pastaj vazhdojmë me pikat të tjera.

Atëherë, shkojmë në votim.

Regjia, ju lutem gati!

E votojmë pikën e pestë të rendit të ditës.

Votojmë tash.

Për 44 vota;

Kundër 1 votë;

Abstenime nuk ka;

Nuk kanë votuar 6.

Faleminderit shumë!

**Konstatojmë që është miratuar pika e pestë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi:** Shkojmë me pikën e fundit “Të ndryshme”. Bëni pyetje, tash e kërkuat ju, pyetje bëtë edhe më herët, pyetje dhe përgjigje. Pra, jo, jo, këta po kërkojnë pasi është Dreni këtu me u përgjigjur për këto sende. Veç një sekondë, ju lutem, veç një sekondë, ju lutem, se mu duk që ram dakord që për shkak se është drejtori këtu, të përgjigjet në pyetje e t’i përfundojmë këto pyetje sa janë drejtorët këtu, e pastaj të vazhdojmë me rendin e ditës, kjo ishte ideja. Atëherë, po e shoh që ka të pajtimit dhe mospajtimit, po e shoh të arsyeshme me e hedhë në votim këtë pikë, se tash nuk mundem unë veç me vullnetin personal me e bërë këtë ndryshim.

Kush është për, që pika “Pyetje dhe përgjigje”, jo, jo e thash, bile unë e përkraha që duhet edhe rregullorja me u bërë në atë mënyrë, nuk kam thënë, po në rregull e hedhim në votim, se në votim tash më duhet me e hedhë se ka propozim.

Atëherë, pyetje përgjigje i bëni atëherë kur të vjen pika “Pyetje dhe përgjigje”, ose i bëni me shkrim, e i merrni ndërkohë përgjigjet, sepse po e shoh që nuk po ka disponim me e ndryshuar rendin e ditës, në rregull është, vendimi i juaj është, në rregull. Unë thash se e pash që ka interesim edhe prej atje, edhe prej këtu, për me e bërë më racionale, por po shihet që nuk ekziston disponimi i përgjithshëm. Jo nëse doni e prisni përgjigjen në fund, ose e bëni me shkrim nëse nuk e pret në fund përgjigjen, pra kjo është ideja.

Po drejtor, urdhëro!

**Muhedin Nushi:** Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje asamblistë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës!

Lidhur me këtë çështjen të cilin e parashtroi Egzoni, ne vazhdojmë me rendin e ditës ashtu si e kemi votuar në fillim, kur të vijmë te pika e nëntë “Pyetje dhe përgjigje”, ju pyetjet i parashtroi gojarisht, por në mënyrë verbale, është Zyra e Kuvendit e cila i shënon të gjitha pyetjet, ua drejton drejtorive të caktuara, dhe drejtoritë me shkrim ua kthejnë përgjigjen deri në mbledhjen e ardhshme. Prandaj, nuk keni nevojë, zotëri Fadil, ju kisha lutur me e përcjell procedurën. A mundem unë me e përfunduar, pastaj ju e vazhdoni, sepse nuk është, ju vazhdoni pastaj, ta përfundoj unë njëherë se unë e mora fjalën.

**Kryesuesi:** Fadil, të lutem, e kërkon fjalën dhe e merr fjalën, Fadil, Fadil!

**Muhedin Nushi:** Ju kisha lutur sinqerisht, ju kisha lutur t’i respektojmë procedurat si janë, nëse nuk merrni përgjigje me shkrim, ne do të diskutojmë. I keni marrë me shkrim, nuk është sefte, po më vjen shumë keq, prej meje i keni marrë personalisht çdoherë përgjigjet për çfarëdo pyetje që keni bërë këtu, nuk mundeni me deklaruar që nuk keni marrë përgjigje. Prandaj, ju lutem, të vazhdojmë me procedurat ashtu qysh janë, rendi i ditës ekziston, pika e nëntë kur të vjen i parashtroi pyetjet, përgjigjet i merrni me shkrim nëse drejtorët nuk janë këtu, nëse ka drejtorë, sepse nganjëherë edhe me qenë drejtori, këtu mundet me ndodhë që nuk mundet menjëherë me ju dhënë përgjigje pa marrë informacione tjera.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

**Osman Billaca:** Leutrim, a mundesh me u ulur në vend tëndin, për shkak se je atje i regjistruar, pastaj atje po del që është Uran Ismaili ulur?

**Kryesuesi:** Për shkak të votimit.  
Atëherë, shkojmë tutje.

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për formimin e Komitetit për komunitete.**

**Kryesuesi:** Siç thash edhe në fillim, do të thotë në mbledhjen e KPF-së është bërë kjo listë, është propozuar, është bërë propozimi nga ana e shumicës, kandidatit të shumicës nga ana e LDK-së, mirëpo nuk është bërë nga ana e LVV-së, prandaj unë propozoj që tash ta bëni propozimin grupi i juaj parlamentar, në mënyrë që ta lexoj listën e plotë dhe ta hedhim në votim.

Po, në emër të kujt z. Sami Boroci?

**Sami Boroci:**...(Larg mikrofonit) ne si koalicion, d.m.th. me u dakorduar si koalicion për emrin, jo në këtë rast veç LVV, AAK, ose AKR. kështu që ndoshta kishte me qenë mirë shefat e GP-ve, nëse veç janë konsultuar, ose një pauzë prej 5 minutave në mes tyre.

**Kryesuesi:** Fjalën e ka Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Kjo i përket VV-së në këtë rast, se edhe është e padrejtë që me e shqyrtuar me koalicionet apo kushdo qoftë pjesë e koalicionit tonë, ky anëtari tjetër i përket veç LVV-së, kështu është edhe me rregullore e shkruar, kështu që nuk mendoj që duhet me e diskutuar më gjatë këtë punë.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Fjalën e ka Fadil Gashi.

**Fadil Gashi:** Kryesues...

**Kryesuesi:** Veç një sekondë.

Atëherë, shefja e GP të LVV-së, Leonora Shabani-Bajraktari.

Fadil, të lutem, a ka mundësi Fadil, po, po, veç tash për raporte personale mos të diskutojmë në një mbledhje që është e përgjithshme, të lutem. Po, po, veç duhet jashtë kësaj mbledhjeje me i bërë këto diskutime, jo tash, të lutem.

Atëherë, ju lutem, ju lutem, Fadil, Egzon, ju lutem, i keni 10 minuta pushim, ose jo, jo, veç pak, se duhet...(fjala e pakryer),

Atëherë, Fadil, fjalën e ka shefja e GP të LVV-së Leonora Shabani-Bajraktari, e cila mund të propozoj emër, ose mund të kërkojë kohë për t'u konsultuar, harmonizuar.

Po, urdhëro!

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Unë kisha sugjeruar ta kemi një takim, për shkak se unë nuk kam qenë e informuar më herët për krijimin e këtij grupi, nuk kam marrë pjesë në atë takim, kështu që kisha dashur që me pasur unë një pauzë edhe të diskutoj me shefin e GP të AAK-së dhe ta bëjmë një marrëveshje me ta.

**Kryesuesi:** Pesë minuta pushim.

**Kryesuesi:** A po vazhdojmë me mbledhjen?

Leonora, Leonora, atëherë GP i LVV-së, ju lutem, ta jepni emrin.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** LVV-ja e propozon asamblisten Valbona Petrovci.

**Kryesuesi:** Ju faleminderit shumë!

Atëherë, lista e cila do të hedhet në votim është kjo:

**Valbona Petrovci, përfaqësuese e shumicës;**

**Elmire Nikçi-Rexha përfaqësuese e shumicës;**

**Hetem Kupina, përfaqësues i shumicës;**

**Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i komunitetit serb;**

**Oktaj Kurteshi, përfaqësues i komunitetit turk;**

**Mirsada Behluli, përfaqësuese e komunitetit boshnjak;**

**Idriz Berisha, përfaqësues i komunitetit ashkali;**

**Adnan Ajeti, përfaqësues i komunitetit rom dhe**

**Kimete Shok përfaqësuese e komunitetit goran.**

Atëherë, regjia, ju lutem bëhuni gati për votim.

Votojmë tash.

Për 33 vota;

Kundër 6 vota;

Abstenim 3 vota;

Nuk kanë votuar ose nuk kanë qenë prezentë 9.

Faleminderit shumë.

**Konstatohet se miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete, me emrat që u lexuan pak më herët.**

Shkojmë tutje.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018.**

**Kjo pikë tash është e plotësuar bashkë me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe komiteteve.**

**Kryesuesi:** Ju lutem, Sekretaria rregullojeni këtë.

Tash i thërras përfaqësuesit e subjekteve politike që t'i propozojnë emrat për këtë grup punues. Të gjitha subjektet politike përfaqësohen me nga një, është Zyra ligjore, Zyra e Kuvendit dhe përfaqësues nga ekzekutivi. Do të thotë, këtu përfaqësohen të gjithë subjektet politike, pasi është grup punues, është mirë me qenë gjithëpërfshirës.

Shkojmë me GP të LVV-së. A e keni menduar, ose mendojeni derisa ta përfundojnë këta tjerët?

Veç një sugjerim, ju lutem, mendoj që kish me qenë mirë me i plotësuar dy kushte: me qenë jurist dhe me qenë e gjinisë femërore, kishte me qenë mirë, jo domosdo, sugjerim është, grup punues është ky, megjithatë jo çdo subjekt duhet me pasur nga një.

LVV, cili është propozimi?

**Leonora Shabani-Bajrakari:** Bashkim Beha.

**Kryesuesi:** Nga LDK-ja?

**Halim Halimi:** Agim Gashi.

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Nga PDK-ja?

Leutrim Retkoceri.

**Kryesuesi:** Nga AAK-ja?

Valbona Ajeti.

**Kryesuesi:** Nga AKR-AA?

Arbenita Murseli.

**Kryesuesi:** Nga LB-ja?

Anëtarja e vetme, atëherë propozoj Bukurie Canollin.

**Kryesuesi:** Më së miri.

Nga Nisma?

Nuk është këtu. E propozon veten sigurisht se nuk ka tjetër.

Baton Dushi.

Në rregull.

Po, urdhëro!

**Nol Nushi:**...(Larg mikrofonit), ... dhe kisha dashur me mirëkuptim, me qenë njëri prej nesh pjesë aty, nuk e di a ka mundësi, nuk e di që formalisht nuk kemi GP, po na po, edhe është



ideja që me qenë pjesëmarrës aty, pasi është një rregullore që kemi me e aplikuar edhe ne kemi me pasur aty.

**Kryesuesi:** Nëse pajtohen këta të tjerët, u bë.

Hajde propozimin, a e keni propozimin? Po nuk është problem, formale është, ideja është veç me qenë të përfaqësuar, nuk është e definuar askund që duhet me qenë kështu ose ashtu, veç me qenë të përfaqësuar sa më tepër.

**Nol Nushi:** Për cilën, veç pak, veç pak, veç një sqarim, se GP nuk është as LB-ja, e as Nisma, të dytë u propozuan, po Nol Nushi?

**Kryesuesi:** Jo edhe ideja, veç një sekondë, që thua LB-ja, edhe Nisma, e vërtetë është d.m.th. krejt, ideja është me pasur të gjithë përfaqësim, përfaqësim gjithëpërfshirës, nuk është e definuar, nuk rregullohet në grupe ose diçka tjetër.

Faleminderit!

Atëherë, veç një sekondë, veç një sekondë, Sokol më parlamentar.

**Osman Bllaca:** Jo çdo herë me Ligj për qeverisje lokale mund ta specifikojmë çdo vendim edhe çdo veprim që e marrim si ekzekutiv dhe si Kuvend komunal, por duhen edhe praktikatat e qeverisjes së mirë dhe qeverisjes së mëhershme, që kanë funksionuar shumë mirë për një akt ose për një plan që e kemi bërë në të kaluarën, çdo herë kemi marrë. Në këtë mandat janë 8 subjekte politike, AA u fuzionuar me AKR-në, që i bie 7. Në mandatin e kaluar p.sh. i kemi pasur 10, 13, varësisht, çdoherë ka qenë praktikë që e kemi përfshirë nga një përfaqësues të të gjitha subjekteve që kanë qenë në Kuvendin komunal. Zyrtarisht, Nol Nushi nuk kemi asnjë veprim ne që është ndarë grupi prej katër asamblastëve, ne mund në qoftë se veprohet kjo, nuk është diçka telashe, por tash menjëherë po shkakton rast precedent që Emani po e propozon Egzon Azemin, tash qohet Halimi e propozon Osmanin, ose ai atë, përfaqësues i ekzekutivit jam unë, propozoj veten.

**Kryesuesi:** Atëherë, hajde, po shpresoj që nuk zgjatet shumë.

Atëherë në rregull po, veç një sekondë, ju lutem veç një sekondë.

Atëherë, i hedhim në votim këto propozime që u dhanë, duke përfshirë edhe Nolin, se tash ju jeni një subjekt, megjithatë tash, ju lutem për mirëkuptim të gjithë me pas. Jo, jo, po tash, pse jo, a jeni GP i VV-së, ata kanë dalë prapa atje, megjithatë ata kanë bërë një diferencim, jo, janë pozicionuar jashtë grupit dhe kanë deklaruar që janë jashtë subjektit, tash më mos të hyjmë në interpretime. Eman, të lutem për mirëkuptim, grup punues është ky.

E hedhim në votim grupin që u propozua.

**Atëherë, kryesuesi normalisht shkon me automatizëm,**

**Bashkim Beha, LVV;**

**Agim Gashi, LDK;**

**Leutrim Retkoceri, PDK;**

**Valbona Ajeti, AAK;**

**Arbenita Murseli AKR-AA;**

**Bukurije Canolli, LB;**

Faqe 49 nga 71

## **Baton Dushi, Nisma dhe plus Nol Nushi.**

Atëherë, shkojmë me votim.

Ju lutem regjisë.

Hymë në votim, mundemi me votuar.

Jemi në procedurë të votimit edhe 11 sekonda, ju lutem!

Për janë 30 vota;

Kundër 1 votë;

Abstenim 1;

Nuk kanë votuar ose nuk janë prezentë 19.

**Kryesuesi:** Jo, tash në rregull, ka njerëz që nuk kanë votuar kurrkund, veç ju lutem të jemi më të vëmendshëm. Është e vërtetë që pati tollovi, por të jemi më të koncentruar.

Edhe njëherë, regjia, ju lutem bëhuni gati për votim.

Shefja e grupit ka të drejtë tash me e tërheq.

Urhëroni.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Atëherë, në vend të Bashkim Behës, unë e propozoj Egzon Azemin.

**Kryesuesi:** Në rregull,

Atëherë lista që e lexova pak më herët, me ndryshimin që në vend të Bashkim Behës është Egzon Azemi.

Shkojmë në votim, i lutem regjisë.

Për janë 42 vota;

Kundër janë 2 vota;

Abstenime nuk ka;

Nuk kanë votuar, ose nuk janë prezentë 7.

**Me këtë konstatojmë se është miratuar Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2018, dhe për Rregulloren e punës së Kuvendit dhe komiteteve.**

Faleminderit!

Shkojmë tutje.

## **Pika e tetë**

**Propozimplani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018-2020.**

**Kryesuesi:** Në emër të GP, urdhëro, Leonora!

**Leonora Shabani-Bajraktari:** LVV-ja e përkrah Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, kuptohet që të krijohet edhe një komision për ecurinë e këtij plani, për shkak se personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, jo vetëm në komunën e Prishtinës,

por janë komuniteti më i marginalizuar sa i përket qasjes së tyre, sa i përket ofrimit, shërbimeve për personat që janë me aftësi të kufizuara. Kështu që LVV-ja e përkrah votimin për Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Z. Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Edhe GP i LDK-së e përkrah. Është një material bukur i mirë, veç është me rëndësi të zbatohet ashtu siç është i paraparë këtu. Duke i marrë parasysh se për persona me aftësi të kufizuara, bile ndoshta është dashur edhe me herët me u bërë. Unë nuk po e them, por është një plan, ju them të drejtën, unë e kam lexuar me vëmendje, është më mirë i bërë sesa buxheti i Komunës që e patëm më herët në pikën e rendit të ditës.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë, z. Halimi.  
Në emër të GP të PDK-së, Leutrim Retkoceri.

**Leutrim Retkoceri:** GP i PDK-së e përkrah Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, veçse ne kishim kërkuar që në të ardhmen me e bërë një komision mbikëqyrës të implementimit të këtij plani, në mënyrë që mos të mbetet vetëm në letër, kemi të bëjmë me një kategori të ndjeshme të shoqërisë, të cilës besoj se të gjithë duhet të ju dalim në hak. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Në emër të GP të AAK-së?  
Valbona Ajeti.

**Valbona Ajeti:** Përshëndetje i nderuari kryesues dhe ju të gjithë kolegë asamblistë!  
Edhe grupi ynë parlamentar e përkrah Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
GP: AKR – AA?  
Vesel Makolli.

**Vesel Makolli:** Edhe ne gjithashtu e përkrahim dhe kërkojmë që të zbatohet në përpikëri në praktikë.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
E hap diskutimin.  
Fjalën e ka kërkuar Adrian Berisha.

**Adrian Berisha:** Përshëndetje edhe njëherë.  
Sikur Plan i veprimit në letër po duket shumë i mirë, po kisha dashur me e ditur se kush janë personat përgjegjës, d.m.th. sa i përket zbatimit të këtij plani në të ardhmen, a kanë me

qenë grupet punuese të përbashkëta, së bashku me asamblistët, apo vetëm drejtoritë, sepse besoj që në grupin tonë parlamentar ka asamblistë që me vetëdëshirë dhe me vullnet me qenë d.m.th. pjesë e procesit të planifikimit, ose të planit të veprimit për persona me aftësi të kufizuara në komunën tonë, duke e futur këtu Leonorën, e cila ka bërë dhe bënë një punë të jashtëzakonshme sa i përket këtij grupi të marginalizuar. Këtu e fus edhe vetën, kështu që ftoj të gjithë drejtorët, Mimosë nuk mundem, a dinë me fol në emër të tjerëve, Mimosë a po e din, po flas në emër tim. Gjithashtu, i kisha ftuar të gjithë drejtorët me u ndier të lirë, d.m.th. me kërkuar ndihmën tonë sa i përket këtij Plani të veprimit për persona me aftësi të kufizuara.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit juve!

Drejtori e ka kërkuar fjalën, z. Muhedin Nushi.

**Muhedin Nushi:** Përshëndetje edhe një herë!

Unë po ju falënderoj që të gjitha GP-të e përkrahën këtë Propozim të planit të veprimit për persona me aftësi të kufizuara. Kam qenë vetë i kyçur në përpilim të këtij plani, së bashku me përfaqësuesin e Zyrës për komunitete. Sa i përket menaxhimit të këtij, ose të realizimit të këtyre objektivave të përcaktuara në këtë plan, fillimisht po ju informoj që janë mbajtur takime me të gjitha drejtoritë. D.m.th. kostoja buxhetore, ose kostoja financiare është praktikisht zero, sepse këto projekte janë të parapara në planet e veprimit të Komunës së Prishtinës për këto dy vitet e ardhshme, dhe jemi dakorduar, ndërsa menaxhimin do ta bënë, përveçse ju jeni të lirë, d.m.th. me qenë edhe ju pjesëmarrës. Ekziston një komitet, Adrian, komiteti jo konsultativ ose jo obligativ, Komiteti për persona me aftësi të kufizuara, i cili është jashtëzakonisht aktiv, ku marrin pjesë të gjitha grupet, d.m.th. përfaqësuesit e të gjitha grupeve nga këto, nga personat me aftësi të kufizuara. Ky komitet mbledhet përafërsisht çdo dy javë, ose tri javë, sipas kërkesave, dhe këta e monitorojnë zbatimin në përpikëri të secilit objektiv të parashtruar në këtë dokument, edhe thirrret secili drejtor me raportuar saktësisht për secilën prej këtyre objektivave, pse është realizuar, pse nuk është realizuar, kur do të realizohet etj. etj. Prandaj, ndieni veten të lirë, që kur të formohet edhe ky komitet jo konsultativ, të jeni pjesëmarrës, të paraqitni kërkesën për pjesëmarrje në të si asamblistë.

**Kryesuesi:** Faleminderit, z. Nushi!

Naime Osmani.

**Naime Osmani:** Faleminderit, kryesues!

Pajtohem si kolegët e mi. Shumë i mirë është ky plan veprimi, por unë kisha dashur një sugjerim me thënë, nëse pajtohen edhe të gjithë kolegët, që të stimulohet punësimi i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nuk është e thënë që janë vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara, ka edhe persona të tjerë të cilët nuk i kanë prindërit gjallë, dhe unë kërkojë që komisioni, ose kur të aplikojnë familjarët, të punësohet ndonjë familjar i atyre personave të cilët janë me aftësi të kufizuara, po kur të është në kushte të barabarta, p.sh. po e marrë shembull pasi e kam drejtorin përballë. Konkurren dikush në Drejtorinë e

Shëndetësisë dhe atëherë komisioni apo komiteti le ta verifikojnë rastin ose edhe le ta paraqet konkurruesi, aplikuesi një dëshmi që e ka personin me aftësi të kufizuara, dhe në kushte të barabarta t'i ofrohet punësimi. Nuk e di sa jam e qartë, por unë njoh shumë persona me aftësi të kufizuara që varet edhe nga niveli edhe nga shkalla të cilët i kanë aftësitë e tyre që nuk i kanë prindërit gjallë, dhe të iu mundësohet dikujt prej familjarëve të jenë të punësuar.

Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Arbenita Murseli.

**Arbenita Murseli:** I nderuari kryesues,

Të nderuar drejtorë,

Kolegë asamblistë,

Përfaqësues të mediave,

Të gjithë ju të pranishëm,

Ky draftplan i veprimit për personave me aftësi të kufizuara, i ka të nënvizuara të gjitha kërkesat themelore të këtyre personave, të cilët përbëjnë më shumë se 10% të popullatës në komunën e Prishtinës, kërkesa këto të cilat duhet të zbatohen me përpikëri. Duke qenë se jemi një shoqëri ku ka diversitete, kategori nga më të ndryshmet, Kuvendi ynë duhet të zotohet se do t'i përfaqësojë denjësisht të gjitha kategoritë pa dallim. Personat me aftësi të kufizuara e presin ndihmën dhe mbështetjen tonë, për ta lehtësuar jetën e tyre aspak të lehtë. Nëse për një aspekt ata janë të kufizuar, nuk duhet harruar që ata dinë të jenë të jashtëzakonshëm në aftësi të tjera. Mes tyre ka edhe gjeni të teknologjisë informative, matematicentë, pedagogë, dizajnerë, zdrukthëtarë etj. Këto aftësi të jashtëzakonshme ata duhet t'i shfrytëzojnë diku, e pse të mos jemi ne ata të cilët duhet t'iu sigurojmë infrastrukturën e përshtatshme që t'i subvencionojmë idetë e tyre brilante në të bërit biznes. Personave me aftësi të kufizuara duhet t'iu lehtësohet qasja në arsim, që fëmijët e tillë të kenë edhe asistencë të veçantë përveç mësimdhënësve, që ta ndiejnë veten po kaq të barabartë si të gjithë fëmijët tjerë, në të gjitha fushat e jetës. Duhet t'u ofrohet përkrahje sidomos prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në punësim që të kenë edhe stimul, që ata nuk janë vetëm në sfidat e tyre, të krijohen vende pune nëpër institucione publike, por edhe private, që këta persona ta ndiejnë veten se nuk janë të përjashtuar, por njësoj si të gjithë të tjerët të integruar. Të krijohet fushatë sensibilizuese e vetëdijesuse se personat me aftësi të kufizuara meritojnë mbi gjithçka respekt, mirënjohje e dashuri të sinqertë, sepse mbi të gjitha jemi po kaq njëllor të barabartë. Nga gjithë kjo, unë dua vë theksin sidomos në tri pika kryesore: E para, organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara, duhet të financohen nga Komuna e Prishtinës, sidomos "Hendikos" është një shembull i tillë, duhet të rregullohet qasja në objekte dhe në rrugë për persona me aftësi të kufizuara, sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ për qasje dhe, e treta, punësimi i personave me aftësi të kufizuara, në çdo pesëdhjetë të punësuar të jetë një person i tillë, ashtu si në institucione publike edhe private. Me pak fjalë, e përgëzoj projektin e tillë, kaq të qëlluar, për këtë plan të veprimit për persona me aftësi të kufizuara

që është realizuar nga "Hendikos", në bashkëpunim me organizatat tjera, me ç'rast edhe e shpreh gatishmërinë që t'i përkrahi në çdo iniciativë që buron për të mirën e tyre.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Fjalën e ka Rifat Deri.

**Rifat Deri:** Faleminderit, kryesues!

Unë duke e shfletuar këtë plan të veprimit, që e përkrahi plotësisht në plotni, por e vërejtja një send këtu, që janë të cekur personat me aftësi të kufizuara të shurdhër e nuk janë të cekur persona të verbër, desha ta bëjë këtë pyetje: A hynë në grupin e personave me aftësi të kufizuara alfabeti Brajd.

Mirë, faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Leonora Shabani-Bajraktari.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Faleminderit edhe njëherë për fjalën e dhënë!

Unë këtu në këtë ulëse që jam, më shumë është për shkak të punës që e kam bërë, dhe se sa vështirë është me e rritur një fëmijë me nevoja të veçanta. Flas nga eksperiencia ime. Si bashkëthemeluese e organizatës "Daun Sindrom Kosova", unë kam pas shumë, shumë vështirësi. Fëmijët tanë me nevoja të veçanta nuk e kanë pasur të drejtën as me u regjistruar nëpër çerdhe, nuk e kanë pasur të drejtën as me u regjistruar nëpër shkolla të rregullta, nuk e kanë pasur të drejtën, por gjithmonë kanë qenë vetëm të izoluar, dhe askush nuk i ka marrë parasysh. Si nënë, jam ndier shumë e diskriminuar gjithmonë, nuk kam pasur të drejtë as me punuar, për shkak se nuk kam mundur me marrë pushimin sa herë që vajza ime ka pasur nevojë. Është dashur me e luajtur rolin e logopedit, është dashur me e luajtur rolin e psikologut, është dashur me e luajtur rolin e fizioterapeutit, për shkak se këto asnjëherë as Komuna e Prishtinës nuk i ka ofruar, as shteti jonë nuk i ka ofruar. Fëmijët me nevoja të veçanta, prindërit e tyre kanë nevojë shumë për mbështetjen e shtetit. Komuna e Prishtinës asnjëherë nuk e ka ofruar fizioterapeutin dhe të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta kanë nevojë për fizioterapi. Komuna e Prishtinës asnjëherë nuk e ka ofruar logopedin, të gjithë fëmijët, çdo i dyti fëmijë ka nevojë për logoped në shkollat tona, çdo i dyti, për shkak se duke u marrë në secilën klasë, ka fëmijë që nuk munden mirë me shkruar, dhe ata gjithmonë etiketohen se këta janë ngelcana, por në fakt ata fëmijë kanë problem me disfleksi, kanë problem me disgrafi dhe kurrkush nuk është marr me ta. Komuna jonë, gjithashtu as shteti i Kosovës asnjëherë, d.m.th. e ofron një psikolog në shkollë, por në fakt unë për veti jam e pakënaqur me punën që e bëjnë ata nëpër shkollat tona, ku shumica e psikologëve e bëjnë më shumë punën e asistentit, ose e kanë veç një muaj punë, atëherë kur i regjistrojnë fëmijët nëpër klasa të para, dhe nuk punojnë më shumë, dhe nuk merren me çështjet familjare të fëmijëve, sa fëmija traumatizohet nëpër shkollat tona dhe psikologu nuk e luan atë rol. Kështu që prindërit gjithmonë duhet me i marrë me të mirë krejt, prindi duhet me e marrë me të mirë mësuesen, duhet me marrë me të mirë mjekun, duhet me i marrë me të mirë të gjithë, për me ia ofruar një shërbim fëmijës së vetë, gjë që me ligj është

i mbrojtur. U cek të stimulohet punësimi i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pse është cekur kjo, është për shkak se shumica e prindërve 80% mundem me thënë 85-90% e prindërve, detyrohen bile me e lënë punën e tyre që e kanë për shkak që me i kushtuar rëndësi dhe me i kushtuar kohë, që fëmija i tyre kur të rritet mos me u varur, ose paqare për shkak se nuk ofrohet asistenti, nuk ofrohet mësuesi mbështetës, nuk ofrohet asnjë gjë, asnjë gjë Komuna jonë nuk e ofron për fëmijët me nevoja të veçanta, asnjë gjë shteti jonë nuk ofron për fëmijët me nevoja të veçanta! Kështu që ne si shoqëri duhet ta respektojmë ligjin, nuk kemi nevojë me pasur mëshirë, se këta nuk janë për mëshirë, por ne duhet ta respektojmë ligjin, çdo i pesëdhjeti duhet me qenë i punësuar. Në fakt, më së pari institucionet tona shtetërore nuk e respektojnë këtë ligj, e ne presim prej bizneseve, biznesi kë të do e pranon në punë, kurse në institucionet tona shtetërore asnjë nuk është i punësuar, sidomos në Komunën e Prishtinës dhe në shumë ministri tjera, e në Qeveri, nuk ka të punësuar tamam me numrin se qysh duhet me qenë me ligj.

Ju faleminderit shumë!

Nuk po ju marrë më shumë kohë.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë Leonora!

Nol Nushi.

**Nol Nushi:** Po, kryesues unë veç një propozim, nëse nuk ka ndonjë kështu përplasje ose ndonjë komplikim me ndonjë ligj ja diçka. Ky Propozim plani për veprimin për persona me aftësi të kufizuara, këtë "persona me aftësi të kufizuara" me e plotësuar me "persona me nevoja të veçanta", sepse kjo "me aftësi" është qysh me thënë asnjëri nuk i kemi aftësitë e pakufizuara këtu, kështu që veç me e ndërruar emërtimin, nëse nuk qet ndonjë problem. Unë e thash, nëse ka probleme me ligjin, në rregull, nëse nuk ka, në rregull.

**Kryesuesi:** Drejtor Nushi, të lutem, a ka mundësi një shpjegim.

**Muhedin Nushi:** Së pari po i përgjigjem Nolit. Nol, është e përcaktuar me ligj, nuk mund të ndikojmë ne në emërtimin ose në terminologji të cilën e cekin në dokumente. Leonora, të dëgjova me vëmendje të madhe, e di rastin tënd në përgjithësi, po edhe unë vetë personalisht jam shumë i dhënë pas këtyre projekteve për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës. Sa i përket punësimit, që u potencua nga ju, nga përfaqësuesja e GP të LDK-së, duhet me ju informuar se ekziston edhe një divergjencë në kuadër të dy ligjeve. Njëri është Ligji për persona me aftësi të kufizuara, i cili obligon çdo institucion, ashtu qysh ju e cekët, që në çdo pesëdhjetë të punësuar të punësohet një person me aftësi të kufizuara, por nga ana tjetër, e kemi Ligjin mbi shërbyesit civil, i cili e ndalon favorizimin e cilitdo grup në këtë aspekt për këtë arsye. Por, këtë që po e them, e kemi provuar para dy viteve, kur kam insistuar që në konkursin për pranimin e një personi të verbër, të punojë në centralin telefonik këtu në Komunë, kur u hap vendi i punës me rastin e vdekjes së punëtorit paraprak, i cili po ashtu ka qenë i verbër, e kam marrë përgjigjen nga Ministria se do të anulohet konkursi në rast se e favorizoj grupin e personave me aftësi të veçanta, prandaj kjo divergjencë në mes të ligjeve është cekur dhe është potencuar disa herë në takimet me OJQ-të, por edhe me organizatat ndërkombëtare në takime pune që i kemi

pasur në hotelin "Sirius" para afro dy muaj ditëve. OJQ "Hendikos" ka marrë obligim me e diskutuar këtë divergjencë të ligjeve, ose mospërputhjeve të ligjeve me kryeministrin, praktikisht edhe me ministrin e Administratës Publike, nuk di që ka pasur lëvizje në këtë drejtim, kështu që nëse ju mendoni se mundemi me e bërë ndonjë projekt të ngjashëm, ku kishim me i punësuar personat me aftësi të kufizuara, ne jemi të gatshëm për me ju ndihmuar maksimalisht.

**Kryesuesi:** Sokol Havolli.

**Sokol Havolli:** Faleminderit shumë!

Duke e parë listën e aktiviteteve të cilat janë paraqitur në këtë plan, definitivisht vërehet se është punuar mirë në këtë drejtim, dhe kjo e siguron një përkrahje mjaftë serioze për këtë kategori të shoqërisë tonë, edhe një integrim të tyre po ashtu, por po besoj përveç përkrahjes në disa raste që është edhe materiale, pra duke i reduktuar disa tarifa, duke i reduktuar disa shpenzime e kështu me radhë, është e nevojshme që të sigurohemi që të integrohen në të gjitha pjesët e shoqërisë, jo domosdo vetëm shkolla të veçanta, por do të thotë edhe në çdo pjesë tjetër të shoqërisë, përfshirë edhe edukimin, sidomos tek grup moshat më të reja, përfshirë edhe edukimin e tyre, me qëllim që mos të ndjehen në asnjë situatë të diskriminuar, edhe në grupet e shoqërisë, qoftë në shkollë, qoftë në çerdhe, apo edhe në vende të ndryshme. Nuk e pash si njërin prej aktiviteteve, sigurisht kërkon studim më serioz shkencorë kjo, mirëpo është një çështje, e cila konsideroj se është shumë e rëndësishme, që ata të jenë njëjtë të integruar edhe në çdo sferë të jetës, shoqërisë, shkollës e kështu me radhë.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit, Sokol!

Mimoza Sylejmani.

**Mimoza Sylejmani:** Përshëndetje!

Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë kolegët asamblistë!

Edhe unë jam shumë e lumtur që ky Plan i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, sot u përkrah nga të gjithë. Unë, personalisht, në mandatin e kaluar, së pari kam filluar me OJQ dhe e kam ngritur zërin, pastaj me Zyrën për...(Fjala nuk kuptohet) urban, dhe kam qenë personi që kam shkuar për herë të parë ndoshta te personat e verbër dhe kam kontaktuar me ta, e kam kërkuar udhëzimin administrativ, të cilin me shumë dashamirësi ma kanë dhënë, dhe kemi filluar të gjitha trotuaret, siç e keni parë rrugën "Garibaldi" të fillojnë dhe të realizohen shtigjet për të verbër dhe pllakat aktile, me standarde evropiane, për herë të parë në rajon. Nuk i ka as Shkupi, as Shqipëria. Shqipëria veç ka filluar tash së voni me i bërë. Në kontakt me Drejtorinë e Investimeve Kapitale, të cilët janë zotuar që sivjet edhe rrugën "Agim Ramadani" do ta bëjnë me shtigje për të verbër, pastaj edhe me pllaka aktile. Pllakat aktile zakonisht përdoren për një sqarim në rrugëkalime tek zebrat, është një gjuhë e tyre, e cila e shpjegon që tash mund ta kalojnë rrugën, d.m.th. ka vendkalim për këmbësorë. Po ashtu, Komuna e Prishtinës, gjatë mandatit të kaluar



gjithmonë po flas, është marrë edhe me Hendikosin shumë. Kam pasur takime unë, personalisht, bashkë me drejtorin Muhedin Nushi, drejtorin Arben Vitia dhe drejtorin e kaluar të Investimeve Kapitale, jemi takuar dhe kemi marrë një listë, të cilën e kanë listuar ata, që Komuna e Prishtinës ka shkuar dhe e ka bërë gjithë implementimin e rampave, apo t'i quajmë pjerrinave, se deri në 6% quhet rampa, pastaj janë edhe pjerrina, më falni që po foli me gjuhë arkitektonike, pasi që jam arkitekthe me profesion dhe më takon për me fol, por po mundohem me qenë sa më e qartë me juve, dhe në të gjitha rastet të cilat janë adresuar në Komunën e Prishtinës. Janë realizuar pjerrinat, qoftë edhe ato në prona private, ku nuk ka obligim Komuna e Prishtinës të shkojë në shtëpi private. Po ashtu, kemi diskutuar të ju bëjmë edhe disa ashensor, si platforma që janë, të vendosen nëpër ndërtesa kolektive ku mungojnë liftet, gjithashtu është për t'u përshëndetur edhe drejtori i Shëndetësisë, z. Vitia, që tash e tutje çdo QMF që është duke u rinovuar, është edhe me një tualet për persona me nevoja të veçanta. Kështu që në mandatin e kaluar veçse ka filluar kjo qeverisje të mendoj për ata, shpresoj që edhe në këtë mandat unë d.m.th. kam me qenë prapë shtytëse, edhe pse asnjë anëtarë i familjes nuk është person me nevojë të veçanta, por unë vullnetarisht, edhe nga profesioni, e kam marrë këtë dhe do ta shtyj përpara. Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Atëherë, diskutues tjerë nuk ka, e hedhim në votim.

I lutem regjisë të përgatitet.

Votojmë tash.

Për 44 vota;

Kundër nuk ka.

Abstenime nuk ka.

Nuk kanë votuar, ose nuk kanë qenë këtu 7.

## **Miratohet Propozimplan i veprimit për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2018-2020.**

Faleminderit shumë.

Kalojmë në pikën e radhës

### **Pika e nëntë**

### **Pyetje dhe përgjigje**

**Kryesuesi:** Atëherë, një pyetje veç e kemi, që është bërë më herët, i lutem drejtorit Vitia të përgjigjet.

**Arben Vitia:** Në fakt, më sa mora vesh, zonja Kumrije janë tri pyetje, a po? Më fal!

Së pari, faleminderit shumë për pyetjet, janë bërë disa keqkuptime ndoshta në disa vende, ku ju si përfaqësuese e qytetarëve në Komunën e Prishtinës, e kemi me borxh edhe ne si Drejtori, kërkoj falje që nuk e kam bërë më herët, për me i shpjeguar disa nga temat që i

Faqe 57 nga 71

ngriti zonja Kumrije. Komuna, në përgjithësi kujdesi parësor shëndetësor operon në bazë të disa ligjeve, duke filluar prej menaxhimit të shëndetësisë në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, po natyrisht edhe në bazë të Ligjit për shëndetësi, sidomos të përcaktuar më qartë në Udhëzimin administrativ 08/2015, që i takon kujdesit parësor shëndetësor. Me këtë rast Komuna, secila komunë, përveç komunave me shumicë serbe, nuk lejohet që të kemi shërbime sekondare, me një fjalë specialistët që na lejohen neve janë vetëm specialistët e mjekësisë familjare. Në ligj përcaktohet që gjinekologët, pediatrit dhe çdo specialist i fushës tjetër, në momentin që del në pension, nuk mund të zëvendësohet nga ai specialitet, pavarësisht nëse është nevoja apo jo, sepse nga viti 2004 është duke u ndërtuar, nuk mund të them që ka mbaruar akoma, koncepti i Mjekësisë familjare, në të cilin edhe unë besoj fuqishëm, po është një tranzicion që, dorën në zemër, më duhet ta, këtu edhe vetë si bashkëfajtor ndoshta, nuk është implementuar në masën 100%. Kjo sjell te këto pyetjet pastaj, te përgjigjet në pyetjet e juaja. E para, shtatzënat, që e përmendët pse shkojnë te gjinekologu, e përmenda, është një numër i madh i gjinekologëve në komunën e Prishtinës, që kanë dalë në pension dhe nuk kemi të drejtë t'i zëvendësojmë me gjinekologë, por vetëm me mjekë familjar. Në një takim që e kemi pasur me Klinikën e Gjinekologjisë, ku ka qenë prezent edhe vetë drejtoresha, është bërë një, mos të them një sulm gati, ku disa nga gjinekologët na u kanë drejtuar neve, që ju si mjekë familjarë nëse hyni në këtë pjesën tonë të profesionit, unë mundem me iu qitur në gjyq për këtë, për këtë e për këtë. D.m.th. është një rezistencë e jashtëzakonshme e gjinekologëve në këtë drejtim. Prandaj, besoj që është jo korrekte me mua absolut, por pranoj çdo kritikë, mirëpo kolegët e mi mjekë në QMF dhe në QMU, është e padrejtë me ju thënë që referohen shtatzënat ndoshta me ndonjë ide të përfitimit me klinikat private, sepse kjo është një kërkesë më së pari e Klinikës së Gjinekologjisë, që në disa raste shtatzënat, p.sh. paptesti neve nuk na lejohet ta marrin mjekët familjar, edhe pse për mua është një procedurë teknike, të cilën mjekët familjarë me një trajnim adekuat, do të kishin mundur ta marrin shumë thjesht, kështu kjo sa i përket pjesës së shtatzënave. Sa i përket terminëve, terminët nga janari, siç jeni informuar nga mediat, ka filluar si pilot-projekt, ideja ka qenë që për tre muaj të bëhet si pilot-projekt, ku pastaj me një grup punues që e ka bërë vetë QKMF-ja, vazhdimisht çdo ditë, shkon në çdo qendër dhe e shikon se si bëhen këto terminët, problemet, sugjerimet e sidomos ankesat e qytetarëve karshi kësaj problematike. Ka pasur probleme në fillim, kanë filluar të stabilizohen, pas 31 marsit ky grup do të dalë me rekomandime në muajin prill, dhe ne mendojmë që prej muajit maj e tutje në bazë të këtyre rekomandimeve, të fillojmë me aplikimin e terminëve, mirëpo në sensin se rastet urgjente, edhe ashtu nuk guxojnë me i kthyer, e kemi obligim ligjor çdo rasti urgjent me i dhënë ndihmën e parë. Asnjë rast tjetër, pavarësisht nëse është rast urgjent apo jo, nuk do të kthehet. Ky është proces i cili nuk është vendosur që do të fillojë nga sot, nesër, mirëpo do të shkojë në mënyrë komplet graduale. Për momentin, p.sh. çdo QMF ka vetëm nga një ordinancë që punon me terminë, ordinancat tjera vazhdojnë të punojnë ashtu siç kanë punuar më herët, mirëpo kemi një interesim të shtuar të qytetarëve, se qytetari që pret ndoshta një orë, kur e sheh qytetarin tjetër që ka caktuar termin dhe futet pa prituri në radhë fare, që kjo ideja, kanë filluar vetë të kërkojnë që të bëjnë terminë. Sa i përket asaj që është shtuar numri i referimeve në QKUK, zonja Kumrije, ndoshta mund të keni marrë informata të gabuara, mirëpo nuk është e vërtetë. Vazhdimisht këtë kriter e kemi pas bazë, dhe vazhdimisht jemi duke e

përcjell, shkalla e referimeve nga niveli parësor në nivelin terciar, fatkeqësisht pasi nuk kemi spital të qytetit akoma, sipas OBSH-së është 20% e lejuar, në komunën e Prishtinës për momentin është në mes 15 dhe 16%, dhe kjo nuk ka ndryshuar fare gjatë kësaj kohe së aplikimit të terminëve. Për atë ju siguroj. Kurdo që secili nga asamblistët të dëshirojë, mund t'i ketë këto të dhëna, mund të shkojmë edhe në QKMF, por edhe të jua prezantojë këtu, që as në 1% nuk është shtuar numri i referimeve gjatë kohës sa janë, sa ka filluar pilot-projekti për terminë. Edhe e treta, po, është një problem, jo vetëm në Mjekësin Familjare, jo vetëm në komuna. Besomëni, duhet ta dini edhe ju, ky është problem shumë më i madh në sektorin sekondar në spitalet regjionale, sidomos në QKUK, bashkëpunimi me kompanitë farmaceutike, derisa nuk ka protokolle klinike nga Ministria e Shëndetësisë, derisa nuk ka udhërrëfytes klinik nga Ministria e Shëndetësisë, do të jetë thuajse e pamundur që të parandalohen edhe ato çka u thanë më herët, p.sh. për punën e referimit, se kur është udhërrëfytes, shumë lehtë mjeku mund ta dijë nëse e ka referuar me ose pa nevojë, pa qenë këto edhe kjo problematika e bashkëpunimit me kompanitë farmaceutike, pavarësisht që ne e kemi ndaluar që të vijnë kompanitë farmaceutike në objektet e QKMF-së, ne i kemi ndaluar disa ligjërata që janë mbajtur më herët nga kompanitë farmaceutike brenda QKMF-së, dhe ato ligjërata tash ne i mbajmë vetë. Mirëpo do të jetë problem shumë i madh, e përmbi të gjitha, problemi kryesor është se kemi numër jashtëzakonisht të vogël të inspektorëve shëndetësorë në Inspektoratin e Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Çka do thotë kjo? Kemi diskutuar me shumë ekspertë që ta ndalojmë dhe ta bëjmë përshkrimin vetëm me emra gjenerik, ashtu siç përshkruhet në ligj, problemi është që ne këtë problematik pastaj do ta bartnim nga mjeku te farmacisti, mjeku e shkruan me emër gjenerik, shkon te farmacisti dhe farmacisti i jep ilaçin në të cilin e përfitimin e ka më të madh, që jo domosdo është më i miri, por mund të jetë edhe mall. Faleminderit Fadil, çdoherë je i mirë kështu në shkurtime, jeni vetë i shkurtë dhe praktik, ju çmoj, po unë nuk jam i tillë, kisha nevojë me e sqaruar, je i mrekullueshëm, Fadil. Me fjalë të tjera, nevojitet një koordinim, pajohem me ju, me Ministrinë e Shëndetësisë, që të parandalojmë këtë efekt, që besoj që është në dëm të qytetarëve, mirëpo pa një koordinim të plotë me Ministrinë e Shëndetësisë nuk do të mund të ndalet kjo, mirëpo prapë ju siguroj, në nivelin primar, duke i njohur tash kolegët e mi në nivelin primar, qoftë në Mjekësinë Familjare, qoftë në Mjekësinë Urgjente, besomëni që kjo problematikë jo vetëm në Prishtinë, por në çdo komunë tjetër është më e pakta në krahasim me nivelin sekondar dhe nivelin terciar.

Faleminderit!

Më fal, ndoshta e zgjata, Fadil!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Shefqet Osmani.

**Shefqet Osmani:** Qe afër një vit në Zonën industriale Prishtinë – Fushë-Kosovë, është një rrjedhë e ujit enorme me mijëra e mijëra kub ujë të cilat dalin në sipërfaqe ose në rrugën të cilën e menaxhon Komuna e Prishtinës, ka kërkesa zyrtare të protokolluara në drejtorinë përkatëse, dhe fajin e hedhin tek Ujësjellësi, ujësjellësi e hedhë te Ibër-Lepenci, asnjë nuk ndërmer asgjë. Sot me kaluar atë rrugë është e pamundur, saktësisht me ju treguar, është te “Kosova Sot”, bash në kthesë, është një qebaptore aty dhe pastaj shkon edhe në Qendër

të regjistrimeve atje komplet ai ujë, në Qendër të Numërimit, është si me qenë deti. Unë mundem drejtorit me ia dhënë edhe incizimin e sotëm, që dy ditë ka filluar komplet edhe asfaltin e ka gërryer, e ka qar përjetë. Mendoj që kjo do t'i kushtojë Komunës së Prishtinës, sepse ai asfalt do të riparohet me taksa të taksapaguesve të Prishtinës. Është që një vit problemi, ne si biznese nuk mundemi me e zgjidhur atë problem, duke u hedhë topi herë te Ujësjetllësi, herë ku ta di unë, te Ibër-Lepenci, uji është i pastër si loti, ai ujë derdhet aty. Kjo është pyetja e parë.

Ndërsa pyetjen e dytë është kjo: Para dy ditëve e dëgjova me vëmendje kryetarin e Komunës, z. Shpend Ahmeti, pas rrënimit të një pjese të objektit këtu pranë, kur tha se të gjitha objektet, decidivisht e tha kështu, qoftë ato të mbrojtura ose private të lëna pas dore, duhet t'i marrë në menaxhim Komuna e Prishtinës, e unë e kam një pyetje shumë të thjeshtë: Një objekt i cili gjendet pranë shkollës "Asim Vokshi", i cili është në gjendje të mjerueshme që 20 vjet, që nuk i dihet titullari, është privatizuar dy-tri herë dhe ka mbetur në mëshirë të kohës, i cili objekt për fat të keq përdoret prej narkomanëve, prej përdorueseve të drogave dhe për qëllime kriminale të njerëzve të cilët kanë interes. Kisha pas një pyetje, ose një kërkesë. Çka do të bëhet me atë objekt? A do ta marrë në menaxhim Komuna, apo do ta bëjë ndonjë marrëveshje me AKP-në, ose ta gjejë titullarin e këtij objekti dhe ta marrë në menaxhim. Kaq kisha.

Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

A ka përgjigje prej ekzekutivit tash, apo, ok. në rregull.

Shkojmë me Adrian Berishën.

**Adrian Berisha:** Po, pyetja ime i drejtohet Drejtorisë së Inspektoratit, më saktësisht drejtorit Ibrahim Mehmetaj, i cili që sa seanca i kemi pasur këtu, asnjëherë nuk ka qenë i pranishëm. Kishte me qenë mirë sikur të ishte i pranishëm këtu. Banorët e banesave të solidaritetit ka 4 muaj që kanë bërë një peticion për tunelin e kurrizit. Tuneli i kurrizit është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, fekale, eshtra të mishtoreve, tymi i byrektorës "Bosna". Janë tri dukuri d.m.th., të cilat janë shumë të këqija për shëndetin e fëmijëve që kalojnë për të shkuar në shkollat "Xhemail Mustafa" dhe "Dardania", të dyja shkolla fillore. Përveç kësaj, në këtë tunel kemi mjaft shumë qen endacakë, të cilët mbledhen shkaku i tymit të byrektorës "Bosna" dhe të eshtrave që i lënë mishtoret brenda tunelit. E kisha lut sinqerisht drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, z. Ibrahim Mehmetaj, me marrë masa, sepse që katër muaj iu ka dërguar peticioni, me 45 nënshkrime, nga banorët e lagjes "Dardania".

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit Adrian.

Naime Osmani.

**Naime Osmani:** Faleminderit, kryesues!

Unë më herët e cekta, por edhe njëherë po i përmendi kërkesat e BL të fshatit Besi. Kjo BL përbëhet prej fshatrave Tenezhdoll, Vranidoll, Rimanishtës dhe Besisë. Tenezhdolli ka shprehur shqetësimin d.m.th. për rrugicat dhe rrethojën e varrezave, Vranidolli rrugicat,

rregullimin e kanalizimit, Rimanishta rrugicat, kanalizimin dhe ujësjellësin, Besia rrugicat, trotuaret në rrugët "Njësi Buna" dhe "2 Prilli", si dhe nënkalmi të shkolla fillore "Nexhmi Mustafa". Po ashtu, unë i kam përgatitur edhe disa pyetje, por pasi ke puna, çështja të kërkesat, unë kërkoj nga drejtorët, apo edhe te personat përgjegjës të drejtorive përkatëse, sidomos te infrastruktura, mundësisht të më njoftojnë me projektet të cilat janë në plan të realizohen gjatë këtij viti, në mënyrë që mos ti përsërisë unë kërkesat e njëjta herë pas herë. Në vitin 2010, nuk e di sa pajohen kolegët e mi, por unë dua me e shtruar këtë çështje në Kuvendin komunal të Prishtinës, është marrë një vendim që ne asamblistët të lirohemi nga pagesa dhe të na ofrohen shërbime mjekësore brenda QMF-ve. Unë kërkoj nga kolegët e mi, se besa ndonjëherë na bien ndonjë grip, a kemi bërë ndonjë analizë, apo diçka tjetër, që pasi ashtu-kështu na pagesa nuk po kemi qysh duhet, se kjo është si një social, apo një pension ta quaj, të na mundësohet, ose në seancën tjetër ta paraqesim, ta qesim në votim, a e pranojnë kolegët apo jo me na u ofruar neve asamblistëve shërbime nga ana e QMF-së. Po ashtu, e ceku kolegu edhe për qentë endacakë, edhe ne po kemi problem në atë pjesë, i kanë pru me kamionë zbratur, andaj të ndërmerre masa, nuk po di tjetër çka me thënë, po në fshat i kanë pru. Gjithashtu, edhe juve, kryeses, po ju drejtohem lidhur me pagesën, me mëditjen tonë. Udhëzimin administrativ faleminderit që na e ke dërguar, se në Ligjin për qeverisje lokale nuk e kamë hasur ku përcaktohet, e di që 10 mbledhje është minimumi, ndërsa sa është maksimumi nuk ceket aty, por në Udhëzim administrativë ishte cekur që 12 mbledhje, por nuk ceket se a paguhen mbledhjet urgjente, apo nuk paguhen, vetëm 12 mbledhje brenda vitit. Kështu që ne në muajin shkurt, e kemi mbajtur një seancë urgjente, dhe ajo nuk na është paguar, nuk është kompensuar, edhe pse na mbledhje të rregullt në muajin shkurt nuk kemi mbajtur. Ju faleminderit!

**Kryesuesi:** Po, një sqarim rreth kësaj të fundit, pastaj është drejtori.

Kjo seancë që po mbahet sot llogaritet e muajit shkurt, sepse këtu sistemi është prej 11 të muajit deri më 10 të muajit tjetër, ky është muaji financiar në njëfarë mënyre i pagesës. Do të thotë, kjo seancë llogaritet për muajin shkurt, seanca tjetër që do të mbahet në mars pak më vonë, është për muajin mars, është e rregulluar kjo. Atëherë, drejtori Vitia.

**Arben Vitia:** Faleminderit, shumë shkurt.

Zonja Naime, më fal, unë jam kundër kësaj, mirëpo nëse bëhet ndonjë rregullore ose diçka, unë mendoj që këtu unë vetë kur të shkoj insistoj me paguar, pavarësisht që kolegët e mi nganjëherë duan ashtu mos me paguar, sepse ka raste sociale dhe ka kategori shumë të mëdha, kategori ndoshta që disa edhe pa të drejt kanë hyrë në lirim, mirëpo në momentin që kanë hyrë ato kategori, unë besoj që nuk ishte dashur ne me u liruar. Ky është mendimi im, në fund të fundit, por nëse merret ndonjë vendim tjetër, ajo është çështje tjetër. Për investime, atë që është vetëm për qytetarët e besoj, vetëm po të tregoj që gjatë këtij viti po bëhet një analizë, që nga viti tjetër Besia ta ketë edhe shërbimin radiologjik, që të gjitha ato fshatra që i përmendet ju, mos të vijnë në Prishtinë për me i kryer këto shërbime, jo 24 orë, nuk ka shans sa e kemi këtë numër të punëtorëve shëndetësorë, është e pamundur.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit kryesues!

Unë kam pasur disa pyetje, por po e shoh që drejtorët shumica nuk janë këtu, edhe veç kisha propozuar KPF-së që në mbledhjet e ardhshme me e qitë si pikë të parë të rendit të ditës pikët "Pyetje dhe përgjigje dhe të ndryshme", për shkak se është e pamundur me marrë përgjigje në mënyrë tjetër.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Po ti parashtroje pyetjen.

**Eman Rrahmani:** Ne e dimë që po na kthehen do përgjigje të shkruara, po nuk është ajo çka duam me marrë, ajo është e kotë, a po kupton. Unë po e di që me i pasur drejtorët, ndoshta veç e kishim pasur rezultatin atë që e duam, po është...

**Kryesuesi:** Eman, derisa të bëhet rregullorja e re duhet funksionuar me të vjetrën, tash si rrugë për të komunikuar më mirë, pasi nuk janë drejtorët këtu, e gjetëm me shkrim. Në rregullore të re bëjmë propozimet dhe e parashohim mundësinë që ata me qenë këtu, pyetja me u bërë më herët.

**Eman Rrahmani:** Po, kur ta miratojmë rendin e ditës mundemi me e ndryshuar, qysh e propozuan sot GP i LDK-së, mirëpo.

**Kryesuesi:** Jo, se edhe puna e prezencës së drejtorëve, d.m.th. pyetja parashtrohet më herët, do të thotë në rregullore mendoj që duhet të parashihet, dhe drejtori duhet me qenë në seancë me iu përgjigjur pyetjes që i është parashtruar më herët me shkrim.

Faleminderit!

Drejtori po e deshi fjalën.

**Gëzim Mehmeti:** Zonja Osmani, faleminderit për pyetje.

Dhe, po ju drejtohem përafërsisht, se Plani i veprimit është finalizuar dhe do të jetë publik. Ju do të mundeni të keni qasje në Plan të veprimit, se ku do të intervenohet, ku do të shtrohet asfalti, kanalizimi i ri, ku do të sanohet kanalizimi i vjetër. Jemi në bisedime me Qeverinë gjermane, na kanë premtuar, janë fjalë ende, por besoj që do ta finalizojmë, janë diku rreth 18 milionë, do ta kemi një grant, me të cilin në Komunën e Prishtinës do të bëhet, do të shtrohet kanalizimi i ri, po ashtu do të bëhet edhe ndërrimi i tubacionit, shpresoj që në vitin 2018. Tash, në fshatin Vranidoll tash po kthehem, në këtë fshat janë diku 14 kërkesa për 14 rrugë, të cilat kanë nevojë për kanalizim, po ashtu edhe për shtrim me kubza, do të thotë rrugë të përkohshme. Nëse më lejohet do ta shpjegoj vetëm një gjë. Shtrimi i rrugëve të përkohshme në kubza, kemi telashe me pronësi, edhe duhet me pasur edhe guxim qytetarët, asamblastët me na ndihmuar në këtë drejtim. Pse? Paditë të cilat janë kundër Komunës së Prishtinës janë në rritje e sipër, unë e thash edhe pak në parë, që nënkupton nëse vazhdon me këtë ritëm, nëse investohet në rrugët në prona private, ata kanë të drejtë

pas disa viteve 5 ose 10 viteve, në kërkesën për shpronësim, po ka. Unë po ju tregoj pse ka. Janë shtruar disa rrugë me asfalt, sidomos me asfalt kemi në Hajvali, mundem edhe në mënyrë të saktë të ju tregoj si qëndron puna. Nëse ndryshohet me Ligjin e Prishtinës, aty do të kemi mundësi në hapësira më të mëdha juridike, do të thotë nëse vazhdohet në këtë ritëm. Unë i kam bërë dy kërkesa. Kërkesën e parë, që është në Drejtorinë e Pronës, të bëhet do thotë kalimi i pronësisë nga private në pronësi publike, ose, por këtu po kemi telashe për arsye se po kemi mos gatishmëri të qytetarëve, sepse e vetmja zgjidhje tash momentalisht, po, dhe thash po, po, nuk e kemi..., (Diskutimi larg mikrofonit).

**Gëzim Mehmeti:** Zonja Osmani tha që është plani, në rregull është, jo, jo një moment. A më lejon vetëm ta shpjegoj? Kemi pasur investime në shumë fshatra, pas 10 viteve është ngritur padia kundër Komunës së Prishtinës, i fitojnë rastet, do të thotë 99% i fitojnë rastet, pra Komuna e Prishtinës nuk ka buxhet, nuk do të ketë kurrë buxhet që ta bëjë kompensimin e pronave. Ne duhet të jemi shumë syçelë. E vetmja mundësi është marrëveshje paraprake me pronarët e pronave, që ata, me pajtim të tyre dhe vullnetin e lirë, të largohen nga kërkesa për kompensim material dhe këtë do ta bëjmë, rrugëdalje tjetër nuk ka, e vetmja është kjo. Për atë arsye e shoh dhe besoj që edhe nga ju do të kemi përkrahje, sepse është interesi i parasë publike. Urdhëro, po, në të gjitha rrugët, unë ta shpjegoja ku i kemi telasht, a kupton?

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit, kryesues!

I kam dy pyetje, e para ka të bëjë me, ose në fakt është për kryetarin e Komunës, e kemi dëgjuar edhe më herët që e ka përmendur, ose gjatë fushatës zgjedhore, por edhe më vonë, që ka me u krijuar edhe një drejtori e re, Drejtoria e Parqeve. Unë personalisht kam insistuar që kjo me u ridizajnuar dhe me u quajtur Drejtoria e Ambientit dhe e Parqeve. E kam ngritur në seancë, por i kam dërguar edhe kërkesë në formë zyrtare, kështu që kisha dashur me e ditur prej kryetarit ku është ky proces dhe kur planifikohet me u realizuar. Edhe një pikë tjetër, është përmendur edhe prej dy parafolësve, është problemi i trajtimit të qenve endacakë, ne si këshilltarë komunalë marrim jashtëzakonisht shumë ankesa prej qytetarëve tanë prej pjesëve të ndryshme, që rrezikohen nga ky problem, kështu që e kisha kërkuar një përgjigje konkrete sa i përket trajtimit të qeneve endacakë nga Komuna, ndërsa sa i përket për paga, besoj që Ligji për Prishtinën ka me reflektuar në pagat e asamblistëve.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Jeta Rafuna-Hasani.

**Jeta Rafuna-Hasani:** Faleminderit, z. kryesues!

E kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, z. Gëzim Mehmeti. Drejtor, a jeni në dijeni për një rrugë në rrugën "Bajram Bahtiri", një rrugë që është prishur, është bërë një gropë shumë e madhe dhe pas reshjeve atmosferike është mbushur komplet me ujë, dhe banorët e asaj lagjeje sapo më shkruan dhe m'i dërguan fotot, ajo gropë është

shumë e madhe dhe është rrezik shumë i madh për këmbësorët, sidomos për fëmijët që shkojnë në shkollën fillore “Emin Duraku”, gjithashtu edhe për veturat, sepse dihet që ajo rrugë është një ndër rrugët më të frekuentuara të asaj pjese.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Urdhëro, drejtor!

**Gëzim Mehmeti:** Zonja Rafuna-Hasani, ne jemi në dijeni dhe kemi kërkuar që sa më shpejt të ketë intervenim emergjent, meqenëse nuk mundemi me bërë në këtë kohë shtrirja e asfaltit, derisa të përmirësohen kushtet atmosferike. Do të thotë, ne do të mundemi pas datës 15 mars të fillojmë me intervenime.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Arbenita Murseli.

**Arbenita Murseli:** Të nderuar, kërkesa ime e parë vjen nga mungesa e ndriçimit në lagjen “Mati 1”, përkatësisht në rrugën “Tasim Elezi”, ku nga orët e para të mbrëmjes deri në orët e para të mëngjesit aty është errësirë absolute. Në një lagje e cila ka vetëm 10 minuta larg qendrën e qytetit, të mungoj ndriçimi rrugor është e papranueshme. Kërkesat e qytetarëve të kësaj lagjeje janë që sa më shpejt të intervenohet në këtë pjesë, para se dukuri negative si mungesa e sigurisë që mund të sjellë edhe sulme nga të panjohur dhe vjedhje të mos bëhet. Kërkesa e dytë, vjen si rrjedhojë e rrugës krejtësisht të degraduar në lagjen Sofalia, përkatësisht në rrugën “Sabit Mushica”, e cila vazhdon të jetë në atë mënyrë tash e sa kohë, prishjet e shpeshta të makinave, vështirësitë e qarkullimit të banorëve sa herë që aty ka shi, borë, dhe jo vetëm më bëjnë insistuese se një intervenim i tillë nga Drejtoria e Investimeve Kapitale është më se i domosdoshëm. Ngjashëm janë edhe gropat e hapura në rrugën “Muarrem Fejza” tek rrethi i rrugës “B”, përkatësisht para barnatoreve, ku gropat janë thuajse krejtësisht të hapura e që po përbëjnë rrezik, sidomos kur ka ngrica, që bëjnë që ato të mos shihen fare, duke shërbyer kështu si rrezik për qytetarët, që mund të shoqërohet edhe me pasoja fatale. Andaj kërkoj që në të tri rastet të bëhen intervenime sa më të shpejta, që t’u lehtësohet jeta qytetarëve në vendbanimet e tyre.

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Drejtor, po.

**Gëzim Mehmeti:** Rreth pyetjes suaj, zonja asamblistë, ne në muajt janar dhe shkurt kemi bërë identifikimin e të gjitha gropave në komunën e Prishtinës, por edhe në zonat rurale. Paraqitet nevoja në intervenime, mendoj në mbi 500 rrugë, dhe kemi dhënë zotim dhe premtim që deri në muajin qershor Prishtina nuk do ta ketë asnjë gropë. Kjo ka qenë, do të thotë e kemi bërë planin, por na duhet më shumë kohë, nuk mundemi për një muaj, apo dy muaj, na duhet kohë deri në qershor.



**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Rifat Deri.

**Rifat Deri:** Faleminderit, kryesues!  
Unë i kam dy kërkesa dhe dy pyetje.

Kërkesa e parë vjen nga Shoqata e të Verbërve, të cilët më kanë lutur për me e lexuar në Kuvendin komunal të Prishtinës kërkesën e tyre: Shoqata jonë, d.m.th. Shoqata e të Verbërve, është organizatë humanitare, e cila daton që nga viti 1947, që do të thotë ka një bagazh pune dhe përvoja shumëvjeçare dhe merret me aftësinë e kufizuar, respektivisht me komunitetin e të verbërve dhe me të parë të dobësuar. Statuti dhe programi i saj në një mënyrë të hollësishme i paraqet rregullat dhe dispozitat me të cilat shoqata jonë organizon aktivitete të ndryshme dhe ofron shërbime për qytetarët e verbër, shërbime të cilat nuk i ofron Qeveria dhe pushteti lokal, sepse janë të natyrës specifike apo të veçantë, sikurse që është ofrimi i shërbimeve, trajnimeve, orientimi në hapësirë, mobilitet, teknologji informative, shkrim-lexim në alfabetin e Brajdit dhe shumë aktivitete kulturore dhe sportive. Prandaj, me anë të kësaj kërkesë, ne po ju drejtohem juve që të na pajisni me një printer të alfabetit të Brajdit, i cili ka për neve rëndësi të shumëfishtë. Ky printer na shërben për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të cekura më lart, sidomos në sektorin e arsimit, ku në mesin tonë përveç që kemi qytetarë që vijnë shkollën e rregullt për të verbër, e cila gjendet në Pejë, shkolla "Xheladin Deda", ndërsa kemi edhe anëtarë të cilët janë jashtë sistemit shkollor, sepse verbëria e tyre iu ka rritur në moshë të ndryshme, apo në moshë të shtyrë, për të cilën gjë ne organizojmë kurse të alfabetit të Brajdit, respektivisht shkrim - lexim, në mënyrë që sado pak ta zbusim analfabetizmin. Po ashtu roli i këtij printeri ka të bëjë me përgatitjen e të gjithë dokumentacionit që del nga programi i punës administrative dhe shoqatës, si dhe broshurave dhe teksteve që marrin qytetarët e verbër për shfrytëzim. Andaj, shpresojmë shumë që Ministria, ose komuna në fjalë do të na ofrojë mundësi, sepse sipas Ligjit të verbërisë, nr. 04-L/092, i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës më 14.06.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013, e obligon pushtetin lokal, respektivisht Kuvendin komunal të Prishtinës, Drejtorinë e Arsimit, të na i siguroj pajisjet tifro-teknike dhe tifro-dialektike, në mënyrë që nëpërmes shoqatës sonë komuniteti i verbër të marrë të gjitha shërbimet e nevojshme. Vlen të ceket se Shoqata e të Verbërve e Prishtinës në kuadër të saj i ka edhe 4-5 komuna të tjera, të cilat përafërsisht i kanë diku 500 anëtarë. Si kërkesë e dytë është, Shoqatës së të Verbërve me Vendimin e Kuvendit komunal, me numër 01-353-306, të datës 24.07.2007, iu ka ndarë një tokë për ndërtimin e shkollës për të verbër, e cila tokë është në ngastrat kadastrorë 832, 833, 834, 835 dhe 722, në sipërfaqe prej 1 ha, pra me fletën poseduese 224 si pronë e Ujësjellësit Rajonal të Prishtinës, tash Shoqata e të Verbërve kërkon që kjo pronë të qitet në pronësi të Shoqatës së të Verbërve, ku kjo u dhënë më datë 24.07.2007, kur kryetar i Kuvendit komunal ka qenë zotëri Ismet Beqiri. Po presim përgjigje për këtë. Si pikë e tretë, ose pyetje e tretë, është shqetësimi që qytetarët e Prishtinës mu kanë drejtuar mua në lidhje me furnizimin me mall. Furnizimi me mall bëhet kohë pa kohë, dhe kjo shkakton tollovi shumë të mëdha në komunikacion dhe qarkullimin e njerëzve nëpër markete, kështu që kishte me qenë mirë sidomos, nuk po e di cilës drejtori i takon kjo, Drejtorisë së Shërbimeve Publike apo Drejtorisë së Inspektoratit, që të bëjnë një orar ku do të bëhet shpërndarja e mallit nëpër markete dhe shitoret tjera, sidomos nga përvoja që

kam pas, nëpër qytete tjera është e ndaluar d.m.th. shpërndarja e mallit nga ora 8:00-18:00, duhet të jetë e ndaluar dhe Inspektorati t'i dënojë të gjithë ata që e bëjnë këtë veprimtari joligjore, nëse ne si Kuvend komunal e biem këtë vendim. Dhe, çka është e treta, e treta është e kam një kërkesë në Shërbime Publike, qytetarët e lagjes "Kodrës së Trimave" sidomos të rrugëve "Aziz Zhilivoda" dhe "Frederik Niqe" ankohen se nuk ka ndriçim, me e ditur një plan se kur do të vjen edhe ndriçimi i këtyre dy rrugëve të cilat i përmenda? Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Drejtori, Muhedin Nushi.

**Muhedin Nushi:** Shumë shkurtimisht, d.m.th. çështja e parë për të cilën unë dëgjova, nëse ka qenë pika e parë mu duk që, po printeri për persona të verbër, për Shoqatën e të Verbërve. Unë e marrë për obligim, se edhe vitin e kaluar kam biseduar me KFOR-in italian, lidhur me furnizimin me pajisje të teknologjisë për persona me aftësi të kufizuara, kështu që unë e marr përgjegjësinë për furnizim me një printer. Prandaj, kërkesën duhet me parashtruar zyrtare, jo Ministrisë edhe Komunës, se munden edhe dy me ardhur, le t'ia parashtrojnë kërkesën Komunës, drejtpërsëdrejti këtu kërkesën, unë veç e shënova dhe e diskutoj, por zyrtarisht le të jetë, kjo është.

E dyta, furnizimi i bizneseve, është në përgatitje rregullorja nga ana e Inspektoratit, por edhe e shërbimeve publike, prandaj ta dini që kjo rregullore kur të hynë në fuqi del këtu; edhe e treta, për ndriçim duheni me e parashtruar kërkesën, sepse ka kërkesa të jashtëzakonshme, po e marrë obligim, d.m.th. po i përzihem në kompetenca drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pasi e di situatën si është, d.m.th për ndriçim ka jashtëzakonisht shumë kërkesa. Është mirë me e paraqitur kërkesën, pastaj me rend, pra, nuk ka prioritete, jo pse është Rifati, ose pse është Muhedini, me rend kur të vijë, atëherë bëhet ndriçimi, por kërkesat duhet të hyjnë në rend të ditës.

Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor!  
Haki Dragusha.  
Më falni, Egzon Azemi e ka fjalën.

**Egzon Azemi:** Faleminderit!

Unë i kamë dy pyetje, e para është se në cilën fazë gjendet projekti për rregullimin e varrezave të dëshmorëve në Marec, për shkak që një grup i qytetarëve, banorë të asaj zone dhe veteran të UÇK-së, kanë dashur me pasur një takim me Shpendin, ose me drejtorin në fjalë, drejtorin e Infrastrukturës, po e përsërisë edhe një herë: Pyetja e parë është rreth varrezave të dëshmorëve në Marec, ku një grup i qytetarëve kanë dashur me e ditur se në cilën fazë është projekti, për shkak se ky premtim ekziston pothuajse qe katër vite, apo më gjatë, mirëpo realizimi i projektit nuk ka filluar praktikisht. Pyetja e dytë është, Plani i mobilitetit kur ka me filluar me u realizuar, pra praktikisht nëpër qytet, dhe kur ka me ndarë komuna fonde për blerjen e biçikletave publike, njësojë siç ka vepruar Tirana, apo edhe qytetet tjera?

Faleminderit!

**Kryesuesi:** Faleminderit!

Po, drejtor Mehemti.

**Gëzim Mehmeti:** Po përgjigjem në pyetjen e parë, pasi që jam kompetent. Sa i përket varrezave të dëshmorëve në Marec, te lagja e Vitisë, kanë përfunduar të gjitha procedurat, së shpejti, bazuar në kushtet atmosferike, fillojmë me renovimin e varrezave të dëshmorëve. Po ashtu, përveç varrezave të dëshmorëve në Marec, jemi me Ministrinë, me Qeverinë, respektivisht jemi në bisedime që ta bëjmë edhe renovimin e varrezave të dëshmorëve në Prishtinë, në lagjen "Velania", do të thotë procedurat kanë përfunduar, shpresoj që në fillim të muajit prill fillojmë me renovim. Afati është diku 60-90 ditë.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Leonora Shabani-Bajrakari ose, më fal, se ka dal Haki Dragusha, se me sistem nuk jam adaptuar.

**Haki Dragusha:** Përshëndetje, kryesues!

Unë desha diçka me shtuar rreth terminëve, foli drejtori, d.m.th. terminët nuk janë kurrgjë të këqija, por vetëm sa e përmirësojnë kualitetin e shërbimeve shëndetësore, pra i japin kohë më shumë mjekëve të punojnë në ordianca, që t'u kushtohen më tepër pacientëve, dhe gjithsesi e përmirësojnë kualitetin. I kam edhe dy pyetje për drejtorin. Punëtorët e ndërrimit të natës të QMF-së kërkojnë me u paguar për ndërrimin e natës. Unë e di përgjigjen, por është kërkesë e tyre, edhe punëtorët e Qendrës për Punë Sociale, ata ankohen që nuk po iu paguhen as ato shtesa që i kanë, as festat, dhe ankohen për një punëtorë që ka dalë në pension dhe prapë i është vazhduar mandati, saktësisht kush është ai?

**Kryesuesi:** Po, drejtor urdhëro!

**Arben Vitia:** Atëherë, sa i përket në QKMF-së, ne kemi pasur, unë ju kam thënë që kanë qenë krejt ndërrimi i natës, një nga një ka dashur me kërkuar me pas takim me mua, derisa ju kam thënë bëjeni një grup. Kanë ardhur e kemi bërë kalkulimin, bile, bile ata mbesin mangët diku nga 8-12 orë në muaj. Ua kam shpjeguar, tash mundem me jua shpjeguar prapë, u kam thënë edhe përgjigjen e dinë krejt, por lirisht le të vijnë prapë te unë dhe ua jap prapë përgjigjen. Sa i përket punëtorëve të QPS-së, iu ka vazhduar kontrata dy personave në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, personi i parë është Selatin Kastrati, është zyrtar ligjor në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, arsyeja pse iu ka vazhduar tre muaj afati, tash veç i ka kaluar, dhe nuk iu ka vazhduar më, ka qenë se ka qenë puna se ka qenë anëtarë i Komisionit për ndarjen e subvencioneve, dhe kemi pasur mungesë të një anëtarë, që e kemi lutur me vazhduar, pasi që e ka pasur edhe praktikën e zakonshme, derisa të kryhen lëndët e vitit të kaluar, për arsye se ka dalë në pension diku kah mesi i tetorit, mos gabofsha, të vitit 2017. Personi tjetër që iu ka vazhduar, ky që ka qenë me QPS, është Nazim Cakolli, bile nuk e di a iu ka nënshkruar, unë kam kërkuar nga kryetari me ia nënshkruar, por sa kam informatë akoma nuk i është nënshkruar. Arsyeja e

vazhdimit është sepse është në Komisionin për ndarjen e banesave sociale dhe të kategorive të dala prej luftës, banesat për kategori sociale kanë mbaruar, kurse komisioni, po mendoj procedurat për ndarjen e banesave për kategoritë e dala nga lufta, nuk ka përfunduar akoma, dhe duke qenë si kryetar i këtij komisioni, kam kërkuar nga kryetari, Shpendi, që me iu vazhduar edhe tre muaj kontrata, derisa të përfundon i tërë procesi, pasi ka qenë i kyçur nga fillimi në këtë proces. A për QPS, ky nuk është problem veç në Komunën e Prishtinës, ky është problem, në të gjitha komunat e kanë këtë problem, sepse nuk janë kujdestari ato që quhen, ato janë "Onkoll" që thuhet, ju e dini z. Haki se janë thirrje, mund të ndodhë, mund të mos ndodhë, ata kërkojnë me të drejtë të paguhen, mirëpo këtu nuk ka kompetencë Komuna të bëjë asgjë. Çka ka kompetencë Komuna, ne kemi mundësi që disa orë shtesë që të ua paguajmë punëtorëve herë pas here, 40 orë unë pak më parë diskutova, 40 orë është maksimumi që mundën me bërë, e përmbi ato nuk mundemi, sepse e kemi të ndaluar me ligj, ndërsa sa i përket këtyre "Onkoll" që janë, nuk mund t'ua paguajmë si kujdestari, sepse nuk është vendim që e marrim ne. Po e them të gjithë kolegët e mi në të gjitha komunat, e kanë të njëjtin problem, dhe po mundohen me e zgjidhur këtë problem. Një nga arsyet tjera është se shërbimet sociale në QPS me decentralizim, nuk janë decentralizuar sikur në shëndetësi dhe në arsim bashkë me fonde, por janë decentralizuar vetëm shërbimet, duke mbetur fondet në njëfarë mënyre në nivelin qendror, edhe pjesë e nivelit qendror.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor!  
Leonora Shabani-Bajraktari.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Unë thjesht, isha e interesuar për shkak se në Kuvendin komunal të Prishtinës ekzistojnë vetëm dy komitete dhe ato që quhen obligative, kurse për mua më obligative, jam me kanë edhe Komiteti për arsim, gjë që e kemi arsimin në nivelin më të ultë në rajon, gjithashtu Komiteti për shëndetësi, Komiteti për kulturë, edhe pse këto nuk janë marrë asnjëherë parasysh, që edhe këto duhet me qenë patjetër obligative dhe të jenë në kuadër të Kuvendit komunal të Prishtinës. Kështu që pyetja ime është: Kur do të fillojë edhe pse nuk është obligative, po jam shumë e interesuar me ndihmuar në arsim, kur do të fillojë të mblidhet Komiteti për arsim?  
Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Ok. pasi nuk është dikush tjetër.

**Arben Vitia:** Nuk është kompetencë e imja, por vetëm me ju treguar që po insistoni amanit, sepse në mandatin e kaluar p.sh. Komiteti për Shëndetësi, nga të gjitha subjektet politike ka qenë dorë e djathtë në shtyrjen e shumë, shumë projekteve në shëndetësi në Komunën e Prishtinës, kështu që po, jam, po i bëjë kërkesë ekzekutivit ose kryesuesit që të formohen sa më shpejtë këto komitete, sepse përnjëmend mundën me ndihmuar, qysh kanë ndihmuar në mandatin e kaluar shumë Komiteti për Shëndetësi.

**Kryesuesi:** Ok. një sqarim, prej Osman Bllacës.

**Osman Billaca:** Komitetet jo obligative janë komitete që duhet të formohen në mandat të Kuvendit komunal, për shkak të volumit shumë të madh të pikëve që i kemi. Pikat e rendit të ditës që i kemi pasur për këtë mbledhje, për mbledhjen e dytë ne i kemi pas 16 pika, e i kemi ndarë, bile kjo mbledhje në dy mbledhje është ndarë, pastaj do t'i paraqesim të gjitha komitetet të cilat janë konsultative, në mbledhjen e radhë, dhe atëherë propozohen prej të gjitha subjekteve politike, dhe pastaj janë funksionale për 4 vitet e ardhshme. Kjo ka qenë arsyeja pse nuk janë formuar menjëherë komitetet tjera.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Diskutues të tjerë nuk po shoh që ka.  
Ok., urdhëroi Valbona!

**Valbona Ajeti:** Faleminderit kryesues!  
Unë e kam një kërkesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë. Banorët e lagjes "Sheshi i Arbrit", që është në anën e djathtë të rrugës "Bajram Bahtiri", e kanë mbulueshmërinë për shërbime shëndetësore në QKMF në Vranjevc, ata duhet me kaluar diku 6 km për me shkuar atje, me e kaluar QMF IV për me i kryer shërbimet atje, sepse te QMF IV nuk munden me kryer shërbimet. Kërkesë e tyre është se a mundet me u bërë mbulueshmëria e asaj lagjeje në QMF IV, sepse e kanë më afër.

**Arben Vitia:** Valbona, patjetër që po. Ju lutem, ma dërgoni me shkrim tamam saktë se nuk po e di rrugën si rrugë tamam, nuk e kam të vizualizuar. Unë veç si informacion, për dy vite e gjysmë një ekip i formuar prej ekspertëve në QKMF e ka bërë zoonimin e qytetit, varësisht prej rrugëve ku munden më lehtë të gravitojnë e ta kenë qasjen më të mirë në qendrat respektive të Mjekësisë Familjare. A mund të ketë ndodhur ndonjë lëshim, sigurisht mund të ketë ndodhur ndonjë lëshim, kështu që çdo informacion i tillë veç na ndihmon neve me e përmirësuar gabimin. Ju kisha lutur që me e-mail, ose në çfarëdo forme, edhe përmes sekretarisë, vetëm ta dijë se nuk e kam të qartë tamam vendin, flas me persona përgjegjës dhe nga lagja "Kodra e Trimave", ajo rrugë pastaj graviton në QMF IV te Medreseja.

**Valbona Ajeti:** Po, se kërkesë kanë për mbulueshmërinë afër shtëpive.

**Arben Vitia:** Ai është problem teknik, që zgjidhet brenda një jave maksimumi.

**Valbona Ajeti:** Faleminderit drejtor!

**Arben Vitia:** Faleminderit juve!

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!  
Atëherë, nuk ka pyetje të tjera.  
Hajde qe te të ndryshme po dalim dhe e kryejmë me një rrugë.

**Naime Osmani:** Desha me iu drejtuar z. Deri, për cilën Shoqatë të të verbërve a pati fjalën, se në mandatin e kaluar ne kemi pasur shumë bashkëpunim, Grupi i grave me gratë e verbra, se këta janë të ndarë në dysh, tri janë, për ata unë desha me e ditur cilës shoqatë drejtor do t'i ndihmoni me atë printer.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë!

Atëherë, është pika e fundit e rendit të ditës, "Të ndryshme" nuk ka diskutues, e mbyllim mbledhjen.

Faleminderit shumë!

**Mbledhja përfundoi në orën 14:45.**

